RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

NË

INSTITUTIN E STATISTIKAVE

Auditimi i përputhshmërisë, është kryer ne bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 330/1, datë 03.04.2017, për periudhën 01.01.2015 deri më 31.03.2017.

Auditimi është kryer nga:

1. Mimoza Lloji, përgjegjëse grupi;
2. Valentina Golemi, anëtar;
3. Eni Kabashi, anëtar;
4. Safete Pojani, anëtar;
5. Remzi Refugjati, ekspert i jashtëm.

Auditimi ka filluar më datë 03.04.2017

Auditimi ka përfunduar më datë 20.05.2017

Qershor 2017

PËRMBAJTJA

	PËRMBAJTJA	
I.	Përmbledhje	4
II	Hyrje	5
III	Qëllimi dhe procesi i auditimit	5-11
IV	Rezultatet e auditimit:	11-97
	I. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi I mëparshëm.	11-18
	II. Përputhshmëria ligjore në planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të shtetit me ligjin organik të buxhetit, pagat dhe shpërblimet, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.	18-54
	a. Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.	18-32
	b. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave (*plan, fakt dhe në %)* dhe krahasimi me vitet e kaluara, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Përputhshmqëria ligjore e krijimit dhe përdorimit të fondit të veçantë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.	32-36
	c. Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj*", i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.	33-54
	II. Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime si dhe ankande të realizuara nga Autoriteti Kontraktor.	
	Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë e shërbime nga subjekti i audituar. Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike. Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra, punë e shërbime. Vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.	55-79
	III. Përputhshmëria ligjore, analiza dhe vlerësimi i auditimit të brendshëm.	

	Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara. Auditimi i përputhshmërisë me Ligji nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".*	79-86
	IV. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". *Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informim komunikimi, monitorimi.*	86-92
	Përmbushja e qëllimeve, objektivave të njësisë publike dhe caktimi i nëpunësit autorizues. Hartimi i politikave, miratimi dhe monitorimi i objektivave të njësisë publike, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Miratimi i rregullave specifike mbi procedurat për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, bazuar në Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nëse është hartuar vetëvlerësimi, nëse është hartuar dhe depozituar te Ministri i Financave deklarata vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon, duke respektuar afatet në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.	
	V. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.	
	Mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Statistikave.	92-97
V.	**Konkluzionet dhe rekomandimet**	97-105

I. Përmbledhje

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 330/1, datë 03.04.2017, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u krye auditimi në Institutin e Statistikave përfaqësuar nga zj. Delina Brahimaj, me detyrë Drejtore e Përgjithshme, për auditimin e ushtruar me objekt: *"Mbi zbatimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko financiare".*
Auditimi u krye nga data 03.04.2017 deri më 20.05.2017, sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e auditimit.

Objektivi kryesor ka qenë, auditimi i zbatimit të përputhshmërisë, për periudhën e veprimtarisë ekonomiko financiare nga data 01.01.2015 deri më 31.03.2017, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje, për të dhënë opinionin mbi përdorimin ligjor të fondeve publike dhe rregullshmërinë financiare në paraqitjen e dokumentacionit, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së saj.
Gjatë planifikimit të auditimit, parashikuam që zonat me risk ndodhen tek prokurimet publike por, nisur nga fakti që për periudhën objekt auditimi janë përdorur pak fonde risku është i nivelit të mesëm. Gjatë auditimit është pasur në konsideratë auditimi i çështjeve që kanë të bëjnë me përdorimin ligjor të aseteve të institucionit, ruajtja dhe mirëmbajtja e tyre.
Gjate kryerjes së auditimit vlerësojmë të theksojmë se, nga të gjithë punonjësit e strukturës së institucionit është gjetur fryma e bashkëpunimit, në drejtim të gatishmërisë për vënien në dispozicion të dokumentacionit, realizimit të takimeve ballafaquese me stafin drejtues e atë administrativ të subjektit të audituar për gjetjet e rezultuara nga auditimi etj.
Gjithashtu, gjatë kryerjes së misionit të auditimit në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, kemi diskutuar opinionet dhe konkluzionet tona, janë mbajtur aktet përkatëse të auditimit, janë shqyrtuar observacionet për aktet e mbajtura duke u reflektuar në Raportin Përfundimtar si dhe kemi propozuar rekomandimet përkatese, të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator me objektiv parësor, përmirësimin dhe rritjen e eficiencës në menaxhimin e financave publike.
Në opinion të përgjithshëm, theksojmë se në INSTAT duhet të bëhet një punë më e madhe në drejtim të menaxhimit më me efektivitet të fondeve buxhetore, duhet të rritet në një nivel më të lartë përgjegjshmëria dhe profesionalizmi menaxherial në drejtim të kuptimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe për ketë duhet të hartohen dhe miratohen një sërë regulla të brendshme për gjurmët e auditimit si dhe në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në funksion të përdorimit me efektivitet të fondeve buxhetore.

II. Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) në auditimin e ushtruar në Institutin e Statistikave, i kushtoi vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e Sistemeve të Kontrollit, me programet buxhetore, me strukturën dhe funksionimin e institucionit, me vlerësimin e veprimtarisë së Auditit të Brendshëm, me zbatimin e akteve ligjore në fuqi, në kryerjen e shpenzimeve.
Auditimi u fokusua në cështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me vlerësimin e dokumentacionit bashkëlidhur fondeve të përdorura, në lidhje me vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre.

Vëmëndje e posaçme i është kushtuar auditimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, në përdorimin e fondeve për kryerjen e shërbimeve, blerjen e mallrave dhe pajisjeve si nevoja të domosdoshme në mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të institucionit.
Gjatë auditimit është pasur në konsideratë auditimi i çështjeve që kanë të bëjnë me përdorimin ligjor të aseteve të institucionit, ruajtja dhe mirëmbajtja e tyre.

Për zbatimin e auditivit u mbështetëm në dispozitat ligjore si më poshtë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 23.12.2014 "*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*";
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;
- Ligji nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare*", i ndryshuar;
- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*";
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*";
- Ligji nr.160/2014, datë 27.11.2014 "*Për buxhetin e vitit 2015*" dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit;
- Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* i ndryshuar,
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për sigurimet shoqërore në RSH*", të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014;
- Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "*Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 90/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*";
- Ligji nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar,
- VKM nr. 914, datë 29.12. 2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*"
- Akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre, etj.

III. Qëllimi dhe procesi i auditimit

Për arritjen e objektivave, jemi bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm. Pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, gjatë ushtrimit të auditimit për zbatimin e përputhshmërisë në veprimtarinë ekonomiko financiare, u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, për të parë nëse ekzistojnë gabime, parregullsi dhe veprime të paligjshme.

Gjatë auditimit u konstatua se:
- Nga auitimi i Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, për periudhën objekt auditimit grupi i auditimit konstatoi se hartimi i programit buxhetor afatmesëm si për fazën fillestare ashtu edhe për fazën e dytë ka mangësi në trajtimin e saj, gjithashtu në kërkesat shtësë ku intitucioni parashikon për investime apo shërbime operative në të cilat mungojnë relacionet shpjeguese ne vlera sasiore dhe cilësore dhe disa formatet për argumentimin për kërkesat shtesë të PBA-së ku saktësisht për vitin 2015, formati mbi argumentimin e shtesës së kërkuar për numrin e anketuesve në vlerën 18,710 dhe për vitin 2016 formati mbi argumentimin e shtesës për inevstimin "blerje paisje chiller" në vlerën 6.5 milion lekë.

- Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2015, 2016 dhe 4-mujorin e 2017, grupi i auditimit konstatoi se në të gjitha kërkesat e INSTAT-it mbi rishpërndarjen e fondeve, mungon analiza specifike e datajimit si dhe arsyes së kërkesave në kundërshtim me pikën 74 të udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
- Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit konstatohet se programimi është prekur nga Aktet Normative si në vitin 2015 dhe në vitin 2016, gjithashtu shikojme se Planifikimi i Buxhetit Afatmesëm nuk i referohet vitit parardhës për të minimizuar ndryshimet e ndjeshme të cilat ndodhin kur perballemi me faktin në fund të vitit duke krijuar kështu mosrealizim të shpenzimeve korrente dhe kapitale.
-Raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi, si dhe raportet periodike që institucioni i ka paraqitur në Ministrinë e Financës, nuk janë plotësuar me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel artikulli, lidhur më ndryshimet e planit të produkteve si në sasi ashtu edhe në vlerë në kundërshtim me pikën 79 të udhëzimin plotësues nr. 1, dt. 15.01.2016 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016*"
-Mungojnë argumentat e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikojnë në të ardhmen për realizimin e tyre.
-Performanca e produketeve duhet të paraqitej e lidhur me relizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e programit si dhe si janë realizuar këto objektiva.
-Raportet e monitorimittë buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financës nëpërmjet lidhjes së vendosur në faqet zyrtare të Institucioneve.
- Nga auditimi i ushtruar <u>mbi veprimtarinë dhe rolin e KS</u> konstatohet se, këshilli nuk ka përmbushur rolin dhe detyrat në përputhje me përcaktimet në nenin 11, të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, konkretisht:
- Nuk është dokumentuar shkresërisht se Këshilli i Statistikave ka mbikëqyrur dhe mbështetur INSTAT në rolin e tij për të siguruar se programi është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare.
- Nuk ka dokumentacion shkresor mbi miratimin e projekt programit, ndryshimet e tij, miratimin e planit strategjik pesëvjeçar të INSTAT-it, masat për realizimin e këtij programi, miratimin e plan veprimit një vjeçar, mbi raportimet e shkurtuara katër/mujore të ecurisë në zbatimin e programit të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Veprimtaria për vitin 2015 është pasqyruar duke organizuar dy mbledhje, në kundërshtim neni 10/1, pika 1 të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, ku citohet: "Këshilli i Statistikave mblidhet, të paktën tri herë në një vit kalendarik".
<u>Nga auditimi konstatohet formalitet në veprimtarinë e KS futja në rendin e ditës të mbledhjes së datës 30.06.2015 të Analizës vjetore të vitit 2014 (gjashtë muaj pas përfundimit të vitit kalendarik) si dhe raportimi 4-mujor i ecurisë së programit të statistikave zyrtare, (dy muaj pas përfundimit të veprimtarisë katër/mujore).</u>
- Gjatë analizimit të mbledhjeve të KS konstatohet se ***procesverbalet mbi zhvillimin e mbledhjeve, nuk janë nënshkruar nga pjesëmarrësit në mbledhje***. KS i janë vënë në dispozicion

relacionet përkatëse për çdo çështje në diskutim ***por që nuk janë nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm*** si dhe të ***pa shoqëruara me projekt vendimet përkatëse***.

- Në mbledhjen zhvilluar më datë 24.12.2015, në dosje mungon dokumentacioni shkresor që ***vërteton pjesëmarrjen e anëtarëve të KS në këtë mbledhje,*** për pasojë Urdhri me nr. 1398 prot., datë 29.12.2015, i Drejtorit të Përgjithshëm të Autorizuar, për pagesën e katër anëtarët të KS, si pjesëmarrës në mbledhje konsiderohet fiktiv.

Mbështetur në urdhrin nr. 1398 prot., datë 29.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm, për pagesën e anëtarëve të KS, pjesëmarrës në mbledhjen e datës 24.12.2015, konstatohet se ***mbledhja është zhvilluar pa kuorumin e nevojshëm,*** në kundërshtim me nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, në të cilin citohet: "Kuorumi përbëhet nga të paktën pesë anëtarë të këshillit".

- Nga auditimi i dosjes me materialet përkatëse për mbledhjen e KS, zhvilluar më datë 24.12.2015, nuk është inventarizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat". Nga ana e Sekretarisë së Këshillit të Statistikave, i cili është ngritur në mbështetje të ligjit nr.9180 datë 05.02.2004 i ndryshuar, neni 8 (Detyrat e INSTAT), nënpika 1/k(II) dhe neni 10/1 pika 3, nuk është administruar dosja me indeks të veçantë sipas kërkesave të ligjit dhe formatit standard të arkivimit. Mungon inventari përmbledhës i dosjes, në të cilin të evidentohen shkresat dhe fashikujt e veçantë si dhe numri kronologjik i fletëve sipas fashikujve përbërës të dosjes. Nuk ka gjurmë nga ana e punonjësit arkivues që dosja është marrë në administrim nga arkivi.

- Nga auditimi mbi zbatimin e ligjit nr. 152/2013, datë 01.10.2013 "Për statusin e nëpunësit civil" në lidhje me respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin, procedurat e ndjekura në rekrutimet për vende të lira pune, ngritjen në detyrë, lëvizjet paralele dhe administrimin e dosjeve të personelit rezultoi se:

- Instituti i Statistikave, për periudhën objekt auditimi në strukturën organike, pavarësisht lëvizjeve paralele apo ngritjeve në detyrë, nuk ka plotësuar numrin e planifikuar të punonjësve, miratuar me urdhrin 147, datë 24.12.2012, nr. 126, datë 10.09.2015, nr. 28, datë 08.03.2017 *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave "* të Kryeministrit.
- Proçedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt " *Shërbim akomodim hotelerie*", për vitin 2016;
- Proçedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt " *Blerje karburanti*" ,për vitin 2016;
- Proçedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Blerje chilleri për Institutin e Statistika*",për vitin 2015;
- Proçedura e prokurimit me objekt "*Shërbim ruajtje objekti*", për vitin 2015;
- Proçedurae prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Botim shtypshkime për INSTAT*", për vitin 2015,

janë evidentuar mangësi, në hartimin e fondit limit, në përzgjedhjen e proçedurës së prokurimit, në përgatitjen e dokumentave të tenderit, në hartimin e kërkesave kualifikuese, ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave, duke sjellë një efiçencë të joplotë të fondeve në arritjen e objektivave të këtij institucioni. Ky përfundim kushtëzohet nga fakti se, pranë INSTAT-së, nuk ka njësi prokurimi si strukturë organike brenda institucionit, kështu nisur nga kjo rrethanë, krijohen në mënyrë të vazhdueshme njësi prokurimi, të cilat paraqiten me produktivitet të ulët, për arsye të

mos pasjes me anëtarë të specializuar dhe trajnuar për fushën kompetente (duke marrë parasysh veprimtarinë specifike të disiplinës së prokurimit publik).
- Në proçedurën me objekt "*Blerje chilleri për Institutin e Statistika",* me fond limit 5,400,000 (pesë million e katërqind mijë) lekë, pa tvsh, financuar nga buxheti i shtetit, për vitin 2015, nga auditimi rezulton se:
-Nga auditimi rezultoi se, në dosjen fizike dhe në Sistemin Elektronik të Prokurimeve SEP në app.gov.al, me REF-13337-10-28-2015, në DT, janë vendosur specifikime teknike, skica teknike dhe lista e materialeve për lidhjen e chillerit, të hartuara nga ([redacted] firmosur me vulë dhe firmë), i cili nuk rezulton të jetë punonjës pranë INSTAT apo të jetë marrë si eksperti i jashtëm. Nuk është evidentuar, asnjë e dhënë mbi mënyrën sesi është rekrutuar për të realizuar dokumentacionin e dorëzuar prej tij. Gjithashtu në dosje ndodhet licenca profesionale fotokopje e cila është lëshuar në 26.05.2005 me afat 10 vjeçar, tenderi është realizuat në tetor 2015, pra del jashtë afateve ligjore) si dhe asnjë ekstrakt pranë QKR-së, gjë që ngarkon me përgjegjësi ish titullarin e INSTAT, ([redacted])
-Nga auditimi rezultoi se, titullari i INSTATI-it, i ka deleguar të drejtën në mungesë dhe porosi [redacted] me detyrë drejtor Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, i cili ka vendosur të jetë njëkohësisht dhe kryetar i KVO-së, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 56, me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, gjë që ngarkon me përgjegjësi ish titullarin me delegim ([redacted]).
-Nga auditimi i DT, rezulton se është, vendosur kritereri i veçantë (Kapaciteti teknik) në pikën b) Liçensa profesionale e shoqërisë, të lëshuara nga autoritet kompetente shtetërore , *Kat. N.S-12 Impjante teknologjike, termike dhe të kondicionimit,* i plotësuar nga operatori ekonomik fitues, "Sulollari"shpk, duke lidhur kontratën nr.1219/10 datë 24.12.2015, me vlerë totale prej 4,668,000 (katër milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë) lekë me TVSH,e cila është realizuar me sukses, e vërtetuar nga proces verbalin e datë 30.12.2015 nga komisioni i pritjes së mallit, i krijuar me Udhërin e titullarit nr.14/2 datë 08.09.2015.
- Gjithashtu në të njëjtën kohë, në datë 24.12.2015, nga ana e ish-Titullarit të AK ,[redacted] , është miratuar kërkesa, e hartuar nga z.[redacted] drejtor Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është realizuar procedura me blerje të vogël me vlerë prej prej 71,667 lekë pa tvsh, me Urdhër Prokurimi nr.36 datë 28.12.2015, në formë shkresore, për të testuar realizimin e montimit dhe blerjes se chillerit.Pikërisht, për të testuar është kërkuar nga AK, *që INSTAT të kontraktojë një inxhinier të fushës i cili të jetë i liçensuar për ushtrimin e funksionit sipas kategorisë NS-12 "Impiante teknologjike, termike dhe kondicionimit",* kërkesë kjo që është kërkuar në proçedurën e blerjes së chillerit, dhe e plotësuar nga operatori ekonmik "Sulollari"shpk. Ky fakt të jep idenë e mosbesimit ndaj OE fitues, si dhe nga AK *duhet të kërkohej në DT nga NjP*, garancia objektit të prokurimit dhe realizimi i kontratës.
-Komisioni i blerjeve të vogla,ka vendosur të përcaktojë fitues operatorin ekonomik "[redacted]" me vlerë ofertë me vlerë prej 60,000 lekë pa tvsh. Titullari i AK zj.[redacted], ka lidhur kontratë me datë 29.12.2015, me personin fizik[redacted], e cila ka marrë përsipër të gjej inxhinierin,që të plotësojë kriterin e mëspërm. Nga auditimi rezultoi se, relacioni për "testimin e punës" së bërë nga operatori ekonomik "[redacted]" është i konfimuar nga ing.[redacted], i cili rezulton të ketë

kontratë punë i mbajtur më datë 28.12.2015, midis [redacted] dhe ing, duke mos paraqitur detyrimet si punëdhënës pagesat e detyrimeve të sigurimeve shendetësore dhe shoqërore, të mëparshme, duke të dhënë idenë se personi fizik, ka bërë thjesht lidhjen me këtë person, duke u paguar me Urdhër shpenzimi nr.35 datë 28.01.2016 me *vlerë prej 60,000 lekë pa tvsh*, në mënyrë jo korrekte nga buxheti i shtetit, në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimeve, duke sjellë një efekt ekonomik negativ që ngarkon me përgjegjësi ish titullarin e INSTAT zj. [redacted] dhe Z.[redacted]

-Në proçedurën e prokurimit, e përqëndruar e realizuara nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqëndruara në Ministrinë e Brëndshme me objekt " Blerje karburanti për vitin 2016", rezultoi se, nga ana AK të INSTAT-it, nuk janë përcaktuar specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit dhe kushtet e veçanta të kontratës, por është llogaritur vetëm vlera e fondit limit dhe sasia e karburantit. Lidhja dhe monitorimi i kontratës datë 26.04.2016 me operator fitues "[redacted]", është realizauar nga INSTAT. Nga auditimi rezultoi se, çmimi është rritur dukshëm, në referim me çmimin fitues për 123,61 lekë/litër, duke i krahasuar me faturat tatimore të shitjes (Fatura tatimore e shitjes nr.55 dt. 29.06.2016 çmimi pa tvsh 135,51 lekë/litër; nr.93 dt. 06.09.2016 çmimi pa tvsh 134.37 leke/liter; nr.17 dt. 21.11.2016 çmimi pa tvsh 133,40 lekë/litër; nr.22 dt. 27.12.2016 çmimi pa tvsh 143,63 leke/liter). Kështu nisur nga këto kushte, nga ana e AK , *duhej të zbatohej* nenit 77 pika 5 e VKM-së nr. 914, dt.29.12.2014, i cili thotë *" Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës, për furnizimin me karburant, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo në ngritje , me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimit të ndryshueshëm të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit mbështetur në deklaratën doganore SAD", gjë e cila ka sjellë që AK, ka përfituar më pak sasi gazoil, për shkak të vlerës më të lartë të çmimit të shitjes.*

-Nga auditimi, është evidentuar, se gjatë vitit buxhetor 2015, janë realizuar 5 proçedura prokurimi të cilat janë zhvilluar në mënyrë të përqëndruar, pranë Drejtorisë së Prokurimeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brëndshme, kjo në zbatim të VKM nr.28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime" si dhe në bazë të shkresës nr.26 prot datë 29.12.2014 "Kujtesë në lidhje me dërgimin e të dhënave për proçedurat e prokurimit që do zhvillohen nga ana jonë si dhe prioritett e zhvillimit të tyre", duke ju kërkuar që prokurimet prioritare duhet të paraqiten pranë Organit Qëndror Blerës, Ministrisë së Puneve të Brendshme, brenda datës 15.01.2015, ndërsa kërkesat për proçedurat e prokurimit me përparësi normale duhet të paraqiten brenda datës 31.01.2015. Kështu, nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit , ka vërejtur se, AK-ja, nuk e ka respektuar afatin ligjor 31.01.2015, të përcaktuar në VKM nr 28, datë 14.01.2015 për dërgimin e të dhënave teknike e sasiore dhe fondin përkatës për çdo prokurim, në OQB, duke sjellë vështirësi e vonesa të panevojshme në zhvillimin e procedurave të prokurimit, kjo edhe për faktin se, në asnjë nga dispozitat ligjore që përcaktojnë kryerjen e prokurimit të përqendruar, nuk ka sanksione për autoritete kontraktore që pa arsye të justifikuara, vonojnë paraqitjen e të dhënave pranë OQB, e për rrjedhojë zgjasin afatet e zhvillimit të tenderëve dhe shkaktojnë vështirësi në plotësimin e nevojave për mallra e shërbime për administratën publike.

- Nga auditimi, rezultoi se pranë INSTAT-it, sektori i auditimit është një strukturë jo e plotë me burime njerëzore, për shkak të dështimit të rekrutimeve të autituesve të brënshëm nga DAP dhe si rrjedhojë nuk ka realizuar të gjitha auditimet që ka parashikuar në fillim të çdo viti kalendarik.

Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i përgjegjësit të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bërë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.

- Lidhur me 2015 nuk është realizuar inventarizimi në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" dhe udhëzimin e MFinancës nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" Kapitulli IV "*Inventarizimi i aktiveve*". INSTAT në 2015 ka bërë zbardhjen e inventarit të 2014.

- Grupi i auditimit konstatoi se INSTAT, për **vitin 2015** ***nuk ka nxjerrë asnjë urdhër*** për ngritjen e GMS dhe për rrjedhojë nuk është realizuar asnjë mbledhje. Për vitin **2016**, INSTAT ka nxjerrë urdhër të brendshëm për ngritjen e GMS me nr. 1567 prot. datë 28.12.2016. Gjatë **2016** është realizuar një mbledhje e GMS protokolluar me shkresën nr. 1567/4 datë 30.12.2016. GMS nuk është mbledhur rregullisht për periudhën objekt auditimi. Kjo bie ndesh me kërkesat e n**enit 27** ***"Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë së sektorit publik"*** të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" ku përcaktohet se: "*1. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave*".

- Grupi i auditimit konstatoi se institucioni ka organikë të paplotësuar gjë që afekton mbarëvajtjen e punës. INSTAT është një institucion i cili për rritjen e standarteve të statistikave ka nevojë gjithmonë për burime shtesë dhe mungesa e këtyre burimeve afekton mbarëvajtjen e punës dhe standarteve të institucionit**. Sekretar i GMS** është nëpunësi zbatues. Në këtë pikë u konstatua se është konfirmuar përkohësisht Nëpunësi Zbatues i INSTAT me shkresën nr. 6413/2 prot. datë 2.06.2016, znj. [redacted] përgjegjëse e sektorit të financës. Ajo do jetë Nëpunëse Zbatuese deri në plotësimin e vendit vakant të *drejtorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse*. Mospërputhja qëndron në faktin që **sekretar i GMS** gjatë mbledhjes ka qënë drejtori i autorizuar i financës[redacted], bazë autorizimit nr. 610 prot. datë 16.05.2016, i cili është shfuqizuar me shkresën nr. 93 prot. datë 18.01.2017, ku detyrat e drejtorit të Drejtorisë së Financave përkohësisht autorizohet ti realizojë znj.[redacted]. Kjo bie në kundërshtim me **nenin 12/2a** "*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" ku përcaktohet se: *" 2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: a) dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*;" Aktualisht me **rregulloren dhe organikën** e re z. [redacted] kryen funksionin e koordinatorit të sistemit statistikor kombëtar.

- Grupi i auditimit konstatoi se Titullari informohet nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, por nuk **ka relacione dhe raporte** rreth këtyre mbledhjeve. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtëpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia **<u>nuk ka hartuar një procedurë</u>** për mbledhjen dhe dokumetimin e gabimeve dhe analizën e tyre.

- Grupi i auditimit konstatoi se INSTAT ka mungesë në fushën e trajnimeve të stafit. Ky institucion nuk *ka program specifik për trajnimin e punonjësve* të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, pika 3.1. "Mjedisi i kontrollit të brendshëm" paragrafët "***Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njërezore***" dhe "***Profesionalizmi i stafit***". Punonjësit e njësisë duke mos patur njohuritë e duhura për ligjin e MFK-së dhe duke moskryer trajnime nuk bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të MFK-së, dhe kjo passjell mangësi në punën institucionale.

IV. rezultatet e auditimit

IV.I. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditivi i mëparshëm

KLSH ka audituar Institutin e Statistikave mbi veprimtarinë ekonomiko financiare për periudhën nga data 01.04.2009 deri më datë 31.12.20012. Me shkresën nr. 1336/6, datë 30.04.2013, bashkëlidhur raportit Përfundimtar të auditimit, për përmirësimin e gjendjes së institucionit, janë rekomanduar marrja e 2 (dy) masave për përmirësim ligjor, 10 (dhjetë) masa organizative dhe 3 (tre) masa për zhdëmtim të dëmeve ekonomike të shkaktuara.
Në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve INSTAT, i ka kthyer përgjigje KLSH, me shkresën nr. 1173/5, datë 10.06.2013, tej afatit ligjor prej 20 ditëve nga marrja e Raportit Përfundimtar të auditimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:
a. *Për përmirësimin e* ***dispozitave ligjore*** *dhe nënligjore janë lënë* ***2*** *rekomandime, të cilat janë pranuar dhe janë zbatuar nga subjekti.*
b. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë* ***10 masa organizative****, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 10 rekomandime, nga të pranuarat 8 janë zbatuar plotësisht,1 i pazbatuar dhe i zbatuar pjesërisht 1 rekomandim.*
c. *Për* ***zhdëmtimin e dëmeve ekonomike*** *të shkaktuara, janë lënë* ***3*** *rekomandime, nga të cilat është pranuar plotësisht 1 rekomandim, nuk janë pranuar 2 rekomandime. Rekomandimi i pranuar është zbatuar plotësisht dhe dy rekomandimet e papranuara nuk janë zbatuar.*
d. *Nuk janë rekomanduar* ***masa disiplinore****.*
Masa organizative e pa zbatuar është rekomandimi nr.2 si dhe i zbatuar pjesërisht rekomandimi nr.5 :

Rekomandimi i lënë:
2. Instituti i Statistikave, për përmirësimin e punës dhe rritjen e përdorimit efektiv të fondeve buxhetore, në të ardhmen të mos marrë veprime për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, të pa argumentuar dhe të pa mbështetur në dispozitat ligjore përkatëse në fuqi, të eliminojë rastet e aplikimit të penaliteteve për mos likuidimin në kohë të detyrimeve në zbatim të kontratave me kontraktohet, si dhe eliminimin në maksimum të taksave përmbarimore që paguhen për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Përgjigja e subjektit:
Për zbatimin e këtij rekomandimi INSTAT, do të punojë vazhdimisht për zbatimin e rekomandimit të kësaj pike, duke zbatuar dispozitat ligjore ne fuqi.

Komenti
Për sa më sipër ky rekomandim është pranuar dhe konsiderohet ***i parealizuar*** *nga INSTAT, për faktin se në periudhën objekt auditimi janë likuiduar pesë vendime gjyqësore të formës së prerë me vlerë 2,873,323 lekë..*

5. Rekomandimi i lënë:
Nisur nga numri i strukturave në varësi të Institutit të Statistikave (gjithsej 35), numri i audituesve në raport me detyrat audituese nuk ka qenë i plotë. Për këtë *rekomandojmë* që, Instituti i Statistikave, të marrë masa për të plotësuar strukturën e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik", pika 2, ku citohet: *"Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi, tre auditues, përfshirë drejtuesin e njësisë"* dhe të organikës të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 147, datë 24.12.2012.

Menjëherë

Përgjigja e subjektit:
Për zbatimin e këtij rekomandimi INSTAT ka hartuar projekt-strukturën organizative e cila ka hyre në fuqi me urdhërin e Kryeministrit nr. 126, datë 10.09.2015 dhe nr. 28, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së institutit të statistikave". Ndërkohë konstatohet se për periudhën objekt auditimi INSTAT nuk e ka plotësuar këtë sektor me numrin e plotë të audituesve. Për vitin 2016 dhe tremujorin e parë të vitit 2017, Sektori ka punuar me një auditues me pak.

Komenti
Për sa më sipër ky rekomandim është pranuar dhe konsiderohet ***i realizuar pjesërisht*** *nga INSTAT.*

-Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar për shpërblimin të dëmit ekonomik tre masa nga të cilat dy masa nuk janë pranuar nga subjekti e konkretisht rekomandimi nr. 1 dhe 3.

1. Rekomandimi i lënë:
Instituti i Statistikave të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, në shumën ***470,113 lekë***, ndaj personave materialisht përgjegjës, nga të cilët 26,000 lekë për dhënien e dhuratave mbi kufirin maksimal të lejuar dhe 444,113 lekë shpenzime të kryera nga minibari në ambientet e institucionit pa dokumente justifikues në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar.

Menjëherë

Përgjigja e subjektit:
INSTAT nuk e ka konsideruar të arsyeshme ta zbatojë këtë rekomandim të lënë nga KLSH, pasi blerja, administrimi dhe lëvizja e produkteve është kryer duke u bazuar në procedurat e prokurimit dhe kontraktimit, si dhe duke zbatuar rregullat e magazinimit dhe hyrje-daljeve të produkteve, procese të cilat nuk janë kontrolluar nga auditi. Shpjegime të cilat janë dhënë edhe nëpërmjet shkresës nr.1175/5, datë 10.06.201, dërguar KLSH.

Komenti
*Për sa më sipër ky rekomandim nuk është pranuar nga INSTAT dhe konsiderohet **i parealizuar**.*

3. Rekomandimi i lënë:
Instituti i Statistikave, të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën ***733,000 lekë*** nga përfituesit, paguar padrejtësisht për dërgimin me shërbim të punonjësve në qytetet Elbasan, Librazhd, Gramsh, Peqin, Kavajë, Krujë, Laç, Lezhë dhe Rrëshen me distancë nga Tirana më pak se 100 km, në kundërshtim me pikën 1, Kreu III, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit".

Menjëherë

Përgjigja e subjektit:
INSTAT nuk e ka konsideruar të arsyeshme ta zbatojëkëtë rekomandim të KLSH për faktin se, nuk e ka konsideruar si dëm ekonomik, mbasi punonjësit nuk kanë lëvizur vetëm në distancën rreth-Tiranë, por kanë lëvizur disa herë edhe nëpër komunat që ndodhen brenda rrethit, kjo për shkak të specifikës së punës për mbarëvajtjen e Censusit të popullsisë 2011, spjegime të cilat i janë dërguar KLSH me shkresën nr. 1173/5, datë 10.06.2013.

Komenti
*Për sa më sipër ky rekomandim nuk është pranuar nga INSTAT dhe konsiderohet **i parealizuar**.*

IV. II. Përputhshmëria ligjore në planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të shtetit me ligjin organik të buxhetit, pagat dhe shpërblimet, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

IV. II/a. Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimi i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit.

Auditimi i programimit dhe realizimit të fondeve buxhetore u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

Baza ligjore në auditim.
-Ligjet: nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; nr.160/2014, datë 27.11.2014 "Për buxhetin e vitit 2015" dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit; nr.147/2015, datë 17.12.2015"Për buxhetin e vitit 2016" dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit; nr.8334, datë 23.04.1998 "Për privatizimin e shoqerive tregtare që veprojnë në sektoret jo strategjike", i ndryshuar; nr.8306, datë 14.03.1998 "Për strategjinë e privatizimin të sektorëve me rëndësi të veçantë"; nr.9723, datë 03.05.2007"Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit"; nr.9870, datë 04.02.2008 "Për Standartizimin" i ndryshuar; nr.9947, datë 07.07.2008 "Për pronësinë Industriale", nr.9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë"; nr.9024, datë 06.03.2003 "Për akreditimin e laboratorëve testues kalibrues, organizmave çertifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë".
-Vendimet e Këshillit të Ministrave: nr.433, datë 02.07.2014 "Për miratimin e projekt dokumentit të programin buxhetor afat mesëm 2015-2017"; nr.432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore";
-Udhëzimet e Ministrisë së Financave: nr.7,datë 28.02.2014 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe tabelat e tavaneve për PBA 2015-2017"; nr.8, datë 27.02.2015 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018", nr.7, datë 11.02.2015 "Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limiteve të angazhimit"; nr.1, datë 04.06.2014, për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit"; nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit"; nr.2, datë 18.08.2011 të Minitrisë së Financave "Për menyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit"; nr.30, datë 27.12.2011 të Minitrisë së Financave "Për menaxhimin e Aktiveve ne Njesite e Sektorit Publik"; nr.5, datë 27.02.2014 "Per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura", me ndryshime, nr.8, datë 29.03.2012 të Minitrisë së Financave "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm".
Urdhëri i Kryeminitrit nr.159, datë 09.05.2014 "Për miratimin e metodologjise për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin e investimeve pubilike".

Pika 1. Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit të vitit 2015 dhe 2016 dhe 2017, çelja e detajimi i planit fillestar, ndryshimet e tij gjatë vitit dhe zbatimi i tij.
Instituti i statistikave, bazuar në programin buxhetor afatmesëm dhe në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8 datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9 datë 22.02.2013 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017", VKM nr.138, datë 20.02.2013 "Mbi miratimin e tavaneve përgatitore të PBA-së 2015–2017", ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këto udhëzime.
Misioni i Instituti të Statistikave është sigurimi i infromacionit sasior dhe përfaqësues për situatën e konomike, demografike, sociale dhe mjedisore në Shqipëri, në kuadrin e programit pesëvjecar të statistikave zyrtare, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të Qeverisë dhe përdoruesve të tjerë. Programi shpenzues i INSTAT-it është prodhimi i statistikave zyrtare e cila konsiston në prodhimin e të dhënave statistikore të nevojshme.

Për vitin 2015 :
Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2014 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017", si dhe VKM-së nr.110, datë 27.02.2014 "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetore Afatmesëm 2015-2017", Instituti i Statistikave ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Kërkesat buxhetore përfundimtare për fazën e parë të PBA-së, janë dërguar në Ministrinë e Financave shkresërisht ,me shkresën nr.348/1 prot., datë 30.04.2014 "Dërgohen kërkesat buxhetore të INSTATIT për fazën e parë të PBA-së 2015-2017", pra brenda datës 01 Maj 2014;
Instituti i statistikave me shkresën nr. 2831 prot. Datë 29.08.2014 drejtuar Ministrisë së Financës ka dërguar dokumentin e PBA-së fazën e dytë ku pasqyrohet vlerësimi i nevojave buxhetore për periudhën 2015-2017 sipas programit buxhetore si dhe pasqyrën e kërkesave shtesë. Tavanet buxhetore të PBA-së 2015-2017, nuk mbulojnë nevojat e Institucionit, duke kërkuar investime kapitale si dhe fonde shtesë të tilla si:
Paisja e godinës me Chiller për kondicionimin e ajrit e cila ndikon në mirëfunksionimin e aparaturave elektro-kompjuterike në tepmeraturat e kërkuara në vlerën 6.5 milion lekë
Janë këkruar fonde shtesë në zërin 600, 601 përkatësisht në shumën 18,710 mijë lekë, për një shtesë të numrit të anketuesve
Sa më sipër, e gjithe vlera mbi shtesën për investime si dhe kërkesën për shtimin e numrit të anketuesve shkon në vlerën për vitin 2015 shkon në vlërën 25,2 milion lekë.

Për vitin2016:
Në zbatim të Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesme", INSTATI ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Kërkesat buxhetore përfundimtare për fazën e parë të PBA-së, janë dërguar në Ministrinë e Financave shkresërisht ,me shkresën nr. 402/1 prot., datë 30.04.2015 "Dërgohen kërkesat buxhetore të INSTAT-it për fazën e parë të PBA-së 2016-2018", brenda aftit ligjor i cili është deri më datë 01 Maj 2015;
Institui i statistikave me shkresën nr. 402/3 prot. Datë 30.08.2015 drejtuar Ministrisë së Financës ka dërguar dokumentin e rishikuar të PBA 2016 – 2018 (faza e II) përfshirë kërkesat shtesë dhe relacionet përkatëse sipas programi buxhetor Veprimtaria Statistikore sipas VKM nr. 696, datë 31.07.2015 "Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmsëm 2016-2018" nuk mbulojnë kërkesat e Institucionit duke kërkuar shtesa sipas nevojave të paraqitura si më poshtë vijon:
Mbi planifikimin e fondit buxhetor për punonjësit me kontratë të përkohshme pune për vitin 2017 dhe 2018 është kërkuar fond shtesë në zërin 600 dhe 601 ku përkatësisht në shumat 21,483 mijë lekë dhe 37,272 mijë lekë.
Shpenzime për investime qe INSTAT parashikon të kryejë në vitin 2016 janë 13.5 milion lekë, ku si rezultat janë kërkuar fonde shtesë në shumën 6.5 milion lekë "Blerje pasije Chiller"
Per vitet 2016, 2017 dhe 2018 është kërkuar palësim fondi në shpenzimet operative (602), përkatësisht në shkumat 23,086 mije lekë, 15,280 mijë lekë dhe 12,779 mijë lekë
Shpenzimet për investimet e INSTAT-it parashikohen të kryhen për vitin 2017 në vlerën 7 milion lekë.

Sa më sipër, totali i shpenzimeve për vitin 2016 shkon në 1,218,300 mijë lekë duke pasur nje tejkalim ne vlerën 148,300 mijë lekë mbi tavanet e miratuara në vlerën 1,070,000 mijë lekë.

Për vitin 2017
Në zbatim të Ligjit nr.9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesme", INSTATI ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim. Kërkesat buxhetore përfundimtare për fazën e parë të PBA-së, janë dërguar në Ministrinë e Financave shkresërisht ,me shkresën nr. 433/2 prot., datë 25.04.2016 "Dërgohen kërkesat buxhetore të INSTAT-it për fazën e parë të PBA-së 2017-2019", brenda aftit ligjor i cili është deri më datë 01 Maj 2016; Institui i statistikave me shkresën nr. 433/6 prot. datë 31.08.2015 drejtuar Ministrisë së Financës ka dërguar dokumentin e rishikuar të PBA 2016 – 2018 (faza e II) përfshirë kërkesat shtesë dhe relacionet përkatëse sipas programi buxhetor Veprimtaria Statistikore sipas VKM nr. 230, datë 30.03.2016 "Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmsëm 2017-2019" nuk mbulojnë kërkesat e Institucionit duke kërkuar shtesa sipas nevojave të paraqitura si më poshtë vijon:
Mbi planifikimin e fondit buxhetor për punonjësit me kontratë të përkohshme pune për vitin 2017 dhe 2018 dhe 2019 është kërkuar fond shtesë në zërin 600 dhe 601 ku përkatësisht në shumat 68,832 mijë lekë, 60,670 mijë lekë dhe 43,740 mijë lekë.
Shpenzimet për investimet e INSTAT-it parashikohen të kryhen për vitin 2017 në vlerën 7 milion lekë.

Nga auitimi i Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm, për periudhën objekt auditimit grupi i auditimit konstatoi se hartimi i programit buxhetor afatmesëm ka mangesi në trajtimin e saj. Programi buxhetor afatmesëm duhet të përmbajë qëllimin e politikave të programve, objektivat e plotikivae të programve, projektet e investimeve publike produketet e programeve dhe kostot e tyre respketive. Referuar ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 i ndryshuar "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në mbështetje udhëzimit nr. 8 datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem". Në kërkesat shtësë ku intitucioni parashikon për investime apo shërbime operative në të cilat mungojnë relacionet shpjeguese ne vlera sasiore dhe cilësore dhe disa formatet për argumentimin për kërkesat shtesë të PBA-së ku saktësisht për vitin 2015, formati mbi argumentimin e shtesës së kërkuar për numrin e anketuesve në vlerën 18,710 dhe për vitin 2016 formati mbi argumentimin e shtesës për inevstimin "blerje paisje chiller" në vlerën 6.5 milion lekë.

Pika 2. Zbatimi i buxhetit gjatë vitit 2015, 2016 dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar.
Zbatimi i buxhetit mbështetet në ligjin e buxhetit vjetor, shkresat e Ministrisë së Financave për akordimin e tyre, si dhe në udhëzimet për zbatimin e tij nga Ministria e Financave që del çdo vit. Nga Dega e Buxhet-Financës ndiqet realizimi i buxhetit për çdo muaj, sipas evidencave të dërguara. Për një menaxhim sa më të mirë të buxhetit, ose në rastet e rishikimit të tij me ligj kryhen rishpërndarjet e fondeve në përputhje me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për

Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe udhëzimet e miratuara nga Ministri i Financave
Nga auditimi mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, u konstatua se:
Për periudhën objekt auditimi, janë hartuar projekt dhe planet e buxheteve të cilat i janë dërguar Ministris së Financës dhe Degës së Thesarit.
Instituti i statistikave administron një program, Veprimtaria Statistikore. Ndarja e plan buxheteve dhe detajimet e tyre janë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli dhe është respektuar disiplina buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Janë respektuat procedurat për programimin e buxhetit dhe çeljen e fondeve në Degën e Thesarit. Treguesit e buxhetit, janë mbajtur tek llogaria e Thesarit.

Për vitin 2015.
-Me shkresën nr.18082/109 prot., datë 09.01.2015 është dëguar detajimi i buxhetit per shpenzimet korente dhe shkresën nr. 8823/14 prot. Datë 05.01.2015 është dërguar miratimi i detajimit për investimet e INSTATIT për vitin 2015 sipas artikujve buxhetor, me të dhënat sipas pasqyrës që vijon:

Programi	Kapitulli	Llogari ekonomike	Debite Lekë	Emërtimi i projektit
1320	01	6000000	269,386,000	Pagat
1320	01	6010000	44,879,000	Kontributi i sigurimeve shoqerore
1320	01	6020000	105,105,000	Mallra & Sherbime
1320	01	6040000	550,000	Transferta korente te brendshme
1320	05	6000000	12,387,000	Paga (Kontrata me Banken e Shqiperise)
1320	05	6010000	2,113,000	Kontributi i sigurimeve
1320	05	6020000	650,000	Mallra & sherbime
1320	01	2300000	6.500.000	Licence
1320	01	2310000	500.000	TVSH
GRAND TOTAL			442.070.000	

Referuar shpenzimeve korrente dhe kapitale, Instituti i statistikave për vitin 2015 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm për vitin 2015-2017, në vlerën 501,210 mijë lekë ku të ndara sipas shpenzimeve, shpenzimet korente zënë 97 % ndërsa 3% të dyre i zënë shpenzimet kapitale. Sipas ligjit nr.160/2014 "Për buxheti e vitit 2015" është miratuar në vlerën 485,230 mijë lekë. Referuar aktit normativ, shpenzimet korrente dhe kapitale kanë patur një rënie të ndjeshme në vlerën 100,808 mijë lekë. Fakti i realizimit të shpenzimeve korrentë dhe kapitale ne fund te vitit ushtrimor rezulton 361,179 mijë lekë.

Viti 2015



Ndryshimet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e rialokimeve, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe ndryshimeve me aktet normative. Argumentimi i kërkesave për transferime dhe ndryshime, shtesa dhe pakësime është si më poshtë vijon:

- Me shkresën nr. 363 prot. Datë 25.02.2015, drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, turizmit, tregëtisë dhe Sipëermarrjes nga INSTAT-i është kërkuar rishpërndarje e fondeve për investim, për të mbuluar detyrimin lokal TVSH i lindur nga marrëveshja e vitit të kaluar me Suedinë. Vlera totale për mbulimin e TVSH është 1,189,000 lekë. Me shkresën 3558/1 datë 12.03.2015 është miratuar nga Ministria e Financës ky rialokim.
- Me shkresën nr. 484 prot. Datë 27.03.2015 është kërkuar nga Instati përdorimi i fondit të vecantë, për transferimin e shumës 67.460 lekë për dalje në pension dhe rast vdekje. Me shkresën nr 5319/1 datë 09.04.2015 është akorduar përdorimi i fondit të vecante nga Ministria e Financës për rasrin e lartëpërmendur.
- Me shkresën nr. 483/1 prot. Datë 02.04.2015 është kërkuar nga INSTAT-i përdorimi i fondit të vecantë për rast sëmundjeje për ndërhyrje shëndetësore në vlerën 50.000 lekë. Me shkresën nr 5319/1 datë 09.04.2015 është akorduar përdorimi i fondit të vecante nga Ministria e Financës për rasrin e lartëpërmendur.
-Me shkresën nr.936 prot. Datë 05.07.2015 nga ana e institucionit është kërkuar transferimi i shumës 56.500 lekë për dalje në pension. Me shkresën nr.10817/1 prot datë 30.07.2015 është akorduar fondi për përdorimin e fondit të vecantë nga Ministri a e Financës për rastin e sipërpërmendur
-Me shkresën nr.1228 prot. Datë 23.10.2015 është kërkuar transferimi i fondit nga lloagria 600 (paga) në vlerën 1,920,000 lekë dhe vlerën 380,000 e llogarisë 601 (sigurime) në llogarinë 602 referuar udhëzimit te përbashkët të Ministrisë së Financës dhe INSTAT-it "Për caktimin e nurmit të punonjëse me kontratë nga Instituti i Statistikave". Me shkresën nr 149131 prot. Datë 30.102015 është miratuar rialokimi i fondeve për shpenzimet korrente nga Ministria e Fiancës.

_Me shkresën nr.11546/30 prot. datë17.08.2015 nga Ministria e Finances është miratuar detajimi i ndryshimeve të Aktit Normativ për pakësim në vlerën 60.000.000 lekë për sa i përket ndryshimeve të planit për shpenzimet korrente.
- Në mbështetje të Aktit normativ numër 1 datë 29.07.2015 ka ndodhur shtesë fondi në masën 16,192,000 lekë në zërin investime (llog 231) për inevstimin Chiller dhe TVSH.
-Me shkresën nr.1390 prot. Datë 24.12.2015 drejtuar Ministrisë së Financës pakësimi i fondit pëe zërin 600 (paga) në vlerën 26,000,000 lekë për zërin 601 (sigurime) në vlerën 5,000,000 lekë për zërin 602 (mallra &shërbime) në vlerën 26,000,000 lekë dhe për zërin 600 (paga) në kapitullin 5 në vlerën 1,000,000 lekë
-Me shkresën nr.18004/27 datë 31.12.2015 Ministria e financës mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.3 datë 28.12.2015 ka miratuar detajimin e ndryshimeve të planit të buxhetit, në vlerën 26,000,000 në zërin 600 (paga), në vlerën 5,000,000 lekë në zërin 601 (sigurime) dhe në vlerën 26,000,000 më zërin 602 (mallra & shërbime)
- Me shkresën nr 11546/166 prot. Datë 21.10.2015 INSTAT-i ka dërguar Ministrisë së Financës, mbështëtur në Aktin Normativ pasqyrën e detajimit të buxhetit mbi shpenzimet operative në vlerën 7,500,000 leke për investimin CHILLER dhe në vlerën 8,692,000 për TVSH.
Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2015, grupi i auditimit konstatoi se rishperndarja e fondeve nga ana e INSTAT-it është kryer duke zbatuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"i ndryshuar por lidhur me hartimin e kërkesave për fonde shtesë apo rishpëndarje fondesh mungon analiza specifike e arsyes së kësaj kërkesë në kundërshtim me pikën 74 të udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"i ndryshuar i cili citon se "Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat".
Nga verifikimi i realizimit faktit të buxhetit për vitin 2015, konstatojmë së është realizuar në total vlera prej 321,939,000 lekë ose 73% ndaj planit fillestar (i miratuar me ligjin 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015") ose 97 % ndaj planit përfundimtar (i miratuar me Aktin Normativ nr.3 datë 28.12.2015). Sipas artikujve shpenzimet INSTAT janë realizuar, si më poshtë vijon:
Sipas të dhënave të pasqyrës rezultoi se:

Programi	Art.	Emertimi	2015			
			Planifikim fillestar	Planifikimi perfundimtar	Realizim	%
		Veprimtaria Statistikore				
1320	600	Paga	269,386	213,386	213,284	99%
1320	601	sig. Shoqerore & shendetesore	44,879	34,879	34,760	99,6%
1320	602	Mallra & sherbime te tjera	105,105	54,105	52,378	96,8%
1320	604	Transferta korrente te brendshme	550	550	195	35,4%
1320	606	Transferta buxhetesh familjare		448	448	100%
1320	600	Pagat nga te ardhurat	12,387	5,967	5,643	94%
1320	601	Sigurimet nga te ardhurat	2,113	933	875	96,4%
1320	602	Shpenzime operative nga te ardhurat	650	8,250	7,954	71.7%
1320	230	Aktive te qendrueshme te patrupezuara		5,311		0.0%
1320	231	Investime	7,000	17,881	6,401	35%
		Totali	442,070	341,710	321,939	97%

Zëri i pagave (llogaria 600) është realizuar në masën 99% kundrejt planit përfundimtar dhe 79% kundrejt planit buxhetor fillestar.
Mbi shpenzimet për sigurimet shoqërore (llogaria 601) është realizuar në masën 99,6 % kundrejt planit përfundimtar, dhe 77,4% kundrejt planit buxhetor fillestar.
Mbi transfertat korrente të brendshme (llogaria 604) realizimi kundrejt planit përfundimtar rezulton në masën 35,4 % ashtu si dhe krahasuar me planin buxhetor fillestar duke krijuar një mosrealizim ne vlerën 355 mijë lekë. Ky mos realizim ka ardhur si rezultat i mos marrjes pjesë në mbledhjet e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës gjithashtu dhe si rezultat i mos realizimit të numrit të mbledhjeve.
Realizimi i investimeve (llogaria 231), arrin në masën 35 % kundrejt planifikimit përfundmtar, në vlerën 18.6 miluion lekë. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mos kryerjes së procesit të tenderimit të blerjes së licencave në vlerën 5.3 milion lëkë dhe vlera e mbetur prej 2.8 milion lekë vjen si rezultat i ofrimit në procesin e tenderimit, cmim më të ulët të blerjes së chillerit nga 7.5 milion lekë në vlerën 4.7 milion lekë. Për shkak të firmosjes me vonesë të marrëveshjes ndërmjet Institutit të statistikave dhe qeverisë Suedeze (Marrëveshja Sida) për projektin "Zhvillimi i Infrastrukturës IT të INSTAT, kemi një mosrealizim të pagesës së TVSH në vlerën 8.7 milion lekë.

Për vitin 2016.
-Me shkresën nr. 17761/83 prot., datë 07.01.2016 është dëguar miratimi i detajimi i buxhetit per shpenzimet korente dhe shkresën nr. 489/1 prot. Datë 28.01.2016 drejtuar degës së thesarit është miratuar detajimi i investimeve për vitin 2016 në shumen 23,000,000 mije lëkë ku sipas artikujve buxhetor, të dhënat janë pasqyrohen si më poshtë vijon:

Programi	Llogari ekonomike	Debite Lekë	Emërtimi i projektit
1320	6000000	257,277,000	Pagat
1320	6010000	42,478,000	Kontributi i sigurimeve shoqerore
1320	6020000	74,109,000	Mallra & Sherbime
1320	6040000	1,014,000	Transferta korrente te brendshme
1320	6000000	6,800,000	Paga (Kontrata e Bankes së Shqipërisë)
1320	6010000	1,140,000	Kontributi i Sigurimeve shoqerore BSH
1320	6020000	8,260,000	Mallra dhe shërbime
1320	2310000	1,200,000	Blerje paisje kompjuterike
1320	2310000	16,000,000	TVSH
1320	2310000	5,800,000	Blerje licence
	Totali		

Referuar shpenzimeve korrente dhe kapitale, INSTAT për vitin 2016 ka bërë një parashikim në planifikimin e Buxhetit afatmesëm për vitin 2016-2018, në vlerën 579,114,000 lekë. Sipas ligjit nr.160/2014 "Për buxheti e vitit 2015" është miratuar në vlerën 558,774,000 lekë. Referuar aktit normativ, shpenzimet korrente dhe kapitale kanë patur një rënie në vlerën 77,915,000 lekë. Fakti i realizimit të shpenzimeve korrentë dhe kapitale ne fund te vitit ushtrimor rezulton 447,047,000 lekë.
Më pas, gjatë vitit janë bërë ndryshime si më poshtë:

Viti 2016



Ndryshimet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e rialokimeve, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe ndryshimeve me aktet normative. Argumentimi i kërkesave për transferime dhe ndryshime, shtesa dhe pakësime është si më poshtë vijon:
Me shkresën nr. 12/1 datë 12.01.2016 është kërkuar nga INSTAT-i transferim fondesh buxhetore në zurën rajonale Dibër, në vlërën 52,000 lekë në zërin 600 dhe në vlerën 5,000 lekë në zërin 601. Kjo kërkesë është miratuar nga Ministria e financës me shkresën nr.624/1 datë 26.01.2016
Me shkresën nr 3267/1 prot datë 09.3.2016 nga Ministria e Financës është akorduar përdorimi i fondit të vecantë për organizimin e një aktiviteti me rastin e 8 Marsit, për 130 punonjës në vlerën 325,000 lekë
Me shkresën nr.4696/1 prot datë 12.04.2016 është akorduar nga Ministria e Financës fondi në vlerën 30.000 lekë për përdorimin e fondit të vecantë për dhenie pagese për rast fatkeqësie.
Me shkresën nr.5715/1 prot. Datë 05.05.2016 është akorduar nga Ministria e Financës fondi për përdorimin e fondit të vecante, në vlerën 30.000 lekë pëe ndihmë një punonjësi për rast fatkeqësie.
Me shkresën nr. 14092/1 datë 17.10.2016 është miratuar nga ministria e Financës rialokimi i fondeve për shpenzime korrente në vlerën 1,4000,000 lekë në zërin 602 (mallra&shërbime).
Me shkresën nr.17366/60 datë 27.12.2016, mbështetur në aktin normativ nr.2, datë 16.12.2016, është pakesuar fondi për shpenzimet kapitale, në vlerën 8,352,000 në llogarin 231, per rimbursim TVSH.
Me shkresën nr. 17561/1, datë 29.12.2016 është akorduar nga ministria e finances për përdorim fondi të vecantë për rast vdekje dhe tre raste dalje në pension, në vlerën 334,000 lekë.

Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2016, grupi i auditimit konstatoi se rishperndarja e fondeve nga ana e INSTAT-it është kryer duke zbatuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"i ndryshuar por lidhur me hartimin e kërkesave për fonde shtesë apo rishpëndarje fondesh mungon analiza specifike e arsyes së kësaj kërkesë në kundërshtim me pikën 74 të udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"i ndryshuar i cili citon se "Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat".

Pasqyra e realizimit të buxhetit për vitin 2016, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, Tiranë paraqitet si më poshtë:
Nga verifikimi i realizimit faktit të buxhetit për vitin 2016, konstatojmë së është realizuar në total vlera prej 327,428,000 lekë, ku ka rezultuar e realizuar prej 79 % ndaj planit fillestar (ligjit nr.147/2015 datë 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016"") ose nje realizim prej 97 % ndaj planit përfundimtar (i miratuar me aktin normativ nr.2 datë 16.12.2016). Sipas artikujve shpenzimet kirrente dhe shpenzimet kapitale janë realizuar, si më poshtë vijon

Programi	Art.	Emertimi	2016			
			Planifikim fillestar	Planifikimi perfundimtar	Realizim	%
		Veprimtaria Statistikore				
1320	600	Paga	257,277	210,525	209,848	99.7%
1320	601	sig. Shoqerore & shendetesore	42,478	35,473	35,120	99%
1320	602	Mallra & sherbime te tjera	74,109	58,434	53,236	91%
1320	604	Transferta korrente te brendshme	1,014	1,014	305	30%
1320	606	Transferta buxhetesh familjare		615	528	85%
1320	600	Pagat nga te ardhurat	6,800	5,550	5,550	100%
1320	601	Sigurimet nga te ardhurat	1,140	990	989	99.8%
1320	602	Shpenzime operative nga te ardhurat	8,260	10,260	10,254	99.9%
1320	230	Aktive te qendrueshme te patrupezuara	5,800	5800	3,947	68%%
1320	231	Investime	17,200	8848	7,651	86.4%
		Totali	414,078	337,509	327,428	97%

Sipas të dhënave të pasqyrës:
Në analizë të realizimit të zërave të shpenzimeve vërehet se zeri i pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600 dh 601) për programin veprimtari statistikore është realizuar në masën 99.7% per zërin e pagave dhe 99% për zerin e sigurimeve shoqërore & shëndetësore dhe krahasuar me planin fillestar zëri i pagave dhe sigurime (llogaria ekonomike 600 dhe 601) janë realizuar në masën 81,5% dhe 82,6 %.
Shpenzimet operative (llogaria 602), realizimi faktit krahasuar me buxhetin përfundimtar ka një masë realizimi prej 91% dhe krahasuar me planifikimin fillestar është realizuar në masën 71 %.
Mbi transfertat korrente të brendshme (llogaria 604) realizimi kundrejt planit përfundimtar rezulton në masën 30 % ashtu si dhe krahasuar me planin buxhetor fillestar duke krijuar një mosrealizim ne vlerën 709 mijë lekë. Ky mos realizim ka ardhur si rezultat i mos pjesëmarrjes në mbledhje të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe Këshillit të Nomeklaturës si dhe mos realizimit të numrit të mbledhjeve si dhe të tërheqjes nga pagesa e një anetari të Këshillit Mbikqyrës.
Realizimi i investimeve (llogaria 231), arrin në masën 79.2% kundrejt planifikimit përfundmtar, duke krijuar një mosrealizim në vlerën 3 milion lekë. Ky mos realizim ka ardhur si rezultat i ofrimit në procesin e tenderimit çmim më të ulët të blerjes së licencave në shumë 1.9 milion lekë dhe paisjeve kompjuterike në vlerën 1 milion lekë .

Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit konstatohet se programimi është prekur nga Aktet Normative si në vitin 2015 dhe në vitin 2016, gjithashtu shikojme se Planifikimi i Buxhetit Afatmesëm nuk i referohet vitit parardhës për të minimizuar ndryshimet e ndjeshme të cilat ndodhin kur perballemi me faktin në fund të vitit duke krijuar kështu mosrealizim të shpenzimeve korrente dhe kapitale. Strukturat drejtuese të INSTAT-it, dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por

dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.

Mbi monitroimin e menaxhimi të shpenzimeve publike, reflektimi në raportet e monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit kundrejt kuotave të planifikuara në nivel prgrami.
Për cdo vit (2015,2016,2017) INSTAT ka hartuar raportet e monitorimit, të cilat janë të konfirmuara nga drejtuesit e programeve. Në zbatim të UMF nr.2, dt. 26.02.2012 "Për proedurat standarde të zbatimi të buxhetit", UMF nr.2, dt. 09.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015" dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financës nr.1 dt. 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016" raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi janë hartuar në mënyrë progresive dhe brenda afateve janë dërguar në Ministrinë e Financës cdo 3 muaj dhe në funad të vitit me shkresat:
Me shkresën nr. 620/3 dt. 29.01.2016 është derguar MF raporti i monitorimit të ecurisë së zbatimit të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2015
Me shkresën nr. 615/3 datë 31.01.2017 është dërguar MF raporti i monitorimit të ecurisë së zbatimit të buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2016.
....2017 3 mujori i parë
Raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi, si dhe raportet periodike që institucioni i ka paraqitur në Ministrinë e Financës, nuk janë plotësuar me një infromacion të plotë me shpejgimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel artikulli, lidhur më ndryshimet e planit të produktece si në sasi ashtu edhe në vlerë në kundërshtim me pikën 79 të udhëzimin plotësues nr. 1, dt. 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016" i cili citon se "Raporti i monitorimit për vitin 2015, si edhe raportet periodike gjatë vitit 2016, që ministritë dhe institucionet do të paraqesin në Ministrinë e Financave, duhet të plotësohen me informacionin si më poshtë, shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, Argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashi-kohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve, duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara, të dhënat përkatëse për realizimin e financimit të huaj, si edhe analiza e tyre, raportimi mbi shumat e shpenzimeve të realizuara nga të ardhurat jashtë limitit, i shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse lidhur me përdorimin e këtyre të ardhurave, të gjitha shpjegimet e mësipërme lidhur me performancën e produkteve duhet të paraqiten të lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit"
Mungojnë argumentat e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikojnë në të ardhmen për realizimin e tyre.
Performanca e produketeve duhet të paraqitej e lidhur me relizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e programit si dhe si janë realizuar këto objektiva.
Raporti i monitorimit është për periudhën objekt auditimi është paraqitur në MF, brenda dartës 15 shkurt të vitit përkatës.

Raportet e monitorimittë buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financës nëpërmjet lidhjes së vendosur në faqet zyrtare të Institucioneve.

Realizimi i të ardhurave për vitin ushtrimor 2015, 2016 dhe 4- mujori i 2017

Instituti i Statistikave realizon të ardhura nga shërbimi i cili kryen për Bankën e Shqipërisë ku objekti i kontratës është ti sigurojë B.SH kryerjen e vrojtimeve dhe informacioneve statistikor, për periudhën objekt auditimi sipas kërkesave për vrojtim të specifukuara prej tij. INSTAT kryen shërbim për Bankën e Shqipërisë për mbledhjen e informacionit statistikor sipas kushteve të parashikuara në kontratat e përvitshme, në vitet 2003 - 2017. Të ardhurat e krijuara nga ky shërbim përdoren bazuar në VKM nr. 432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore" si dhe Udhëzimit të përbashkët Nr.1, datë 11.10.2006 të Ministrisë së Financave, nënshkruar nga Ministri i Financave me shkresën Nr.3423/1 Prot, datë 23.05.2007 ku referuar këtij udhëzimi Instati ka të drejtë të përdori 90% të të ardhurave dhe 10 % ti derdhi në buxhetin e shtetit. Githashtu, për periudhen objekt auditimi INSTAT ka marre fonde nga donator te ndryshem ku përkatësisht për vitin 2015, nga Gopa consultans në vlerën 2,270 mijë lekë, nga AMF në vlerën 2,104 mijë lekë ne një total prej 4,374 mijë lekë dhe për vitin 2016 nga Gopa në vlerën 8,277 mijë lekë, nga UNDP në vlerën 3,975 mijë lekë duke arritur një total prej 12,252 mijë lekë, te ardhura jasht limitit te cilat jane te ardhura qe trashegohen ne vitin pasardhes. Aktivitetet që zbatohen në këto projekte midis të tjerash përfshijnë projekte pilote në Statistikat makro-ekonomike (llogaritë kombëtare, llogaritë tremujore kombëtare dhe llogaritë rajonale), Statistikat e çmimeve (PPP dhe IÇK), Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Statistikat Bujqësore Statistikat agro-monetare, Statistikat mbi kulturat dhe në prodhimin e kafshëve, Statistikat Sociale (të ardhurat dhe kushtet e jetesës, anketat e buxhetit familjar), Statistikat e Mjedisit (Statistika mbi ujin dhe mbeturinat) dhe Statistika te Biznesit (Statistikat Strukturore të Biznesit dhe Regjistrat e Biznesit). Te ardhurat jasht limitit te realizuara nga donatoret per vitin 2015 jane 4,374 mije leke dhe për vitin 2016 jane 12,252 mije leke. Shpenzimet e realizuara nga keto te ardhura per vitin 2015 jane 5,485 mije leke dhe ne vitin 2016 jane 4,466 mije leke
Realizimi i të ardhurave dytësore për vitet 2015-2016 paraqitet si më poshtë :
Në mijë lekë

		2015		2016	
Art	TE ARDHURAT	PLAN	FAKT	PLAN	FAKT
7	Te ardhura dytësore	16,800	23,890	18,666	32,685

Nga të dhënat e mësipërme shikojm një tejkalim të krijimit të të ardhurave kundrejt planifikimit të tyre, si për vitin 2015 dhe vitin 2016 dhe kjo ka ardhur si rezultat i shtimit të vrojtimeve të kërkuara nga Banka e Shqipërisë. Përkatësisht për vitin 2015 kemi një realizim të të ardhurave dytësore në vlerën 23,890 mijë lekë, me një tejkalim prej 142% mbi planifikimin e tyre. Për vitin 2016 krmi një realizim të të ardhurave dytësore në vlerën 32,685 mijë lekë, me një tejkalim prej 175% mbi planifikimin e tyre. Referuar kontratës së lidhur me BSH si dhe referuar shërbimeve të kërkuara prej saj, më poshtë rendisim shërbimet dhe vlerat përkatëse për secilin prej tyre të

Banka Shqiperise	Arketuar 2015	Arketuar. 2016
1. Vrojtimi i Investimeve të Huaja Direkte (sasior)	540000	720000
2. Sherbimet e udhetimit	1280000	6080000
3. Vrojtimi i Dërgesave të Emigrantëve	2400000	2400000
4. Vrojtimi i tregut të pasurive të palujtshme	184000	368000
5. Vrojtimi mbi situatën financiare dhe të borxhit të Korporatave në Shqipëri	1680000	2280000
6. Vrojtimi mbi gjëndjen financiare dhe të borxhit pranë Familjeve	2640000	2640000
7.Vrojtimi i Besimit të Bisnesit për sektorët e manifakturës,ndërtimit dhe shërbimeve	3600000	1800000
8. matja e kosto IPB	630000	2160000
9. matja e kosto IPI	896400	5276088
10. Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit (cilësor)	4320000	8961624
11. Matja e kultures financiare	1320000	
12.Vrojtimi tregtise jashme	400000	
13. Vrojtimi i Turizmit	4000000	
Totali	23.890.400	32.685.712

Shpenzimet e realizuara nga këto të ardhura për vitet 2015-2016 paraqiten si më poshtë :
Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2015 janë shpenzuar në total 14,742 mijë lekë (ose rreth 96% ndaj planit përfundimtar), dhe për vitin 2016 janë shpenzuar në total 16, 793 mijë lekë të shpërndara mes llogarive si më poshtë:

Në mijë lekë

Art.	SHPENZIMET	2015		2015	2016		2016
		Plan	Fakt	REAL %	Plan	Fakt	REAL %
600	Paga nga te ardhurat	5,967	5,643	95	5,55	5,55	100
601	Sigurime Shoqerore nga te ardhurat	933	875	94	990	989	100
602	Shpenzime operative nga te ardhurat	8,25	7,954	96	10,26	10,254	100
	SHUMA	15,15	14,472	96	16,8	16,793	100

Sic edhe vihet re nga tabela e mësipërme, shpenzimet për pagat gjatë vitit 2015 rezultojnë 5,643 mijë lekë duke pasur një realizim prej 95 % kurndrejt planifikimit të tyre. Shpenzimet për sigurimet shoqerore konsitojnë në vlerën 875 mijë lekë, duke cuar në një realizim prej 94 % kundrejt planifikimit të tyre. Mosrealizimi i tyre ka ardhur si pasojë e mos plotësimit të vëndeve të anketuesve për shërbimin përkatës.
Shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 7,954 mijë lekë, pra 96 % referuar planifikimit të tyre, në të cilat perfshihen pagesat e anketuesve me kontratë shërbimi, ku sipas udhëzimit nr. 2453/1 dt. 19.02.2015 të përbashkët me Ministrinë e Financës "Për caktimin e nurmit të

punonjësve me kontratë nga Instituti i statistikave" janë paguar anketuesit të cilët kanë kryer sherbimin per jo më shumë se 18 ditë pune në muaj, sipas udhëzimit të sipërpërmendur.
Auditimi u krye duke kryqëzuar informacionin e gjeneruar nga pasqyrat financiare, me të dhënat për zërat respektivë në situacionin e shpenzimeve, si edhe diferencat për shpenzimet e dhjetorit të vitit paraardhës me dhjetorin e vitit ushtrimor korent.

IV. II/b. Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave (*plan, fakt dhe në %)* dhe krahasimi me vitet e kaluara, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Përputhshmëria ligjore e krijimit dhe përdorimit të fondit të veçantë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

- Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave.
Në Institutin e Statistikave, organizimi dhe funksionimi mbështet në ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004, "*Për Statistikat"* i ndryshuar, ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave" si dhe në ligjin nr. 90/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"*. Bazuar në këtë legjislacion, organizimi i brendshëm i INSTAT, për periudhën objekt auditivi është bërë mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me urdhër të Kryeministrit 147, datë 24.12.2012, nr. 126, datë 10.09.2015, nr. 28, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave " dhe të pasqyruar në Rregulloren e Brendshme.
Konstatohet se, institucioni për periudhën objekt auditimi, nga data 01.01.2015 deri më datë 09.01.2017, ka funksionuar në zbatim të rregullores, *"Rregullore e Brendshme e Veprimtarisë së INSTAT"*, protokolluar me nr. 462 prot., datë 18.04.2013. Më datë 10.01.2017 është miratuar Rregulloren e Brendshme "*Për Veprimtarinë dhe Funksionimin e INSTAT"*, protokolluar me nr. 39 prot., datë 10.01.2017.
Nga përmbajtja e rregullores së Brendshme të Institucionit, rezulton se janë evidentuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushin pozicionet e punës në nivelet Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie, Këshillin e Statistikave në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, që materializohen në përshkrimin e punës. Në këtë rregullore nuk janë evidentuar detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil si dhe për pozicionin e kordinatorit .

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se për periudhën 01.01.2015 deri më 10.09.2015, INSTAT është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin 147, datë 24.12.2012. Bazuar në këtë strukturë organizative institucioni ka **235** punonjës të miratuar nga të cilat 191 në aparat dhe 44 në zyrat rajonale. Kjo strukturë ka pësuar ndryshim me vendimin nr. 282, datë 01.04.2015, "Rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2015", të Kryeministrit, i cili e ka pakësuar numrin e punonjësve me 20 veta, duke shkuar në 216 punonjës gjithsej. Ndërsa për periudhën 11.09.2015 deri më 08.01.2017, INSTAT është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 126, datë 10.09.2015, të Kryeministrit "*Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së institutit të Statistikave*". Bazuar në këtë strukturë organizative institucioni ka **216** veta të miratuar nga të cilat 171 në aparat dhe 45 në zyrat

rajonale. Për aparatin e institucionit, mbështetur në strukturën dhe organikën e miratuar pozicionet e punës deri më 10.09.2015 janë si më poshtë:

- Drejtor i Përgjithshëm 1
- Drejtor Drejtorie 8
- Përgjegjës Sektori 39
- Specialist 96
- Punonjës mbështetës 27

Ndryshimi i strukturës me urdhrin nr. 126, datë 10.09.2015 ka mundësuar uljen e sektorëve nga 39 në 35, të numrit të punonjësve me kontratë nga 27 veta në 17 veta, në rritje të numrit të specialistëve nga 96 në 108 si dhe shtimin e 2 koordinatorëve.
Në strukturë 180 punonjës i rregullojnë marrëdhëniet e punës me ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, si dhe 10 prej tyre me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".

- Mbi realizimin e fondit të pagave dhe respektimi i strukturës organike të miratuar.
Nga auditimi rezulton se, në institutin e Statistikave për vitin 2015 fondi i pagave është realizuar në masën 99.9%, për vitin 2016 në masën 99.69% dhe për tremujorin e parë të vitit 2017 në masën 100%.
Realizimi i fondit të pagave në vlerat e mësipërm ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të numrit të punonjësve, pasi për vitin 2015 në krahasim me organikën institucioni ka punuar me mesatarisht 15 punonjës më pak, për vitin 2016 me 25 punonjës si dhe për tremujorin e parë të vitit 2017 me 28 punonjës më pak. Sigurimet shoqërore për vitin 2015 janë realizuar në masën 100%, për vitin 2016 në masën 99, ndërsa për tremujorin e parë të vitit 2017 në masën 100%. të dhënat paraqiten në tabelën nr. 1 dhe nr. 2.

Tabela nr.1 Mbi realizimin e numrit të punonjësve dhe fondin e pagave

Nr	VITI	Nr. Punonjsve ne strukture		Fondi i pagave strukture		% realizimit
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar	
1	2015	184	162	118,900	118,841	99.9
2	2016	171	146	110,000	109,663	99.69
3	***Trem. 2017***	***171***	***143***	***131,000***	***26,814***	***100***

Burimi: Të dhënat e tabelës janë marrë nga sektori i financës dhe përpunuar nga audituesi

Numri i punonjësve sipas lisë pagesave për çdo muaj dhe paga bruto e tyre, është realizuar:

Tabela nr. 2 Mbi numrin e punonjësve dhe pagën bruto në/lekë

	Muaji	Viti 2015			Viti 2016			Tre/mujori Viti 2017		
		Nr.	fakt	Paga bruto /lekë	Nr.	fakt	Paga bruto /lekë	Nr.	fakt	Paga bruto /lekë
1	03.Janar	191	169	10, 152,706	171	157	9,608,761	171	142	8,720,539
2	Shkurt	191	169	10,194,614	171	149	9,344,121	171	144	9,077,362
3	Mars	191	167	10,176,290	171	146	9,456,224	171	144	9,016,169
4	Prill	191	164	9,927,745	171	147	9,387,320			
5	Maj	171	162	9,835,417	171	145	9,329,715			

6	Qershor	171	160	9,796,655	171	145	9,705,913			
7	Korrik	171	161	9,836,192	171	146	9,210,351			
8	Gusht	171	162	9,829,775	171	145	9,058,334			
9	Shtator	171	160	9,802,494	171	142	8,703,353			
10	Tetor	171	158	9,655,860	171	140	8,744,099			
11	Nëntor	171	158	9,945,635	171	150	8,554,710			
12	Dhjetor	171	160	9,718,262	171	140	8,552,860			
	Shuma	**2132**	**1950**	**118,844,645**	**2052**	**1752**	**109,663,401**	**513**	**430**	**26,814,070**

(Të dhënat e tabelës janë marrë nga specialisti i financës dhe përpunuar nga audituesi)

Instituti i Statistikave në periudhën objekt auditimi ka të punësuar punonjës me kontratë një vjecare dhe gjashtë mujore për anketime në vitin 2015, kanë punuar mesatarisht 325 anketues nga 386 të planifikuar në vitin 2016, kanë punuar mesatarisht 353 anketues nga 371 të planifikuar. Për këtë kategori punonjësish fondi i pagave për vitin 2015, 2016, është realizuar në masën 99 %.
Në periudhën objekt auditimi në INSTAT janë punësuar punonjës për anketime, me kontrata me afat të shkurtër. (kontrata shërbimi) Në këto anketime kanë punuar mesatarisht 84 anketues në vitin 2015, në vitin 2016 gjithsej 150 anketuaes, si dhe në tremujorin e parë të vitit 2017 mesatarisht 202 anketues.
Për këtë katëgori punonjësish janë mbajtur në mënyrë sistematikë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore conform dispozitave ligjore në fuqi. Të dhënat paraqiten në tabelat, nr. 3,4,5:

Tabela nr.3 Mbi realizimin e numrit të punonjësve dhe fondin e pagave punonjësit me kontratë

Nr	**VITI**	**Nr. Mesatar i punonjësve me kontratë**		**Fondi i pagave për punonjësit me kontrate**		**% realizimit**
		Planifikuar	**Realizuar**	**Planifikuar**	**Realizuar**	
1	2015	386	325	100,453	100,086	99
2	2016	371	353	106,075	105,735	99
3	***Trem. 2017***	***423***	***349***	***94,625***	***23,762***	***100***

(Të dhënat e tabelës janë marrë nga specialisti i financës dhe përpunuar nga audituesi)

Tabela nr.4 Punonjës me kontratë shërbimi 2015-2017

Viti	Nr. mesatar /mujor i punonjësve	Paga/ mijë lekë
2015	84	13,767
2016	150	21,550
2017	202	6,218

Tabela nr.5 ndalesat për sigurime shoqërore e shëndetësore

Nr.	Emertimi i kontratës	Viti	Sig.shoqërore (16.7%)	Sig Shëndetsore (1.7%)
1	Kontratë me afat një vjecar, gjashtë mujor	2015	10,841,146	1,228,663
2	Kontrata me afat të shkurtërshkurtra	2015	3,516,534	398,540
3	Kontratë me afat një vjecar, gjashtë mujor	2016	13,379,740	1,561,704
4	Kontrata me afat të shkurtërshkurtra	2016	2,380,342	269,772
5	Kontratë me afat një vjecar, gjashtë mujor	2017	3,262,086	369,703
6	Kontrata me afat të shkurtërshkurtra	2017	940,490	106,599

(Të dhënat e tabelës janë marrë nga specialisti i financës dhe përpunuar nga audituesi)

- Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi etj.

Fondi i veçantë, është përdorur në zbatim të VKM nr. 369, datë 13.06.2007 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar me VKM nr. 929, datë 17.11.2010 dhe VKM nr. 826, datë 05.12.2011, duke u përdorur pjesërisht kryesisht për rastet e veçanta si, për dalje në pension, nga ku rezulton se janë kryer pagesa në vlerën 647 mijë lëkë, për sëmundje me vlerë 100 mijë lekë, për fatkeqësi në familje gjithsej 320 mijë lekë.

Nga fondi i vecante ne vitin 2016 është përdorur vlera 120 mijë lekë për kryerjen e aktivitetit për punonjësit e administratës. Fondi i veçantë, nuk është përdorur për shpërblimin e punonjësve në fund të çdo viti ushtrimor, të dhënat paraqiten në tabelën nr. 6

Mbi realizimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi.

Tabela nr.6

nr.	EMERTIMI	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
		Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%	Plani	Fakti	%
1	Pagat (600)	219,353	218,927	100	216,075	215,398	99	225,625	50,576	100
2	Sig. Shoqërore (601)	35,812	35,635	100	36,463	36,109	99	41,915	9,097	100
3	Fondi i vecantë	449	449	100	615	528	86			
3/a	Bonus karburanti	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3/b	Shpërblim për punë të mirë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3/c	Shpërblim në fund të vitit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3/d	Për sëmundje	100	100	100						
3/e	Për fatkeqësi	120	120	100	110	110	100	90	90	100
3/f	Për pension	229	229	100	505	418	83			
4	Për aktivitete(602)	0	0	0	325	120	37	0	0	0

- Mbi pagesat për gradë shkencore

Në zbatim të VKM nr. 545, datë 11.8.2011 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë" ndryshuar me VKM nr. 449, datë 11.07.2012 si dhe të udhëzimit nr. 1, datë 16.03.2012, të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në INSTAT për periudhën objekt auditimi është paguar një person me gradë shkencore "Doktor i shkencave", i cili ka në strukturë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Gjithsej shuma e përfituar është në vlerën 75,000 lekë. (3 muaj x 25.000 lekë/muaj për trmujorin e parë 2017)

- Respektimi i dispozitave ligjore për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale.

Nga auditimi i kryer me zgjedhje, për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se për periudhën objekt auditimi, për punonjësit e punësuar në zbatim të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", janë zbatuar dispozitat ligjore

që rregullojnë këtë fushë. Nga audutimi u konstatua përputhshmëri midis vlerës në total të pagës bruto, kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e paraqitur në pasqyrat financiare.

Në lidhje me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit, u konstatua se për çdo punonjës ka dosje të veçantë të plotësuar me dokumentacionin e duhur konform legjislacionit në fuqi si CV, diplomë, listë notash, certifikatë personale, rekomandim, raport mjekësor, librezë pune, certifikatë të gjendjes gjyqësore, vlerësimi etj. Në INSTAT, për periudhën objekt auditimi, janë depozituar vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve në zbatim të 152/2013 "Për nëpunësin civil" si dhe VKM nr. 116, datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil". Regjistri i personelit është plotësuar sipas rubrikave të tij për të gjithë punonjësit ku janë regjistruar të gjitha emërimet, lëvizjet, largimet si për punonjësit në organikë dhe për punonjësit e emëruar me kontratë.
Libri i pagave, për periudhën objekt kontrolli, është plotësuar për të gjithë punonjësit që janë në marrëdhënie pune, ku janë shënuar për çdo muaj të gjitha ekstraktet sipas listë pagesave nga paga bruto, shtesa e ndalesa deri në pagën neto.

- Proceset Gjyqësore
Për periudhën objekt auditimi INSTAT ka ekzekutuar 5 vendime gjyqësore **me vlerë 2,873,323 lekë** për ish punonjësit, që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna, Nga vendimet e ekzekutuara 2 i përkasin vitit 2015 si dhe 3 vendime vitit 2016, nga këto një vendim është për rrikthim në vendin e punës. Në tremujorit të parë të vitit 2017 nuk ka vendime të reja të dala nga proceset gjyqësore të formës së prerë për likuidim.

Për vitin 2015 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore 960,585 lekë, vlerë e cila është paguar nga fondi i akorduar nga INSTAT.

Për vitin 2016 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore është 1,397,373 lekë, vlerë e cil është paguar nga fondi i akorduar nga INSTAT.

Për tremujorin e parë të vitit 2017 vlera në total e mbetur për likuidim nga viti 2016 është 515,365 lekë.

Për periudhën objekt auditimi INSTAT ka likuiduar një person, punonjës i aparatit, i cili ka fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna, me të drejtë rikthimi në vendin e punës, vendim i cili është zbatuar nga ana e INSTAT. **Vlera e likuiduar në total, deri më 31.03.2017, për këtë person është 564,200 lekë.**
Aktualisht INSTAT, ka gjithsej 7 procese gjyqësore për punonjës të cilët janë larguar nga puna në vitin 2015 dhe 2016.

IV. II/c. Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të*

menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejt dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Baza ligjore në auditim:
-Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; "Mbajtja e kontabilitetit" është regjistrimi në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike. "Sistem kontabël" është sistemi që përdoret për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarisë së një njësie ekonomike. "Standarde kontabël" janë parimet ose rregullat e përgjithshme, të shpallura nga një organizëm përgjegjës për normalizimin kontabël, që përcakton ky ligj, të cilat shërbejnë si bazë për zgjedhjen e trajtimeve ose të metodave kontabël, që zbatohen për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Standardet Kontabël Ndërkombëtare (SKN) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)" janë standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Kontabël Ndërkombëtare (IASB). "Evidenca mbështetëse" është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë. Dokumentet bazë përmbajnë regjistrimet fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik; dokumentet plotësuese janë bartës të informacionit të marrë nga dokumentet bazë; regjistrat (librat) kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve ekonomike të kryera, të marra nga dokumentet bazë ose dokumentet plotësuese.
"Bartësi informatik" është çdo dokument i evidencës mbështetëse, i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.
Pasqyrat financiare vjetore, përveç atyre që parashikohen në mënyrë të specifikuar nga standardet kontabël kombëtare, duhet të përmbajnë këto dokumente: bilancin kontabël; pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve; pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta; pasqyrën e rrjedhjes së parasë (cash floë); anekset e pasqyrave financiare, që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues.
-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit", i ndryshuar, si dhe udhëzimet vjetore për zbatimin e buxhetit; UMF nr. 7, datë 11.02.2015 "Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limiteve të angazhimit"; nr. 1, datë 04.06.2014, "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", etj.

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, vendore dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj, etj", ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 10, datë 27.02.2008.
-UMF nr. 22, datë 10.07.2013 "Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit" etj.
Nga auditimi u konstatua se:
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, *"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësive që varen prej tyre*", ndryshuar me UMF nr. 26, dt. 27.12.2007*"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj"*. Bilanci i vitit 2016 është hartuar dhe depozituar më datë 29.01.201 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë.
Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin. Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.
Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar, si dhe i llogarive inventarjale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:
a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.
b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:
Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- *U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;*
- *U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;*
- *U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;*
- *U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.*
- *U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;*
- *U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.*

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.

- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik")*.

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2015 rezultoi:

<u>Në analizë aktivet:</u>

Në formatin nr. 1 "*Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuar*" në vlerën 125,801,629 lekë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
9	21,23,24,28	II. Akt. Qëndrueshme. të Trupëzuara	125,801,629	135,132,960
10	210	Toka, troje, Terrene	0	0
11	211	Pyje, Kullota Plantacione	0	0
12	212	Ndërtime e Konstruksione	67,113,938	67,113,938
13	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	
14	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	13,105,396	9,048,126
15	215	Mjete transporti	20,630,352	20,630,352
16	216	Rezerva shtetërore	0	
17	217	Kafshe pune e prodhimi	0	
18	218	Inventar ekonomik	132,129,875	154,561,946
19	219	Amortizimi aktiv. Qendr. të trupëzuara (-)	-118,493,885	-116,221,402
20	231	Shpenzime proces për rritjen e AQT	0	
21	232	Shpenzime proces për transferime kapitale	0	
22	24	Aktive te Qend. te trupëzuara te dëmtuara	0	
23	28	Caktime	0	

Zëri "*Ndërtime e konstruksione*" (llog. 212) për vlerën 67,113 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri "*instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune*" (llog. 214) për vlerën 13,105 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri *"Mjete transporti*" (llog. 215) është për vlerën 20,630 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. (*Shtatë automjete* autovetura land rover 76-75 a,

autoveture opel 63-10, autoveture frontera opel 0151a, autoveture hynday-07, autoveture ford mondeo tr 37-18, autoveture tojote 26-17, autoveture ford -everest 34-92)
Zëri "*Inventar ekonomik*" (llog. 218) për vlerën 142,947 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.
Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme:
Në formatin 6 kolona 2 "*blerje e krijuar me pagesë*" për vlerën 251,354 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, "*Ndërtime e konstruksione*" në vlerën 67,114 mijë lekë, "*Inventar ekonomik*" në vlerën 154,561 mijë lekë, "*Instalime teknike makineri dhe pajisje*" në vlerën 9,048 "*Mjete transporti*" në vlerën 20,630 mijë lekë.
Kolona 8 pakësime gjatë vitit ushtrimor "*Nxjerrje jashtë përdorimit*" janë pasqyruar pakësime të aktiveve, '*instalime teknike dhe makineri pajisje*" në vlerën 58 mijë lekë "*Inventar ekonomik*" në vlerën 11,614 mijë lekë.

"*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*" (Llog. nr. 219) prej 118,547,757 mijë lekë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.
"*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*" për 13,999,331 mijë lekë është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 dhe është i ndarë në grupe analitike sipas zërave të "*Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara".*

Normat e amortizimit janë përllogaritur sipas VKM nr. 401, datë 23.10.1989 "*Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit*", ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual fiskal *"Për tatimin mbi të ardhurat*" ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur. Normat janë:

15% për studime dhe kërkime;
1% për ndërtesat dhe konstruksionet;
3% për inventarin ekonomik;
25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
6% për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla; dhe
14% për mjetet e transportit.

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë, (*Shtojca nr. 4*):

LLOG EKON	emertimi	Kodi qarkut	GJENDJE 01.01.2015	SHTESA	PAKESIME	GJENDJE 31.12.2015
2192	ndertesa	3535	3.224.294	638.896		3.863.190
219411	makineri paisje	3535	2.515.523	322.253		2.837.776
219512	mjete transporti	3535	14.902.052	790.505		15.692.557
2198100	inventar ekonomik	3535		18.846.149		18.846.149

2198400	fotokopjo	3535	5.046.666		62.731	4.983.935
2198500	fax	3535	1.163.506	865.563		2.029.069
2198600	paisje kompjuterike	3535	70.108.616		534.914	69.573.702
2198700	te tjera paisje	3535	19.260.745		18.539.366	721.379
		Totali	**116.221.402**	**21.463.366**	**19.137.011**	**118.547.757**

Aktivet qarkulluese zëri "*Objekte inventari*" në shumën prej 39,828 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

"*Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët*" (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formati nr. 2 për vlerën 16,695 mijë lekë ku "*Të tjera operacione me shtetin (debitor)"* zënë shumën 15,373 mijë lekë e cila në analizë (*Inventari i llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin" dt. 31.12.2016*) përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2017 si "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" (llog. 401-408) për 779 mijë lekë, "*personeli e llogari të lidhura me to*" (llog. 421-423) për 8,041 mijë lekë, "*Të drejta dhe taksa për tu derdhur në shtet*" (llog. 431) për 988 mijë lekë, për "*sigurime shoqërore*" (llog. 435) në vleftën 2,628 mijë lekë, "*sigurime shëndetësore*" (llog. 436) në vleftën 350 mijë lekë, "*Organizma të tjera shoqërore*" (llog. 437, 438) në vleftën 1,924 mijë, "*Kreditorë të ndryshëm*" (Llog. 467) për 659 mijë lekë.

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
20	Klasa 4	II. Detyrime afatshkurtër	22,746,409	22,545,945
21	419	Klientë (Kreditore), parapagese pjesore	0	
22	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	779,103	562,828
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	8,041,277	12,007,145
24	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	988,702	783,709
25	432	Tatime mbledhura nga shteti për llog. Pusht. Lokal		
26	433	Shteti fatkeqësi natyrore		
27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	1,322,203	1,169,779
28	435	Sigurime shoqërore	2,628,985	2,695,871
29	436	Sigurime shëndetësore	350,969	369,166
30	437-438	Organizma të tjerë shoqërore	1,924,643	1,682,752
31	44	Institucione te tjera publike		
32	45	Marrëdhënie me institucione brenda e jashtë sistemit		
33	460	Huadhënës		
34	464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letra me vlerë		
35	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	6,050,746	5,822,569
36	467	Kreditore të ndryshëm	659,781	1,361,126

Në llog. (466) "*Kreditorë në mjete në ruajtje*" janë pasqyruar në vlerën 6,050 mijë lekë

<u>Në pasiv të bilancit</u> janë paraqitur A/I "*fondet e veta*" të institucionit që arrijnë në vlerën 168,026 mijë lekë e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivit të bilancit 217,043 mijë lekë dhe B "*<u>detyrimeve</u>*" të pasivit në vlerën 49,017 mijë lekë.

Formati 8 "*Pasqyra e lëvizjes së fondeve*" ku janë pasqyruar tepricat në çelje, lëvizjet për periudhën (debi, kredi) dhe teprica në mbyllje e cila korrespondon me pasivin e bilancit.

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	**A**	**FONDE TE VETA**	**168,026,268**	**176,695,646**
2	**10**	**I. Fonde të veta**	**168,026,268**	**176,695,646**
3	101	Fonde bazë	168,026,268	176,695,646
4	105	Grante të brendshme kapitale		
5	106	Grante të huaja kapitale		
6	107	Vlera Akt. Qend.të caktuara në përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		

<u>Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit</u>, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 316,937 mijë lekë të ndara sipas zërave si (600) "*Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli*" në vlerën 214,622 mijë lekë, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit.
llog. (601) "*Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore*" në vlerën 35,816 mijë lekë, llog. (602) "*Mallra dhe shërbime të tjera*" në vlerën 65,836 mijë lekë, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2016.
Llog. (604) "*Transferta korrente të brendshme"* në vlerën 214 mijë lekë.
Llog. (606) "*Transferta për buxhete familjare e individët"* në vlerën 448 mijë lekë.
Llog. (63) "*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*" në vlerën - 662 mijë lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Nr.	Nr. llog.	PERSHKRIMI I SHPENZIMEVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor	Viti i mëparshëm
a	*b*	*c*	*1*	*2*
1	Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	316,275,486	313,378,982
2	60	I. Shpenzime Korrente	316,937,439	323,193,638
3	600	Paga,shperblime e te tjera personeli	214,622,501	225,472,989
4	6001	Paga, personeli i perhershem	118,617,370	126,090,045
5	6002	Paga, personel I perkohshem	96,005,131	99,382,944
6	6003	Shperblime		
7	6009	Shpenzime tjera personeli		
8	601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	35,816,230	37,166,255
9	6010	Kontribute per sigurimet shoqerore	32,146,718	33,390,198
10	6011	Kontribute per sigurimet shendetesore	3,669,512	3,776,057
11	602	Mallra dhe sherbime te tjera	65,836,248	59,954,294
12	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	9,648,127	15,507,777
13	6021	Materiale dhe sherbime speciale	4,904,031	6,034,194
14	6022	Sherbime nga te trete	29,244,768	19,683,786
15	6023	Shpenzime transporti	4,839,866	2,728,245
16	6024	Shpenzime udhetimi	4,408,573	7,156,183
17	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	3,377,826	1,732,300

18	6026	Shpenzime per qeramarrje	7,002,516	5,788,266
19	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	2,356,341	1,137,183
20	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
21	6029	Shpenzime te tjera operative	54,200	186,360
22	603	Subvencionet	0	0
23	6030	Subvecione per diference cmimi		
24	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
25	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
26	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
27	6039	Subvecione te tjera		
28	604	Transferime korrente te brendshme	214,000	152,000
29	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	214,000	152,000
30	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
31	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
32	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
33	605	Transferime korrente me jashte	0	0
34	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
35	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
36	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
37	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
38	606	Transferta per buxh.familjare e individe	448,460	448,100
39	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	448,460	448,100
40	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
41	63	II. Ndryshimi i gjendjeve te inventarit (+ -)	-661,953	-9,814,656

<u>Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit</u> formati nr. 3/2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2016 (*grant*) në shumën 296,975 mijë lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i vitit 2017 në vlerën 15,373 mijë lekë.

Të ardhurat tatimor e jo tatimore janë pasqyruar në bilanc në formatin 3/2 në vlerën 23,890 lekë dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë është po e njëjta vlerë.

Në lekë

34	**71**	**III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)**	**23,890,400**	**21,176,000**
35	**710**	**a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia**		
36	7100	- Nga ndërmarrjet. publike jo financiare		
37	7101	- Nga ndërmarrjet. publike financiare		
38	7109	- Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
39	**711**	**b) Shërbime administ. e ardhura sekondare**	**23,890,400**	**21,176,000**
40	7110	- Tarifa administrative dhe rregullatorë		
41	7111	- Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	23,890,400	21,176,000
42	7112	- Takse për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	- Nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44	7114	- Te ardhura nga biletat		
45	7115	- Gjoba dhe kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime		
46	7116	- Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi ndërtimeve pa leje		
47	**719**	**c) Te tjera te ardhura jo tatimore**		

Pasqyra e bilancit "*Burimet dhe shpenzimet lidhur me investime*" zëri "*Shpenzime për rritjen e AQ*" formati 4/e e plotësuar për shumën 4,668,000 lekë në analizë rakordon me vlerën prej 4,668,000 lekë në pasqyrën "*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*".

Formati 4/e:

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica Në çelje	Transaksionet e vitit		Teprica në Fund
				Debi	Kredi	
a		*b*	*c*	*d*	*e*	*f*
	II	SHPENZIMET PER INVESTIME	0	6,401,248	6,401,248	0
34	230	Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuara				0
35	231	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara	0	6,401,248	6,401,248	0
36	2310	Toka, troje e terrene				0
37	2311	Pyje, kullota ,plantacione				0
38	2312	Ndërtime e konstruksione				0
39	2313	Rruge, rrjete dhe vepra ujore				0
40	2314	Instalime teknike, pajisje, instrum dhe vegla pune				0
41	2315	Mjete te transportit				0
42	2316	Rezerva shtetërore		1,733,248	1,733,248	0
43	2317	Kafshe pune e prodhimi				0
44	2318	Inventar ekonomik		**4,668,000**	**4,668,000**	0
45	232	Transferimet kapitale				0
46	25	Huadhënie dhe nën huadhënie	0			0
47	255	Të dala për huadhënie dhe nenhuadhenie të brendsh				0
48	256	Të dala për transaksionet e huadhenies se huaj				0
49	250	Të hyra nga principali i huadhënieve te brendshme				0
50	251	Të hyra nga principali i transaks. të huadhe së huaj				0
51	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0			0
52	265	Të dala për kapitale te veta ne nd. publike jo fitimp				0
53	266	Të dala për kapitale te veta ne instituc financiare				0
54	267	Të dala për kapitale te veta ne joint venture				0
55	269	Të dala për kapitale te veta te tjera				0

Vlera e mësipërme në pasqyrat financiare formati 4/e është paraqitur e gjithë vlera për, "*Rezerva shtetërore" në vlerën 1,733,248*_për "*Inventar ekonomik*" për 4,668 mijë lekë kur edhe në pasqyrën "*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*" në formatin 6, kolona e dytë shumat pasqyrojnë vlerën e investimeve të ndarë sipas zërave të investimeve në vlerat e mësipërme.

Formati 12 "*Pyetësor dhe shënime shpjeguese*" është plotësuar formalisht relacioni shpjegues për pasqyrat financiare por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në

pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2015 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 "*Për miratimin e planit kontabël"* si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse.
Veprimet për vitin 2015 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 "*Për kontabilitetin*" ndryshuar me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

Për vitin 2015
Për vitin 2015, grupi i auditimit konstatoi se nuk është bërë inevtarizimi për vitin 2015, por nga institucioni është kryer vetëm inventarizimi dhe kontabilizmi për vitin 2014 e cila është pasqyruar në bilancin e vitit 2015. Invetarizimi është kryer me urdhri nr. 1241, datë 25.12.2014 "*Për ngritjen e komisionit të inventarizimit*" sipas referencës ligjore, ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi.

Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitin 2014 është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet INSTAT-it për vitin 2015. Në këtë raport janë pasqyruar dhe diferencat e konstatuara për vlerën 6,343,021 lekë (*Vlerësime dëmesh*).

Në formatin 6 kolona 8 Janë regjistruar vlerat për nxjerrje jashtë përdorimit për zërat "*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*" për 58,797 lekë dhe "*Inventar ekonomik*" për vlerën 11,614,179 lekë sipas procesverbaleve të asgjësimit datë 23.07.2015.

Nga auditimi u konstatua se INSTAT, Drejtoria e Financës ka hartuar pasqyrat financiare për *Aparatin e INSTAT-it*, të cilat janë dërguar të Thesari dt. 29.01.2016, duke mos u përfshirë Përmbledhësja e Thjeshtë për pasqyrat financiare të konsoliduara (*formati nr. 10, formati nr. 11*) janë dërguar në dt. 21.04.2016, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2016 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si edhe njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj"*, i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

Është hartuar Raporti i monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 i cili është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 620/3, dt. 29.01.2016.
Raportet e monitorimit të shpenzimeve vepër vitin 2016, që janë paraqitur në Ministrinë e Financave, ndër të tjera mungon formati programin "*Planifikim, menaxhim, administrim*" i cili

përfshin vetëm administratën pa drejtoritë rajonale ku si rezulatat performanca e produkteve *"Planifikim, menaxhim, administrim"* nuk është e paraqitur e lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programit si dhe sa janë realizuar këto objektiva.
Pasqyrat e plotesuara nuk janë të plotësuar me një informacionin më të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.
- Raportet e monitorimit të buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT por nuk shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive, në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Për vitin 2016
Bilanci i vitit 2016 është hartuar dhe depozituar më datë 27.02.2017 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë.
Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin pasqyrat dhe anekset përkatëse dhe informacionin. Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.
Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar, si dhe i llogarive inventarjale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:
a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.
b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:
Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- *U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;*
- *U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;*
- *U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;*
- *U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.*
- *U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;*

- *U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.*

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.

- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2016 rezultoi:

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 "*Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuar*" në vlerën 114,485 mijë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
9	21,23,24,28	II. Akt. Qëndrueshme. të Trupëzuara	114,485,676	125,801,629
10	210	Toka, troje, Terrene	0	0
11	211	Pyje, Kullota Plantacione	0	0
12	212	Ndërtime e Konstruksione	67,113,938	67,113,938
13	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	0
14	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	13,105,396	13,657,329
15	215	Mjete transporti	20,630,352	20,630,352
16	216	Rezerva shtetërore	0	0
17	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0
18	218	Inventar ekonomik	132,129,875	142,947,767
19	219	Amortizimi aktiv. Qendr. të trupëzuara (-)	-118,493,885	-118,547,757
20	231	Shpenzime proces për rritjen e AQT	0	0
21	232	Shpenzime proces për transferime kapitale	0	0
22	24	Aktive te Qend. te trupëzuara te dëmtuara	0	0
23	28	Caktime	0	0

Zëri "*Ndërtime e konstruksione*" (llog. 212) për vlerën 67,114 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri "*instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune*" (llog. 214) për vlerën 13,105 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri *"Mjete transporti*" (llog. 215) është për vlerën 20,630 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. (*Shtatë automjete* autovetura land rover 76-75 a, autoveture opel 63-10, autoveture frontera opel 0151a, autoveture hynday-07, autoveture ford mondeo tr 37-18, autoveture tojote 26-17, autoveture ford -everest 34-92)
Zëri "*Inventar ekonomik*" (llog. 218) për vlerën 132,130 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme:
Në formatin 6 kolona 2 "*blerje e krijuar me pagesë*" për vlerën 244,349 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, "*Ndërtime e konstruksione*" në vlerën 67,114 mijë lekë, "*Inventar ekonomik*" në vlerën 142,948 mijë lekë, "*Instalime teknike makineri dhe pajisje*" në vlerën 13,657, "*Mjete transporti*" në vlerën 20,630 mijë lekë dhe "*Koncesione, patenta, licensa t ngjashme"* në vlerën 3,947,706 mijë lekë.

Kolona 8 pakësime gjatë vitit ushtrimor "*Nxjerrje jashtë përdorimit*" janë pasqyruar pakësime të aktiveve, '*instalime teknike dhe makineri pajisje*" në vlerën 552 mijë lekë "*Inventar ekonomik*" në vlerën 11,052 mijë lekë. *Proces verbali i azgjësimit i mbajtur nga komisionet e ngritura nga titullari me urdhër nr.799/2, datë 24.10.2016 "Për komisionin e asgjësimit të disa paisjeve dhe materialeve të zyrave të INSTAT"*

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 6 "*Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara*" kolona 11 është e pasqyruar në formatin nr. 1 në zërin "*Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara*" jo me të njëjtat vlera pasi zëri i paraqitur në këtë format (llog. 230) "*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara*" në vlerën **3,947,706** lekë i pasqyruar në formatin nr. 1 është pasqyruar në kolonën 11 në llog. "*Aktive të qëndrueshme të trupëzuara*", zëri (llog. 203) "*Koncesione, patenta, licensa e të tjera të ngjashme" në vlerën* ***3,947,706*** *lekë*."

"*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*" (Llog. nr. 219) prej 118,493,885 mijë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.
"*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*" për 11,549,691 mijë lekë është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me VKM nr. 401, dt. 23.10.1989 dhe është i ndarë në grupe analitike sipas zërave të "*Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara".*

Normat e amortizimit janë përllogaritur sipas VKM nr. 401, datë 23.10.1989 "*Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit*", ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual fiskal *"Për tatimin mbi të ardhurat*" ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur. Normat janë:

15% për studime dhe kërkime;
1% për ndërtesat dhe konstruksionet;
3% për inventarin ekonomik;

25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
6% për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla; dhe
14% për mjetet e transportit.

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 219, (formati nr. 1) dhe formati 7, u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë, (*Shtojca nr. 4*):

LLOG EKON	emertimi	Kodi qarkut	1.01.2016	SHTESA	PAKESIME	31.12.2016
2192	ndertesa	3535	3.863.190	631.629		4.494.819
219411	makineri paisje	3535	2.837.776		238.745	2.599.031
219512	mjete transporti	3535	15.692.557	668.355		16.360.912
2198100	inventar ekonomik	3535	18.846.149	1.736.414		20.582.563
2198400	fotokopjo	3535	4.983.935		1.278.737	3.705.198
2198500	fax	3535	2.029.069	432.476		2.461.545
2198600	paisje kompjuterike	3535	69.573.702		1.963.549	67.610.153
2198700	te tjera paisje	3535	721.379		41.715	679.664
		Totali	118.547.757	3.468.874	3.522.746	118.493.885

Aktivet qarkulluese zëri "*Objekte inventari*" në shumën prej 2,325 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

"*Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët*" (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formati nr. 2 për vlerën 20,206 mijë lekë ku "*Të tjera operacione me shtetin (debitor)"* zënë shumën 18,904 mijë e cila në analizë (*Inventari i llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin" dt. 31.12.2016*) përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2017 si "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" (llog. 401-408) për 3,668 mijë lekë, "*personeli e llogari të lidhura me to*" (llog. 421-423) për 8,928 mijë lekë, "*Të drejta dhe taksa për tu derdhur në shtet*" (llog. 431) për 867 mijë lekë, për "*sigurime shoqërore*" (llog. 435) në vleftën 2,399 mijë, "*sigurime shëndetësore*" (llog. 436) në vleftën 316 mijë, "*Organizma të tjera shoqërore*" (llog. 437, 438) në vleftën 1,923 mijë, "*Kreditorë të ndryshëm*" (Llog. 467) për 802 mijë lekë.

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
20	Klasa 4	II. Detyrime afatshkurtër	21,488,585	22,746,409
21	419	Klientë (Kreditore), parapagese pjesore		
22	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	3,667,814	779,103
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	8,928,179	8,041,277
24	431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	867,029	988,702
25	432	Tatime mbledhura nga shteti për llog. Pusht. Lokal		
26	433	Shteti fatkeqësi natyrore		

27	4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	1,302,024	1,322,203
28	435	Sigurime shoqërore	2,399,470	2,628,985
29	436	Sigurime shëndetësore	316,555	350,969
30	437-438	Organizma të tjerë shoqërore	1,923,101	1,924,643
31	44	Institucione te tjera publike		
32	45	Marrëdhënie me institucione brenda e jashtë sistemit		
33	460	Huadhënës		
34	464	Detyrime për t'u paguar për blerjen e letra me vlerë		
35	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	1,382,746	6,050,747
36	467	Kreditore të ndryshëm	701,667	659,780

Në llog. (466) "*Kreditorë në mjete në ruajtje*" janë pasqyruar në vlerën 1,282 mijë lekë
Në pasiv të bilancit janë paraqitur A/I "*fondet e veta*" të institucionit që arrijnë në vlerën 144,566 mijë lekë e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivit të bilancit 200,111 mijë lekë dhe B "*detyrimeve*" të pasivit në vlerën 55,546 mijë lekë.

Formati 8 "*Pasqyra e lëvizjes së fondeve*" ku janë pasqyruar tepricat në çelje, lëvizjet për periudhën (debi, kredi) dhe teprica në mbyllje e cila korrespondon me pasivin e bilancit.

Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	**A**	**FONDE TE VETA**	**144,565,732**	**168,026,268**
2	**10**	**I. Fonde të veta**	**144,565,732**	**168,026,268**
3	101	Fonde bazë	144,565,732	168,026,268
4	105	Grante të brendshme kapitale		
5	106	Grante të huaja kapitale		
6	107	Vlera Akt. Qend.të caktuara në përdorim		
7	109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		

Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 323,825 mijë lekë të ndara sipas zërave si (600) "*Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli*" në vlerën 219,035 mijë lekë, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit.
llog. (601) "*Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore*" në vlerën 36,464 mijë lekë, llog. (602) "*Mallra dhe shërbime të tjera*" në vlerën 67,363 mijë lekë ose, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2016.
Llog. (604) "*Transferta korre3nte të brendshme"* në vlerën 360 mijë lekë.
Llog. (606) "*Transferta për buxhete familjare e individët"* në vlerën 603 mijë lekë të totalit të shpenzimeve.
Llog. (63) "*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*" në vlerën 16,092 mijë lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Nr.	Nr. llog.	PERSHKRIMI I SHPENZIMEVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor	Viti i mëparshëm

a	*b*	*c*	*1*	*2*
1	Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	339,917,906	316,275,486
2	60	I. Shpenzime Korrente	323,825,616	316,937,439
3	600	Paga,shperblime e te tjera personeli	219,034,714	214,622,501
4	6001	Paga, personeli i perhershem	108,790,596	118,617,370
5	6002	Paga, personel I perkohshem	110,244,118	96,005,131
6	6003	Shperblime		
7	6009	Shpenzime tjera personeli		
8	601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	36,464,309	35,816,230
9	6010	Kontribute per sigurimet shoqerore	32,577,104	32,146,718
10	6011	Kontribute per sigurimet shendetesore	3,887,205	3,669,512
11	602	Mallra dhe sherbime te tjera	67,363,293	65,836,248
12	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	7,874,504	9,648,127
13	6021	Materiale dhe sherbime speciale	5,975,093	4,904,031
14	6022	Sherbime nga te trete	36,715,233	29,244,768
15	6023	Shpenzime transporti	3,507,022	4,839,866
16	6024	Shpenzime udhetimi	4,144,103	4,408,573
17	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,502,093	3,377,826
18	6026	Shpenzime per qeramarrje	6,135,585	7,002,516
19	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	1,397,373	2,356,341
20	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
21	6029	Shpenzime te tjera operative	112,287	54,200
22	603	Subvencionet	0	0
23	6030	Subvecione per diference cmimi		
24	6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
25	6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
26	6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
27	6039	Subvecione te tjera		
28	604	Transferime korrente te brendshme	360,000	214,000
29	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	360,000	214,000
30	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
31	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
32	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
33	605	Transferime korrente me jashte	0	0
34	6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
35	6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
36	6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
37	6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
38	606	Transferta per buxh.familjare e individe	603,300	448,460
39	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	603,300	448,460
40	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor		
41	63	II. Ndryshimi i gjendjeve te inventarit (+ -)	16,092,290	-661,953

<u>Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit</u> formati nr. 3/2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2016 (*grant*) në shumën 283,663 mijë lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i vitit 2017 në vlerën 18,904 mijë lekë.

Të ardhurat tatimor e jo tatimore janë pasqyruar në bilanc në formatin 3/2 në vlerën 32,799 lekë dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë është po e njëjta vlerë.

Në lekë

34	**71**	**III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)**	**32,798,893**	**23,890,400**
35	**710**	**a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia**		
36	7100	- Nga ndërmarrjet. publike jo financiare		
37	7101	- Nga ndërmarrjet. publike financiare		
38	7109	- Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
39	**711**	**b) Shërbime administ. e ardhura sekondare**	**32,798,893**	**23,890,400**
40	7110	- Tarifa administrative dhe rregullatorë		
41	7111	- Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	32,798,893	23,890,400
42	7112	- Takse për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	- Nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44	7114	- Te ardhura nga biletat		
45	7115	- Gjoba dhe kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime		
46	7116	- Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi ndërtimeve pa leje		
47	**719**	**c) Te tjera te ardhura jo tatimore**		

Pasqyra e bilancit "*Burimet dhe shpenzimet lidhur me investime*" zëri "*Shpenzime për rritjen e AQ*" formati 4/e e plotësuar për shumën 11,599,053 lekë në analizë nuk rakordon me vlerën prej 4,181,447, lekë në pasqyrën "*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*" kolona e dytë "*Blerjet e krijuara me pagesë*" formati 6 me një diferencë në vlerën **7,417,606** lekë.
Totali i shtesave të krijuara me pagesë nuk është i barabartë me burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet.

Formati 4/e:

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica	Transaksionet e vitit		Teprica	
			Në çelje	Debi	Kredi	Fund	
a		*b*	*c*	*d*	*e*	*f*	
	II	SHPENZIMET PER INVESTIME	0	11,599,053	11,599,053	0	
34	230	Shpenzime për rritjen e AQ të patrupëzuara		3,947,706	3,947,706	0	
35	231	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara	0	7,651,347	7,651,347	0	
36	2310	Toka, troje e terrene				0	
37	2311	Pyje, kullota ,plantacione				0	
38	2312	Ndërtime e konstruksione				0	
39	2313	Rruge, rrjete dhe vepra ujore		7,417,606	7,417,606	0	
40	2314	Instalime teknike, pajisje, instrum dhe vegla pune				0	
41	2315	Mjete te transportit				0	
42	2316	Rezerva shtetërore				0	
43	2317	Kafshe pune e prodhimi				0	
44	2318	Inventar ekonomik		233,741	233,741	0	
45	232	Transferimet kapitale				0	
46	25	Huadhënie dhe nën huadhënie	0			0	
47	255	Të dala për huadhënie dhe nenhuadhenie të brendsh				0	
48	256	Të dala për transaksionet e huadhenies se huaj				0	
49	250	Të hyra nga principali i huadhënieve te brendshme				0	

50	251	Të hyra nga principali i transaks. të huadhe së huaj				0
51	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0			0
52	265	Të dala për kapitale te veta ne nd. publike jo fitimp				0
53	266	Të dala për kapitale te veta ne instituc financiare				0
54	267	Të dala për kapitale te veta ne joint venture				0
55	269	Të dala për kapitale te veta te tjera				0

Vlera e mësipërme në pasqyrat financiare formati 4/e është paraqitur e gjithë vlera për, "*Rrugë rrjete vepra ujore"* për 7,418 mijë lekë, kur në aktivet ky zë është 0 lekë për "*Inventar ekonomik*" për 234 mijë lekë kur edhe në pasqyrën "*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme*" në formatin 6, kolona e dytë shumat nuk pasqyrojnë vlerën e investimeve të ndarë sipas zërave të investimeve në vlerat e mësipërme.

Formati 12 "*Pyetësor dhe shënime shpjeguese*" është plotësuar formalisht relacioni shpjegues për pasqyrat financiare por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2016 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 "*Për miratimin e planit kontabël"* si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse.
Veprimet për vitin 2016 janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 "*Për kontabilitetin*" ndryshuar me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

Për vitin 2016 ka dalë urdhri nr. 799, datë 20.06.2016 "*Për ngritjen e komisionit të inventarizimit*" i Drejtori I Përgjithshëm znj. [redacted] sipas referencës ligjore, ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi.
Inventarët 2016;

Llog.	Emërtimi	Gjendja kontable 01.01.2016	Gjendja sipas inventarit 31.12.2016	Diferenca
1	2	3	4	(3-4)
202	Studime e kërkime			
230	Shp.. Për. Rr. Akt. të paqënd.	0	0	
210	Toka, troje, terrene			

212	Ndërtime e konstruksione	67.113.938	67.113.938	0
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore			0
214	Ins. Teknike makineri pajisje	13.657.329	13.105.396	-551.933
215	Mjete transporti	20.630.352	20.630.352	0
218	Inventar ekonomik	142.947.758	132.129.855	-10.817.903
312	Materiale	39.828.269	23.806.808	-16.021.461
327	Objekte inventari	2.396.371	2.325.542	-70.829
	TOTALI	286.574.018	259.111.892	-27.462.126

Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitin 2016 është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e INSTAT, për vitin 2016. Në këtë raport janë pasqyruar dhe diferencat e konstatuara për vlerën 27.462.126 lekë

Në formatin 6 kolona 8 Janë regjistruar vlerat për nxjerrje jashtë përdorimit për zërat "*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*" për 551,933 lekë dhe "*Inventar ekonomik*" për vlerën 11,051,632 lekë sipas procesverbaleve të asgjësimit dt. 24.10.2016 dhe fletë daljeve nr. Dt. 31.10.2016.

Nga auditimi u konstatua se INSTAT, Drejtoria e Financës ka hartuar pasqyrat financiare për *Aparatin e INSTATI-t*, të cilat janë dërguar të Thesari dt. 27.02.2017, duke mos u përfshirë Përmbledhësja e Thjeshtë për pasqyrat financiare të konsoliduara (*formati nr. 10, formati nr. 11*) janë dërguar në dt. 18.04.2017, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2016 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si edhe njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj"*, i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

Është hartuar Raporti i monitorimit të shpenzimeve për vitin 2016 i cili është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 515/3, dt. 31.01.2017
-Raportet e monitorimit të shpenzimeve vepër vitin 2016, që janë paraqitur në Ministrinë e Financave, ndër të tjera mungon formati programin "*Planifikim, menaxhim, administrim*" i cili përfshin vetëm administratën pa drejtoritë rajonale ku si rezulatat performanca e produkteve *"Planifikim, menaxhim, administrim*" nuk është e paraqitur e lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programit si dhe sa janë realizuar këto objektiva.
-Pasqyrat e plotësuara nuk janë të plotësuar me një informacionin më të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungojnë argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.

- Raportet e monitorimit të buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT por nuk shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive, në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

IV. III. Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.

Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë e shërbime nga subjekti i audituar. Zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike. Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra, punë e shërbime. Vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Gjatë auditimit të ligjshmërisë dhe përputhshmërisë, mbi proçedurat e prokurimeve publike,të realizuara përgjatë vitit buxhetor 2015, në aparatin e Institutit të Statistikave (INSTAT), me objekt ***"Përputhshmëria ligjore në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime",*** grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore Ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", VKM nr.918 datë 29.12.2014 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë eletronike", VKM nr.28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime", Udhëzim e APP-së nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik", Udhëzimin e APP-së nr.3 datë 27.01.2015 "Për proçedurën e prokurimit me vlerë të vogël" , çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit. Për shkak të volumit të dosjeve të tenderave dhe sidomos të, atyre me vlera të vogla u përzgjodh metoda me zgjedhje rastësore, metoda e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjes për proçesin e prokurimit të audituar. Përqëndrimi i grupit të audititimit, është mbështetur në pikat e renditura të audituara si më poshtë:

-Hartimin dhe njoftimin e rregjistrit të prokurimit publik;
-Llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit;
-Hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumentave standarte të tenderit;
-Paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave;
-Vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit eletronik (SPE);
-Menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces;
-Njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj.
Për vitin 2015, vlera e parashikuar për objektet prokuruese (zëri buxhetor 231,dhe 602) në Institutin e Statistikave, është me vlerë prej 33,152,134 lekë pa TVSH, duke u realizuar me

vlerë prej 33,157,522 lekë me TVSH, kjo në referim të shkresës së Regjistrit të parashikimeve me nr.155 prot datë 30.01.2015 dhe Regjistrit të realizimeve me nr.155/5 prot datë 14.01.2016, dërguar pranë Agjecisë së Prokurimeve Publike (APP).

(Raportimi i Rregjistrit të realizimit të prokurimeve publike për vitin 2015, të INSTAT).

Nr	Lloji i proçedurës	Sasia	Fondi limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (me TVSH)
1.	Kërkesë për propozim	6	15,883,207	13,861,029.6
2.	Negocim pa shpallje	4	1,264,648	1,515,870
3	Proçedurë e hapur	1	2,481,405	1,517,477.8
4	Prokurim i përqëndruar Ministria e Brendshme	5	14,087,632	14,194,760.96
5	Prokurimet me vlerë të vogël	33	3,275,861	2,774,366
6	Proçedurë emergjente	4	149,890	149,890
7	***Procedura Totali***	***53***	***37,142,643***	***34,013,392***

-Nga auditimi, rezultoi se, në përgjithësi Autoriteti Kontraktor (AK), ka përzgjedhur proçedurën tenderuese "Kërkesë për propozim" me arsyetimin, se kontratat janë me vlerë më të ulët monetare, njoftimi i kontratës ka afat kohor minimal 10(dhjetë) ditë për dorëzimin e ofertave, por përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të ftuar, nga ana Njësia e prokurimit (NjP) është bërë me pretendimin se janë të regjistruar në sistemin elektronik, duke mos paraqitur argumentimin dhe dokumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomike që kanë ftuar, kjo në kundërshtim me VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit të prokurimit publik"neni 39, pika 4 (kërkesë për propozime).

-Nga auditimi është evidentuar se ka mangësi, në hartimin e fondit limit, përzgjedhjen e proçedurës së prokurimit, në përgatitjen e dokumentave të tenderave, në hartimin e kërkesave kualifikuese, ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave, duke sjellë një efiçencë të joplotë të fondeve në arritjen e objektivave të këtij institucioni. *Ky përfundim kushtëzohet nga fakti se për pranë INSTAT-së, nuk ka njësi prokurimi si strukturë organike brenda institucionit, kështu nisur nga kjo rrethanë, krijohen në mënyrë të vazhdueshme komisione prokurimi ad hoc, të cilat paraqiten me produktivitet të ulët, për arsye të mos pasjes në komision anëtarë të specializuar dhe trajnuar për fushën kompetente (duke marrë parasysh veprimtarinë specifike të disiplinës së prokurimit publik).*

-Nga auditimi, është evidentuar, se gjatë vitit buxhetor 2015, janë realizuar 5 proçedura prokurimi të cilat janë zhvilluar në mënyrë të përqëndruar, pranë Drejtorisë së Prokurimeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brëndshme, kjo në zbatim të VKM nr.28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime" si dhe në bazë të shkresës nr.26 prot datë 29.12.2014 "Kujtesë në lidhje me dërgimin e të dhënave për proçedurat e prokurimit që do zhvillohen nga ana jonë si dhe prioritett e zhvillimit të tyre", duke ju kërkuar që prokurimet prioritare duhet të paraqiten pranë Organit Qëndror Blerës, Ministrisë së Puneve të Brendshme, brenda datës 15.01.2015, ndërsa kërkesat për proçedurat e

prokurimit me përparësi normale duhet të paraqiten brenda datës 31.01.2015. Kështu, nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit , ka vërejtur se, AK-ja, nuk e ka respektuar afatin ligjor 31.01.2015, të përcaktuar në VKM nr 28, datë 14.01.2015 për dërgimin e të dhënave teknike e sasiore dhe fondin përkatës për çdo prokurim, në OQB, duke sjellë vështirësi e vonesa të panevojshme në zhvillimin e procedurave të prokurimit, kjo edhe për faktin se, në asnjë nga dispozitat ligjore që përcaktojnë kryerjen e prokurimit të përqendruar, nuk ka sanksione për autoritete kontraktore që pa arsye të justifikuara, vonojnë paraqitjen e të dhënave pranë OQB, e për rrjedhojë zgjasin afatet e zhvillimit të tenderëve dhe shkaktojnë vështirësi në plotësimin e nevojave për mallra e shërbime për administratën publike.
Grupi i audituesve të KLSH-së, ka audituar gjithsej *11(njëmbëdhjetë)* proçedura për vitin 2015, (**1** proçedurë e hapur, **6** kërkesë për propozim dhe **4** Negocim pa shpallje) të cilat janë përllogaritur në vlerën prej 19,629,260 lekë pa tvsh ose vlera e kontratave të realizuara prej 16,894,376 lekë me tvsh, të cilat i përkasin objekteve prokuruese në zërin buxhetor (602, 230 dhe 231).
Nga auditimi, në disa prej proçedurave, janë konstatuar mangësi në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, në përgatitjen e dokumenteve të tendera, hartimit të kërkesave kualifikuese dhe kualifikimet e skualifkimet të operatorëve ekonomik konkurrues e pjesëmarrës në tendera, duke sjellë një eficencë të joplotë të fondeve në arritjen e objektivave të këtij institucioni, si pasojë e mangësive të lidhura me mungesën e harmonizimit të punës midis, stukturave të hartimit të fondeve limit, të njësisë së hartimit të dokumentacionit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave,të zbatimit dhe monitorimit të kontratave.
Më poshtë po japim, *vetëm proçedurat* prokuruese ku janë evidentuar, mangësitë gjatë auditimit, të realizuara pranë INSTAT si Autoritet Kontraktor, të financiuara në Buxheti i Shtetit.

1.Mbi auditimin e proçedurave me objekt "Mbi auditimin mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të proçedurave "Kërkesë për propozim"me mjete elektronike me object "Blerje chilleri për Institutin e Statistika", me fond limit 5,400,000 lekë, pa tvsh, dhe të proçedurës me blerje të vogël sipas Urdhër Prokurimi nr.36 datë 28.12.2015", financuar nga buxheti i shtetit për vitin 2015.

1.Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna mbi tenderin	***Komisioni i vlerësimit të ofertave***	***Njësia e prokurimit***
Në bazë të Urdhër të titullarit të AK-së, me shkresë nr.1219 datë 20.10.2015 "Për ngritjen komisionit të përllogaritjes së fondit limit"".	1. [redacted] Kryetar 2. [redacted] Anëtar 3. [redacted] Anëtar	1. [redacted] IT 2. [redacted] Finac 3. [redacted] Jurist
Vlera e përllogaritur e 5,400,000 (pesëmilion e katërqind mijë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.		
UP me shkresë nr.1219/1 prot datë 26.10.2015 , me llojin e procedurës "Kërkesë për propozim" me mjete elektronike. Hapja e ofertave datë 09.11.2015, ora:11:00. KVO e ngritur me Urdhër nr.1219/2 prot, datë 26.10.2015.		
NjP, ka ftuar 5 OE, me pretendimin se janë të rregjistruar në sistemin elektronik të prokurimit.		
KVO, në bazë të dokumetacionit ligjor dhe dokumentavepër kapacitetet teknike dhe finaciare,ka skualifikuar 2(dy) OE dhe ka kualifikuar 2 (dy) operatorë, duke shpallur fitues opëratorin me vlerë më të ulët		

"[redacted]" shpk.		
Titullari i AK, me shkresën nr.1219/4 prot datë 10.12.2015 ka miratuar Raportin përbledhës të Komisionit të Ofertave, duke shpallur fitues operatotin "[redacted]" me vlerë oferte ekonomike prej 5,400,000 lekë pa tvsh.		
AK me subjektin fitues ka lidhur Kontratë nr.1219/10 datë 24.12.2015, me vlerë totale prej 4,668,000 (katër million e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë)lekë me TVSH.		

-Nga auditimi rezultoi se, në dosjen fizike dhe në Sistemin Elektronik të Prokurimeve SEP në app.gov.al, me REF-13337-10-28-2015,në DT, janë specifikimet teknike, skica teknike dhe lista e materialeve për lidhjen e chillerit, të hartuara nga ([redacted] firmosur me vulë dhe firmë), i cili nuk rezulton të jetë punonjës pranë INSTAT apo të jetë marrë si eksperti i jashtëm. Nuk është evidentuar, asnjë e dhënë mbi mënyrën sesi është rekrutuar për të realizuar dokumentacioni e dorëzuar prej tij, në dosje ndodhet licenca profesionale fotokopje e cila është lëshuar në 26.05.2005 me afat 10 vjeçar, tenderi është realizuat në tetor 2015, pra del jashtë afateve ligjore) si dhe asnjë ekstrakt si subjekt i rregjistruar pranë QKR-së.
Gjithashtu, nga auditimi, del se komisioni i përllogaritjes së fondit limit, ka marrë tre oferta nga tre operatorë ekonomik, duke kërkuar Chiller ngrohje–ftohje, duke përfshirë dhe materialet për instalimin e pajisjes, duke mos e detajuar në zëra, kjo në kundërshtim me bazën ligjore të ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe në zbatim të VKM nr.704 datë 29.10.2014 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyerje dhe kolaudim" dhe VKM nr.843 datë 17.12.2014 "Shtojca e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyerje dhe kolaudim", përgjegjësi e Njësisë së prokurimit me përbërje prej [redacted] specialit IT, [redacted] financier dhe [redacted] jurist).
Pra siç, shihet nga ana e AK-së, në NjP, nuk është angazhuar eksperti i fushës (meqënëse kemi investim, zëri buxhetor 231), duke dalë në pah mangësia, që pranë INSTAT-së, nuk ka njësi prokurimi si strukturë organike brenda institucionit, kështu nisur nga kjo rrethanë, krijohen në mënyrë të vazhdueshme komisione prokurimi ad hoc, të cilat paraqiten me produktivitet të ulët, për arsye të mos pasjes në komision anëtarë të specializuar dhe trajnuar pranë APP-së, për fushën kompetente (duke marrë parasysh veprimtarinë specifike të disiplinës së prokurimit publik).
-Nga auditimi rezultoi se, Titullari i INSTATI-it, i ka deleguar të drejtën në mungësë dhe porosi [redacted], i cili ka vendosur të jetë njëkohësisht dhe kryetar i KVO-së, kjo në kundërshtim me të ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 56 (Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar paragrafi 2 citohet "…Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e proçedurës së përzgjedhjes së fituesit në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. Kjo ngarkon me përgjegjësi [redacted].

-Nga auditimi i DT, rezulton se është, vendosur kritereri i veçantë (Kapaciteti teknik) në pikën b) Liçensa profesionale e shoqërisë, të lëshuara nga autoritet kompetente shtetërore , *Kat. N.S-12 Impjante teknologjike, termike dhe të kondicionimit*, i plotësuar nga operatori ekonomik fitues, "Sulollari"shpk, duke lidhur kontratën nr.1219/10 datë 24.12.2015, me vlerë totale prej 4,668,000 (katër million e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë)lekë me TVSH, ku pas kryerjes së plotë dhe në kohë të lëvrimit për të gjithë artikujve, të kësaj kontrate, e vërtetuar nga, process verbalin e datë 30.12.2015 nga komisioni i pritjes së mallit, i krijuar me Udhërin e titullarit nr.14/2 datë 08.09.2015.

- Gjithashtu në të njëjtën kohë, në datë 24.12.2015, nga ana e ish-Titullarit të AK ,[redacted], është miratuar kërkesa, e hartuar nga z.[redacted] drejtor Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, është realizuar procedura me blerje të vogël me vlerë prej prej 71,667 lekë pa tvsh, me Urdhër Prokurimi nr.36 datë 28.12.2015, në formë shkresore, për të testuar realizimin e montimit dhe blerjes se chillerit. Pikërisht, për të testuar është kërkuar nga AK, *që INSTAT të kontraktojë një inxhinier të fushës i cili të jetë i liçensuar për ushtrimin e funksionit sipas kategorisë NS-12 "Impiante teknologjike, termike dhe kondicionimit",* kërkesë kjo që është kërkuar në proçedurën e blerjes së chillerit, dhe e plotësuar nga operatori ekonmik "[redacted]"shpk. Ky fakt të jep idenë e mosbesimit ndaj OE fitues, si dhe nga AK *duhet të kërkohej në DTnga NjP*, garancia objektit të prokurimit dhe realizimi i kontratës. Kjo ngarkon me përgjegjësi ish-Titullarin e INSTAT [redacted] dhe [redacted].

-Komisioni i blerjeve të vogla,ka vendosur të përcaktojë fitues operatorin ekonomik "[redacted]" me vlerë ofertë me vlerë prej 60,000 lekë pa tvsh. Titullari i AK zj. [redacted], ka lidhur kontratë me datë 29.12.2015, me personin fizik [redacted], e cila ka marrë përsipër të gjej inxhinierin,që të plotësojë kriterin e mëspërm. Nga auditimi rezultoi se, relacioni për "testimin e punës" së bërë nga operatori ekonomik "[redacted]" është i konfimuar nga ing. [redacted], i cili rezulton të ketë kontratë punë i mbajtur më datë 28.12.2015, midis [redacted] dhe ing, duke mos paraqitur detyrimet si punëdhënës pagesat e detyrimeve të sigurimeve shendetësore dhe shoqërore, të mëparshme, duke të dhënë idenë se personi fizik, ka bërë thjesht lidhjen me këtë person, duke u paguar me *vlerë prej 60,000 lekë pa tvsh*, i cili përbën efekt ekonomik negativ, nga buxheti i shtetit, i paguar në në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimeve. Kjo ngarkon me përgjegjshmëri zj. [redacted] Është realizuar pagesa me Urdhër shpenzimi nr.35 datë 28.01.2016, me personin fizik të mësipërm.

Gjithashtu, grupi i audituesve, gjatë qëndrimit në ambjentet e INSTAT, evidentoi se instalimet e realizuara për ,Chilleri shërbente vetëm për sistemin e ftohjes, ndërsa për sistemin e ngrohjes nuk e siguronte, ndonëse në DT dhe specifikimet teknike, është shprehur për sisteme ngrohje dhe ftohje. Sistemi i ngrohjes në godinën e INSTAT sigurohej pjesërisht nga sistemi i kaldaljës , duke djegur karburant dhe një pjesë me sistemin e kondicionimit.

Në lidhje mbi problematikën e mësipërme, grupi i audituesve ***ka mbajtuar procesverbalin nr.1 datë 08.05.2017, me nr. 457/11 prot të INSTAT-it.*** Në përgjigje të tij nga ana e z. [redacted],(*ndërsa nga ish-titullarja e INSTAT* [redacted] *nuk është dorëzuar asnjë observacion*), është dorëzuar observacioni pranë KLSH-së, me nr.330/2 prot datë 19.05.2017. Këto kundërshtime u panë me vëmendje nga audituesit, të cilët nuk i marrin në konsideratë si më poshtë vijon:

1.Në paragarafin 2 faqe 1, audituesit mbi vendimin për të qënë titullar i AK dhe kryetar i KVO-së, janë mbështetur në auditimin e shkresave administrative dhe të çdo korespondence e cila është

në funksion të arritjes së qëllimit të realizimit të proçedurës, por nuk mund të marrim në konsideratë asnjë veprin që është në kundërshtim me bazën ligjore, në këtë rast Titullari i INSTATI-it, i ka deleguar të drejtën në mungësë dhe porosi [redacted], i cili ka vendosur të jetë njëkohësisht dhe kryetar i KVO-së, kjo në kundërshtim me të ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 56 (Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar paragrafi 2 citohet "…Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e proçedurës së përzgjedhjes së fituesit në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

2.Në paragarafin 1 faqe 1, citohet se "*Duke patur parasysh specifikën e nërtesës së INSTAT (e cila është e mbuluar tërësisht me xham), gjë që krijonte kushte shumë të vështira pune gjatë periudhës së nxehtë në vend, INSTAT ka aplikuar disa herë për tu pajisur me fondet e duhura nga buxheti I shtetit për blerjen e pajisjes Chiller. Duke qënë se në organikën e INSTAT nuk ka persona të kualifikuar për hartimin e specifikimeve teknike të kësaj natyre, personi fizik* [redacted] *është vetë – ofruar kundrejt asnjë shpërblimi për të ndihmuar institucionin për të krijuar idenë mbi llojin e pajisjes dhe mënyrën e instalimit të saj në godinë. Mbajtësi i Liçencës nr.M.0200/2,* [redacted] *është regjistruar në regjishtrin themeltar në datën 02.05.2008. Në kohën kur materiali është përgatitur i është dorëzuar INSTAT, personi fizik ing.* [redacted] *rezultonte aktiv dhe liçenca e tij e vlefshme*".

-Arsyetimi i mos marrjes në konsideratë, qëndron mbi faktin se,nga auditimi rezulton se, nuk është evidentuar, asnjë e dhënë mbi mënyrën sesi është rekrutuar për të realizuar dokumentacioni e dorëzuar prej tij, në dosje ndodhet licenca profesionale fotokopje e cila është lëshuar në 26.05.2005 (dhe jo në 02.05.2008) me afat 10 vjeçar, tenderi është realizuar në tetor 2015, pra del jashtë afateve ligjore) si dhe asnjë ekstrakt si subjekt i rregjistruar pranë QKR-së.

Gjithashtu, në mungesë të personave të kualifikuar, baza ligjore e prokurimeve publike , të lejon mundësinë e marrjes së eksperti të jashtëm, për të realizuar hartimin e specifikimeve teknike, etj.

3. Në paragarafin III faqe 2, citohet se " *i kam paraqitur titullarit të INSTAT kërkesën për kontraktimin e një inxhinieri për kontrollin e përputhshmërisë së pajisjes me specifikime teknike dhe efektshmërinë e instalimit të saj. Pavarësisht se kontrata e nënshkruar për lëvrimin dhe montimin e pajisjes ka parashikuar garancinë e pajisjes, institucioni duhej të ishte i sigurtë mbi cilësinë dhe përputhshmërinë e mallit të ofruar. Kjo vjen edhe në më mbështetje të nenit 77 të VKM nr.914 ku parashikohet që "Gjatë zbatimit të kontratës , autoriteti kontraktor ose organe të tjera shtetërore, mbikëqyr veprimtarinë e kontraktonit...*""

-Arsyetimi i mos marrjes në konsideratë, qëndron mbi faktin se,nga auditimi është evidentuar se,kjo proçedurë tenderimi është lëvruar në zerin buxhetor 231, pra kemi të bëjmë me investim dhe jo blerje malli, por edhe në këtë proçedurë del në pah se, pranë INSTAT-së, nuk ka njësi prokurimi si strukturë organike brenda institucionit, kështu nisur nga kjo rrethanë, krijohen në mënyrë të vazhdueshme komisione prokurimi ad hoc, të cilat paraqiten me produktivitet të ulët, për arsye të mos pasjes në komision anëtarë të specializuar dhe trajnuar për fushën kompetente (duke marrë parasysh veprimtarinë specifike të disiplinës së prokurimit publik).

- Arsyetim, tjetër i mos marrjes në konsideratë, qëndron mbi faktin se,nga auditimi, AK mund të kishte iniciuar proceduren për mbikëqyrjen e kontratës, në përbushje të nenit 77 të VKM nr.914,

gjë të cilën nuk e ka bërë por ka përzgjedhur procedurë dhe rrugë të cilat nuk janë në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore të prokurimeve publike.

2. Mbi auditimin mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë e proçedurave me objekt "Shërbim ruajtje objekti", për vitin 2015, pranë INSTAT është realizuar me tre proçedura në kohë të ndryshme si më poshtë vijon:

Nga auditimi rezultoi se, në bazë të Regjistrit të parashikimeve me nr.155 prot datë 30.01.2015 dhe Regjistrit të realizimeve me nr.155/5 prot datë 14.01.2016, dërguar pranë Agjecisë së Prokurimeve Publike (APP), objekti i prokurimit me objekt "Shërbim ruajtje objekti për INSTAT 2015" është planifikuar dhe realizuar me proçedurë elektronike, në sistemin e app.goc.al me REF...., lloji i proçedurës i hapur, me vlerë fondi limit prej 2,481,405 lekë pa tvsh dhe fituar nga operatori ekonomik "[redacted]"shpk me vlerë kontrate perj 1,517,477 lekë me tvsh.

Nga auditimi, rezultoi se kjo vlerë totale e parashikuar për këtë shërbim, është realizuar në tre procedura si më poshtë:

2.1)Lloji proçedurës "Proçedurë me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", me fond limit prej 551,423 lekë pa tvsh. Në lidhje mbi realizimin e kësaj proçedurë mund të themi se:

-Në bazë të Urdhër Prokurimi me shkresë nr.373 prot datë 25.02.2015, është miratuar nga titullari i AK, të kryhet prokurimi i fondit limit prej 551,423 lekë pa tvsh, me llojin e proçedurës me negocim, pa shpalljeparaprake të njoftimit të kontratës, me arsyetimin e nevojës emergjente për ruajtjen e objektit të Institutit të Statistikave. Nga auditim rezulton se jepet asnjë dokument mbi përllogaritjen e fondit limit. Proçedura është realizuar më datë 26.02.2015, duke shpallur fitues shoqërinë "Dea Secyrity"shpk me ofertë me të ulët ekonomike me vlerë prej 550,000 lekë pa tvsh. Nga ish titullari në mungesë dhe porosi [redacted] me përfaqësuesin e shoqërisë është lidhur kontrata nr.373/7 prot datë 26.02.2015 me afat kohor për 2 muaj, ku AK ruan të drejtën e ndërprerjes së kontratës si rezultat i proçedurës negocim pa shpallje, nese procedura standarte për këtë shërbim do të përfundojë para afatit prej dy muajve.

Nga auditimi, në lidhje mbi monitorimin dhe ekzekutimin e kontratës, është mbajtur procesvervali i datës 27.04.2015, ku për INSTAT ka firmosur ish Titullari me delegim dhe mungesë [redacted] (në kundërshtim me bazën ligjore të LPP-së dhe menaxhimit financiar) dhe [redacted], ku nuk japin elementin sesa roje ka kryer shërbim për vendrojen, pasi në kontratë neni 8, janë parashikuar 5 roje për një vend roje, por janë mjaftuar duke thenë se pas kontrollit mbi realizimin e shërbimit të ruajtjes me roje private, rezultojnë se janë përmbushur kriteret, duke mos lënë asnjë dokumentacion për vertetimin e kritereve, duke e finalizuar me pagesësat e bërë nga INSTAT me Urdhëra shpenzimi, nr.210 datë 21.04.2015; nr.258 datë 14.05.2015, gjithsej në vlerë totale 660, 000 lekë me tvsh.

2.2) Proçedura e prokurimit me vlerë të vogël, me fond limit me vlerë prej 550,000 lekë pa tvsh me objekt "Shërbim i ruajtjes me roje private për nevojat të INSTAT ". Në lidhje mbi auditimin e realizimit të kësaj proçedurë mund të themi se:

-Me shkresë nga komisioni i prokurimit me blerje të vogel, më datë 07.05.2015, i është kërkuar titullarit të AK, të miratojë miratimin e fillimit të procedurës me BLV, fond i cili do të mbahet nga zëri i përcaktuar në rregjistrin e parashikimit publik për vitin 2015, në vlerë totale 3,032,828 lekë pa tvsh. Kjo kërkesë është hartuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi nuk

i takon komisionit me blerje të vogla ta iniciojë procedurën. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje ([redacted],[redacted] dhe [redacted]).
Kështu nga auditimi nuk del e qartë, mënyra e përllogaritjes së fondit limit nga AK, ndonëse, nga instituconet kompetente të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), është miratuar dhe dërguar pranë çdo autoriteti kontraktor, shkresën e datës 01.04.2015, "Rekomandime mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtes fizike" .
Gjithsesi, kjo proçedurë është realizuar si proçedurë me vlerë të vogël më datë 12.05.2015, duke shpallur fitues shoqërinë e ruajtjes fizike të objekteve "[redacted]"shpk, me vlerë prej 448,515 lekë pa tvsh. Fillimisht Kbv me përbërje([redacted],[redacted] dhe [redacted]), kanë skualifikuar operatorin "[redacted]" pasi oferta ekonomike e paraqitur prej tij ka rezultuar nën koston ligjore, kjo për faktin se sistemi eletronik i prokurimeve pranë APP-së, nuk është e mundur përdorimi I shifrave me presje dhjetore për çmimet e ofertave të paraqitura, fakt ky jo i ditur prej anëtarëve të komisionit të blerjeve të vogla, duke nxjerr në pah se nga ana e AK *<u>të INSTAT, nuk ka pasur trajnime të vazhdueshme pranë APP-së, në mënyrë që burimet njerëzore të jenë të trajnuara dhe të marrjes në në kohë të udhëzimet e miratuara nga strukturat kompetente si KPP dhe APP, konretisht shkresën e datës 01.04.2015, "Rekomandime mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtes fizike.</u>*
Kështu, më pas me revlerësim të situatës së krijuar nga komisioni I mësipërm, është evidentuar se kanë marrë pjesë 6 (gjashtë) OE me të njejtën vlerë ekonomike të njëjtë prej 448,515 lekë pa tvsh, duke aplikuar hedhjen e shortit. Për këtë veprim kanë shprehur dakortësinë të 6 (gjashtë) operatorët ekonomikë, ku OE "[redacted]"shpk, ka tërhequr zarfin me numër 1, kusht ky për shpalljen e fituesit.
Nga auditimi, rezulton se është lidhur Kontratë nr.181/1prot datë 13.05.2015, me shoqërinë "[redacted]"shpk, me vlerë prej 448,515 lekë pa tvsh. Në neni 4 pika 2 thuhet se, " *vlera e kontratës për 5(pesë) roje në një muaj është 224,257 lekë pa tvsh*,(e cila thjesht është pjestuar me vlerën prej dy muaj, duke mos argumentuar përllogaritjen sipas në përputhje me rekomandimet e mësipërme), *Vlera e kontratës përfshin pagat e rojeve, sigurimeve shoqërore si dhe të gjitha shpenzimet plotësuese dhe detyrimet fiskale në fuqi që parashikon ligji*".Gjithashtu, nga monitorimi i kësaj kontrate del se, për këtë vend roje janë paguar 4 roje nga 5 të planifikuar , kjo në bazë të dokumentacionit të depozituar nga administratori i shoqërisë "[redacted]"shpk, kur ka shoqëruar praktikën për urdhër shpenzimi nr324 datë 09.06.2015, me vlerë prej 164,938 lekë me tvsh (nga data 13.05.2015 deri 31.05.2015) për shkak të ndërprejes së kontratës, mbasi ka përfunduar procedura standarte.Pra dukshën del një pagëpër 1 roje e pa argumentuar në bazë të detyrimive kontraktore.

3.Mbi auditimin e proçedurës "Kërkesë për propozim"me mjete elektronike me object "Botime shtypshkrime për INSTAT, për vitin 2015", me fond limit 6,871,087 (gjashtë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë, pa tvsh, financuar nga buxheti i shtetit, për vitin 2015.

1.Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna mbi tenderin	***Komisioni i vlerësimit të ofertave***	***Njësia e prokurimit***
Në bazë të Urdhër Prokurimit të titullarit të AK-së, me shkresë nr.510/1prot datë 07.04.2015 , për realizimin	1.[redacted] Kryetar	1.[redacted],eks/ jasht

procedurës elektronike "Kërkesë për propozim".	2. [redacted] Anëtar 3. [redacted] Anëtar	2. [redacted] sp/hart 3. [redacted] Jurist 4. [redacted] sp/publik
Vlera e përllogaritur e prej 6,871,087, AK ka bërë përllogaritjen, por ky fakt nuk është dokumentuar nga ana shkresore.		
Me shkresën nr.510/2 prot datë 07.04.2015, është ngritur KVO. Afati I hapjes së ofertave në SEP, më datë 06.05.2015 ora11:00.		
NjP, ka ftuar 5 OE, me pretendimin se janë të rregjistruar në sistemin elektronik të prokurimit.		
KVO, në bazë të dokumetacionit ligjor dhe dokumentavepër kapacitetet teknike dhe finaciare,ka skualifikuar 2(dy) OE dhe ka kualifikuar 2 (dy) operatorë, duke shpallur fitues bashkim e operatorëve "[redacted]" me vlerë oferte prej 4,739,840 lekë pa tvsh.		
Titullari i AK, me shkresën nr.722/5 prot datë 21.07.2015 ka miratuar Raportin përbledhës të Komisionit të Ofertave, duke shpallur fitues bashkim e operatorëve "[redacted]".		
AK me subjektin fitues ka lidhur Kontratë nr.722/9 datë 18.08.2015, me vlerë totale prej 5,687,808 (pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëe tetë)lekë me TVSH.		

Nga auditimi u konstatua:

I.Lidhur me përllogaritjen e vlerës së kontratës dhe hartimit të dokumentave të tenderit.

Në mbështetje të Urdhërit të Prokurimit Titullari i autoritetit INSTAT, me shkresë nr.510/1 prot datë 07.04.2015, është ngritur NjP, e cila përbëhet prej katër anëtarësh(duhet në baë të drejtës juridike, cdo komision duhet të përbëhet nga numër tek I barabartë me tre soe me shume, gjithmonë numër tek, në mënyrë që vendimarrje, të mos barazohet në numra).

Nga auditimi, u evidentua se, NjP, është mbledhur më datë 23.04.2015, ku është shprehur se "….lista e artikujve, sasitë, grafiku I kryerjes së shërbimit, si dhe specifikimet teknike për këtë proçedurë prokurimi janë përgatitur nga drejtoritë/sektorët përkatësisht: Sektori I publikimit/Drejtoria e Integrimit Europian, Kordinimit të Projekteve e Publikimeve; Drejtoria e statistikave Ekonomike, Drejtoria e Anketave pranë familjeve dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit/sektori I menazhimit të bazave të të Dhënave dhe metadatës".

Këto specifikime janë vendosur për shkak të natyrës specifike, pasi të gjitha anketa, duhet të kalohen pranë skanerit I cili, bën leximin dhe më pas nga operatorët pranë INSTAT, realizohet përpunimi I dhënave, të cilat relatohet dhe pranë institucioneve ndërkombëtare të njohura në këtë fushë nga shteti shqiptar (EUROSTATI).

Në proces verbal të datës 23.04.2015, gjithashtu janë shprehur se "Autoriteti kontraktor, para daljes së urdhërit të prokurimit, ka bërë përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas zërave të shërbimit të kërkuar nga sektorët/drejtoritë e ineresuara për botim shtypshkrime, bazuar në testimin e çmimeve të tregut, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit public", pra dukshëm ky fond limit nuk është hartuar nga njësia e prokurimit, kështu që detyrimit ish Titullari I AK duhet të kishte ngritur një grup pune për hartimin….e fondit limit, kjo në bazë të ligjit nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 57 (njësia e prokurimit), pika 2.nënpika 3 (*Përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk I është ngarkuar një stukture të posaçme*", pikërisht ne dosjen fizike, nuk rezulton të jetë ngritur një grup për hartimin e fondit limit.

Nga auditimi i vendosjes nga NjP, të kriterit të kapacitetit teknik, pika b, është evidentuar se "*…vërtetimin të lëshuar nga Administrata tatimore që vërteton se subjekti juaj i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, për jo më pak se 29 (njëzet e nëntë) punonjës për periudhën janar- Mars 2015, të vertetuar nga dega e tatim taksave dhe të shoqëruar me listpagesat nga sigurimet shoqërore.Për asye të afatit të limituar dhe rëndësisë së veçantë të këtij shërbimi, operatori ekonomik, duhet të ketë në dispozicion numrin e venojshëm të punonjësve, në mënyrë që të sigurohet në kohë realizimi I proceseve për produktin e cilësisë dhe me kujdesin e duhur, si më poshtë (Disenjemi(faqosja, përgatitja e lay –out për printim, përgatitja e lastrave(montimi), shtypshkrimi i materialeve, prerja dhe palosja e fashikujve të printuar, mbledhja e fashikujve, lidhja (me qepje/ngjitje/tel/penj), ngjitja e kopertanave dhe lidhjet seriale, paketimi i materialeve, transporti (përfshirë ngarkim/shkarkimi) për në institucion i materialeve, sipas kërkesës së autoritetit kontrator*.

Pra nga ana e NjP është bërë përshkrimi që vetë operatori ekonomik, e ka në përputhje me objektin e QKR-së, duke shtuar elementin e numrin të punonjësve, duke mos e argumentuar pse duhet pikërisht ky numër, që deri diku kushtëzojnë garimin e drejtë midis operatorëve.

Gjithashtu, flitet për 1 magazinier, financier dhe 1 përgjegjës për ndjekjen e proceseve, deri diku duket si paradox, pasi cdo OE, ka financier, si dhe natyra dhe specifika e shtypshkrimeve janë të paracaktuar që në momentin e rregjistrimit të aktivitetit. Ky fakt përbën që NjP nuk ka vendosur kriter teknik professional, por thjesht ka evidentuar pjeësn e organizit të proceseve të punës që kryhen nga operatorët ekonomikë në këtë fushë.

II. Vlerësimi I ofertave dhe lidhja e kontratës

Në bazë të Procesverbaleve të datave 06.05.2016 dhe 15.05.2015, KVO, ka realizuar mbylljen në sistemin e fazës së dorëzimit të ofertave, kun ë bazë të SEP me REF…….., kanë paraqitur dokumentacion 4 (katër) operatorë ekonomikë;

1.Bashkimi i OE "[redacted]"shpk dhe "[redacted]"shpk me vlerë oferte 4,820,540 lekë pa tvsh, i kualifikuar

2. "[redacted]"shpk me vlerë oferte 6,343,950 lekë pa tvsh, i kualifikuar

3. "[redacted]" shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, i skualifikuar

4. "[redacted] shpk , nuk ka paraqitur ofertë ekonomike,i skualifikuar

Nga auditimi u evidentua se, në datën 22.05.2015 , shoqëria ""[redacted]"shpk , ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit kontraktor formularin e ankesës, protokolluar në INSTAT me nr.510/7, e për pasojë , titullari I AK, me shkresën nr.510/8 prot datë 22.05.2015, ka nxjerrë Urdhërin për pezullimin e proçedurës së prokurimit. Në datën 29.05.2015, nga komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës me shkresë nr.510/9 prot datë 22.05.2015, është përgatitur një relacion, pasi I është vënë në dispozicion dosja e proçedurës së prokurimit, deri në fazën përkatëse, ku AK me shkresën nr.510/10 prot datë 29.05.2015, AK i ka kthyer përgjigje shoqërisë "[redacted] n"shpk, në të cilën pasqyrohen argumentimet përkatëse, duke e marrë në konsideratë ankesën e saj.

Gjithashtu, në datën 26.05.2015, shoqëria "[redacted]"shpk, me anë të shkresës së protokolluar në INSTAT me nr.722, datë 26.05.2015, ka paraqitur një informacion lidhur me deklaratën mbi konfliktin e interest të paraqitur nga shoqëria "[redacted]"shpk.Me shkresën nr.722/1 prot datë

02.06.2015, "Kërkesë për dhënie mendimi", INSTAT ka komunikuar me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. ILDKP, ka kthyer përgjigje me shkresën nr.2781/1 prot datë 03.06.2015, në të cilën , bazuar në përcaktimet e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin public", I ndryshuar, shoqëria "[redacted]"shpk, duhet refuzuar nëse ka marrë pjesë në këtë proçedurë prokurimi, për arsye se ndodhet në kushtet e konfliktit të interest dhe nuk mund të lidhë kontratë për tenderat e organizuar nga institucionet publike.
Nga auditimi, rezulton se edhe Komisioni I Prokurimit Publik (KPP), me anë të vendimit nr.459/2015, në lidhje me proçedurën e prokurimit "Kërkesë për propozime" me object "Botim shtypshkrime për INSTAT, për vitin 2015". Në këtë vendim KPP-ja ka vendosur që "[redacted]"shpk, duke qënë në kushtet e konfliktit të interest, duhet të skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi dhe AK (INSTAT), të vazhdojë me proçedurën e prokurimit. Në këto kushte, oferta fituese , ka mbetur nga bashkimi I operatorëve ekonomik "[redacted]"shpk dhe "[redacted]"shpk, si oferta e vetme e sukseshme.
Edhe në këtë proçedurë është kërkuar nga Avokatura e Shtetit, nga INSTAT, në referim të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 "për avokaturën e Shtetit", neni 15, dhënie mendimi, për project-Kontrata, kjo në referim të shkresave të dy anëshe me nr.722/7 prot datë 24.07.2015 nga INSTAT dhe shkresës nr.1587/1 prot datë 29.072015 të zyra e Avokatit të Përgjithshëm.

4. Mbi auditimin e proçedurës me objekt "Shërbim mirëmbajtje skanerash për Institutin e Statistikave".

Të dhëna për tenderin	Komisioni Vlerësimit Ofertave	Njësia e Prokurimit
1. Urdhër Prokurimi nr.1196/1, datë 21.10.2015 2. Fondi limit 757,667(shtatëqind e pësëdhjetë e shtaë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh 3. llojii proçedurës së prokurimit "Kërkesë për propozim" 4. Datat e hapjes së kërkesave për pjesëmarrje 05.11.2015. 5. Firmafituese "[redacted]"shpk 6. Dt.e lidhjes kontratës 27.11.2015 7.Vlera kontratës 599,999 (pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëtëqind e nënëtdhjetë e nëntë lekë pa tvsh ose 719,998 lekë me tvsh.	1. [redacted] - Kryetare(Drej e statistika ekonomike) 2. [redacted] - anëtare (përgj në sektorin e zhvillimit të prog kom) [redacted] –anëtare (spec në sektorin të prog kom).	1. [redacted] sp/admi 2. [redacted] sp/rrjetit dhe servera 3. [redacted] sp/sektorin juridik dhe burimeve njerëzore.

Me urdhrin nr.1196 prot, datë 12.10.2015, është ngritur komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.
Në dosje fizike, ndodhet process verbali datë 20.10.2015, ku komisioni I përllogaritjes së fondit limit, ka shprehur argumentimin e hartimit të fondit limit, në bazë të tre ofertave të marrë në mënyrë eletronike ngë tre opeatorë ekonomikë, kjo në mbështetje të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit të prokurimit publik"neni 59 (përllogaritja e fondit limit).

Nga auditimi rezultoi se, ishte arkivuar nevoja e kërkesës për këtë shërbim, nga cila drejtori????
Me datën 21.10.2015, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 1196/1 Prot, me objekt "Shërbim mirëmbajtje skanerash për Institutin e Statistikave", me fond limit në vlerën 757,667 lekë, pa tvsh, me llojin e proçedurës "Kërkesë për propozime".
Me urdhrin nr. 1196/2Prot, datë 21.10.2015, nga Titullari i Autoriteti Kontraktor është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për këtë procedurë prokurimi.
Me datën 23.10.2015, nga Njësia e Prokurimit janë hartuar dhe miratuar dokumentet e tenderit, ku nga auitimi u evidentua se , janë përzgjedhur 5 operatorë ekonomikë, por pa paraqitur argumentimin dhe dokumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomike që kanë ftuar, kjo në kundërshtim me VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit të prokurimit publik"neni 39, pika 4 (kërkesë për propozime).
Me datën 05.11.2015, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka bërë hapjen e procedurës së prokurimit, ku është konstatuar se, është paraqitur vetëm 1 operator ekonomik, nga 5 operatorë të ftuar nga INSTATI.
Çmimet dhe vlera në lekë të ofruara nga operatori ekonomik janë sipas pasqyrës si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik	Çmim i ofertës pa tvsh	Çmim i ofertës me tvsh
1.	[redacted]"shpk	599,999	719,998

Kështu, nisur nga këto kushte , Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në dokumentacionit ligjot, ekonomik dhe financiar, e depozituar pranë sistemit elektronik të APP-, ka vendosur që operatori i vetëm i paraqitur "[redacted]"shpk shpk, është shpallur fitues, me ofertë prej 599,999 lekë pa tvsh.
Me datën 17.11.2015, nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është hartuar Raporti Përmbledhës. Raporti përmbledhës është nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT.
Me datën 27.11.2015, është nënshkruar kontrata nr.1196/7 prot midis palëve për "Jupiter Group" shpk, dhe nga autoriteti kontraktor i INSTAT.
Me datën 17.12.2015, është mbajtur proçesverbalin , për verifikimin e kryerjes së shërbimit për riparimin e skanerave optic, komisioni me përbërje([redacted],[redacted] dhe [redacted]). Nga auditimi rezulton (mungesa e ngritjes së këtij komisioni). Gjithashtu në Kontratën nr.196/7 në nenin 17 (përfaqësimi i palëve) është përcaktuar [redacted] për ndjekjënen dhe zbatimin e kontratës.
Likuidimi në vlerën 719,999 lekë, është bërë në "[redacted]", me datë 22.12.2015, sipas Urdhër-shpenzimi nr.737 datë 22.12.2015.

3.Mbi auditimin e proçedurës "Kërkesë për propozim"me mjete elektronike me object LOTI I"Shërbim mirëmbajtje printera, plotera, USP për kompjutera, UPS për servera", me fond limit 775,233(shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë, dhe LOTI II "Shërbim mirëmbajtje skanerash" (i anulluar) me fond limit 782,000 (shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë) pa tvsh, financuar nga buxheti i shtetit, për vitin 2015.

1.Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

Të dhëna mbi tenderin	***Komisioni i vlerësimit të ofertave***	***Njësia e prokurimit***
Në bazë të Urdhër Prokurimit të titullarit të AK-së, me shkresë nr.721 datë 26.05.2015 , për proçedurën "Kërkesë	1.[redacted] ema kryetar	1. [redacted] spec/ IT

për propozim" e ndarë në : Loti I "Shërbim mirëmbajtje printera, plotera, UPS për kompjutera, UPS për servera me fond limit 775,233 (shtatëqind e shatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e tre)lekë pa tvsh. Loti II "Shërbim mirëmbajtje skanerash, me fond limit 782,000 (shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh (I anulluar).	2. [redacted] anëtare 3. [redacted] anëtar	2. [redacted] spec/ IT 3. [redacted] Jurist
Vlera e përllogaritur e 1,557,233 (një million e pesëqind e pësëdhjetë e shatë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, I ndarë në dy (2) Lote, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.		
Hapja e ofertave datë 08.06.2015, ora:11:00. KVO e ngritur me Urdhër me shkresë nr.721/1 prot, datë 26.05.2015.		
NjP, ka ftuar 5 OE, me pretendimin se janë të rregjistruar në sistemin elektronik të prokurimit.		
KVO, në bazë të dokumetacionit ligjor dhe dokumentavepër kapacitetet teknike dhe finaciare, për Lotin I ka kualifikuar operatorin ekonomik "[redacted]"shpk me ofertë ekonomike 539,999 lekë , pa tvsh dhe të skualifikojë operatorin ekonomik "[redacted]" person fizik për mosparaqitje e të gjithë dokumentacionit të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit. Ndërsa për Lotin II, I ka skualifikuar, në përputhje me bazën ligjore, 3 (tre) operatorë ekonomik "[redacted]"shpk për deformime të fomularit të ofertës në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit; "[redacted]" person fizik, për mosparaqitje e të gjithë dokumentacionit të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit; "[redacted]"shpk për deformime të formularit të ofertës pjesë e dokumentave standarte të tenderit dhe gabimeve aritmetike mbi 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.		
për Lotin I, Tituulari I AK me operatorin fitues "Jupiter Group"shpk ka lidhur Kontratë Shërbimi nr.721/3prot datë 20.07.2015,me vlerë totale oferte 539,999 (pesëqinde tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë , pa tvsh si dhe të anulloj proçedurën për Lotin II, me object "Shërbim mirëmbajtje skanerash", me fond limit 782,000 lëkë pa tvsh		

Nga auditimi u konstatua:

I.Lidhur me përllogaritjen e vlerës së kontratës.

Kjo procedurë është iniciuar në bazë të kërkesës së Drejtorisë së burimeve Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, datë 14.05.2015, me arsyetimin të përdorimit për një kohë të gjatë të pajisjeve kompjuterike dhe nevojës për riparim. Lista e artikujve, specifikimet teknike, sasia dhe grafiku i lëvrimit për objektin e kësaj proçedure janë përgatitur nga sektori i Administrimit të rrjetit të serverave/Drejtoria e teknologjisë së Informacionit.

II. Mbi hartimin e dokumentave të tenderit.

Nga ana e NjP , ka miratuar dhe publikuar pranë app.gov.al me REF……, dokumentat e proçedurës së prokurimit, vendosjen e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për operatorët

pjesëmarrës , e pasqyruar në procesverbalin e datës 27.05.2015. Gjithashtu, nga Njësia e Prokurimit ,nga auditimi u evidentua se, janë përzgjedhur 5 operatorë ekonomikë, me pretendimin se janë të rregjistruar në sistemin elektronik të prokurimeve, duke mos paraqitur argumentimin dhe dokumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomike që kanë ftuar, kjo në kundërshtim me VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit të prokurimit publik"neni 39, pika 4 (kërkesë për propozime).

III.Mbi vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertës fituese.

KVO, në bazë të procesverbalit të datës 08.06.2015 dhe nga auditimi në faqen elektronike të app.gov.al me REF….., për Lotin I me object "Shërbim mirëmbajtje printera, plotera, UPS për kompjutera, UPS për server" u praraqitën 2 (dy) operatorë ekonomikë, kurse për Lotin II "Shërbim mirëmbajtje skanerash" u paraqitën 3(tre)operatorë ekonomikë.Gjithashtu,proçesi për përzgjedhjen e ofertës fituese ka vazhduar me procesverbalin e datës 16.06.2015 e KVO-së, i cili në përputhje me bazën ligjore, për Lotin I ka kualifikuar operatorin ekonomik "[redacted]"shpk me ofertë ekonomike 539,999 lekë , pa tvsh dhe të skualifikojë operatorin ekonomik "[redacted]" person fizik për mosparaqitje e të gjithë dokumentacionit të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit.

Ndërsa për Lotin II, I ka skualifikuar, në përputhje me bazën ligjore, 3 (tre) operatorë ekonomik "[redacted]"shpk për deformime të fomularit të ofertës në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat standarte të tenderit; "[redacted]" person fizik, për mosparaqitje e të gjithë dokumentacionit të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit; "[redacted]"shpk për deformime të formularit të ofertës pjesë e dokumentave standarte të tenderit dhe gabimeve aritmetike mbi 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Bazuar në nenin56, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin public", I ndryshuar neni 66, pika 5, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public", në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, oferta do të vlerësohet anomalisht e ulët, kur ajo është e ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "[redacted]" shpk për Lotin I,me object "Shërbim mirëmbajtje printera, plotera, UPS për kompjutera, UPS për server", nga përllogaritja ka rezultuar si ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte, KVO-ja ka kërkuar nga operatori ekonomik "[redacted]"shpk, të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet dhe elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, të cilin e provuar me shkresën me nr.721/3 prot datë 16.06.2015. Për sa më sipër, KOV e ka vlerësuar sit ë rregullt dhe në përputhje me ligjin ofertën e operatorit ekonimik "[redacted]"shpk, të paraqitur për Lotin I. Nga ana e titullarit të AK, me anë të shkresës nr.721/5 prot datë 26.06.2015, ka miratuar proçedurën e prokurimit "Kërkesë për propozim", duke shpallur fitues për Lotin I, me object "Shërbim mirëmbajtje printera, plotera, UPS për kompjutera, UPS për server" ofertën e paraqitur nga OE "[redacted]"shpk, me vlerë totale oferte 539,999 (pesëqinde tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë , pa tvsh si dhe të anulloj proçedurën për Lotin II, me object "Shërbim mirëmbajtje skanerash", me fond limit 782,000 lëkë pa tvsh, anullohet, bazuar në ligjin nr.9443 datë 20.11.2006 "për prokurimin public" I ndryshuar, neni 24, pika1, shkronja ç, për shka se asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

IV.Mbi auditimin, në lidhjen dhe zbatimin e kontratës.

Nga auditimi, për Lotin I, Tituulari I AK me operatorin fitues "[redacted]"shpk ka lidhur Kontratë Shërbimi nr.721/3prot datë 20.07.2015, duke respektuar të dyja palët detyrimet kontraktore.

Kështu më datë 20.08.2015, sipas procesverbalit, përsoni ndjekës I kontratës I shprehur në nenin 16 (përfaqësimi I palëve), është shprehur se "…nga kontrollet dhe verifikimet e kryera mbi pajisjet object riparimi të parashikuar në kontratën e mësipërme, rezulton se operatori ekonomik "[redacted]"shpk, ka rezlizuar me sukses kryerjen e shërbimit të riparimit, duke përbushur të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në DT.
Me Urdhër shpenzimi nr.476 datë 09.09.2015 me operatorin ekonomik fitues "[redacted]"shpk.

Viti 2016 dhe tremujori i parë i vitit 2017

Nga auditimi mbi përputhshmërinë ligjore në planifikimin dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime për vitin 2016 dhe tremujorin e parë të vitit 2017, jane konstatuar mangësi në hartimin e fondit limit, në përgatitjen e dokumenteve të tenderave, ne pergatitjen e specifikimeve teknike, ne hartimit të kërkesave kualifikuese gjithashtu nuk eshte bere monitorimi i kontratave.Autoriteti kontraktor INSTAT-së, nuk ka njësi prokurimi ne organike por krijohen rast pas rasti komisione prokurimi ad hoc.te pa trajnuar dhe per pasoje zbatimi i disa procedurave te prokurimit paraqiten problematike. ***Njesia e prokurimit ne te gjithe rastet ka filluar procedurat e prokurimit per llogaritjen e fondit limit, testimin e çmimeve ne treg, marrjen e ofertave operatoreve ekonomik,etj. pa u ngritur si Njesi e Prokurimi nga Autoritetit Kontraktor***. Njesia e prokurimit eshte ngritur me daljen e urdherit te prokurimit. Argumentimi dhe perllogaritja e vleres limit te kontrates ne disa objekte prokurimi gjykojme se jane te pa argumentuara si ne tenderin " Sherbim, akomodim hotelerie" dhe "Blerje karburant".
2. **Regjistri i parashikimeve te prokurimit publik 2016**, eshte hartuar nga autoriteti kontraktor INSTAT dhe e derguar ne APP, gjithashtu çdo kater mujor eshte derguar ne APP regjistri i realizimit te prokurimeve publike.
Gjate vitit jane bere tete ndryshime ne regjistrin e parashikimeve te prokurimit publike, keto levizje te fondit limit jane bere brenda totalit. Me daten 09.05.2016 eshte bere nje shtese ne regjistrin e pp me objekt "Sherbim , akomodim hotelerie" me nje fond limit 2 000 000 leke.
Ne shkurt te 2016 eshte bere nje ndarje (pjestim) fondi limit dhe konkretisht tenderi "Kerkese per propozime" te objektit te prokurimit "Sherbim ruajtje objekti INSTAT" me fond limit 3,032,828 leke eshte ndare ne :
Kerkese per propozim 2,534,522 leke
Blerje me vlera te vogla 498,306 "
Nga auditimi rezultoi se ishte lidhur shtesa e kontrates (20%) me nr.375/36 prot, dt. 29.12.2015 e cila perfundonte me 10.02.2016.Periudha nga mbarimi i kontrates shtese deri ne realizimin e tenderit 2016 eshte mbuluar me prokurimet me blerje te vogla.

3- Procedura e prokurimit kerkese per propozim " *Sherbim akomodim hotelerie* ".

Fondi limit 2,000,000 leke me tvsh,
Vlera e kontrates 1,852,439

Me dt.09.05.2016 eshte bere nje shtese ne regjistrin e parashikimeve te prokurimit publik me nje fond limit 2 000 000 leke dhe me daten 03.05.2016 eshte bere nje kerkese nga znj. [redacted], me

detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes se te Dhenave dhe znj.[redacted] detyrë Sekretar i Pergjithshëm I Kordinimit te Zyrës Rajonale Statistikore per prokurimin e sherbimit te akomodim-hoteleri se bashku me specifikimet teknike ku jane percaktuar trajtimi me ushqim e fjetje, nuk ka permendur bazen ligjore per kete trajtim. Njesia e prokurimit e perbere nga znj. [redacted], [redacted] dhe z. [redacted] kane argumentuar perllogaritjen e fondit limit prej 1 812 836 leke pa tvsh duke marre oferta nga dy operatore ekonomik dhe nje kontrate e realizuar. ***Nuk ka nje program te trajnimit te nenshkruar nga titullari i institucionit qe ky trajnim do te kete fjetje dhe trajtimin me ushqim, kafe .***Njesia e prokurimit ka filluar procedurat pa kete program, ajo dorezoi vetem dokumentat " Kalendar i trajnimit" i nenshkruar nga stafi i trajnimit se bashku me listen pjesmaresve ne trajnim.
Ne llogaritjen e fondit limit nuk jane marre per baze kerkesat e VKM nr.329 dt.20.04.2016 " Per trajtimin financiar te punonjesve qe dergohen me sherbim jashte qendres se punes, brenda vendit". Nga nje perllogaritje e bere rezulton se, n.q.s punonjesit qe moren pjese ne trajnim do te trajtoheshin sipas VKM nr.329 dt.20.04.2016 (trajtim financiar 2500 leke/dite +3000 lek/nate per fjetje + shpenzime transport) do te shpenzoheshin rreth **1 300 000 leke.**
Sipas kontrates te lidhur me fituesin e tenderit, kontraktori eshte paguar **1 852 439 leke.**

Konstatojmë se ky prokurim ka dhene nje efekt financiar negativ ne buxhetin e shtetit në vlerën 552,439 lekë.

Gjithashtu konstatohet se nuk eshte hartuar Raporti permbledhes te korektesise dhe cilesise se sherbimit sipas nenit 77, 'mbikeqyrja e kontrates" pika 3 dhe 4 te VKM **nr.** 914, dt.29.12.2014

4-Procedura e prokurimit e hapur , e perqendruar, me objekt "Blerje karburanti"

Fondi limit **2 595 810** leke pa tvsh
Vlera e kontrates e lidhur me fituesin e tenderit eshte **2 595 810** leke pa tvsh
Autoriteti kontraktor INSTAT me shkresen nr. 185 prot.date 08.02.2016 ka derguar kerkesen Ministrise se Puneve te Brendshme per zhvillimin e procedurave te prokurimit "Blerje karburant" duke percaktuar fondin limit 2 595 810 leke pa tvsh dhe sasine e gazoilit prej 21 000 litra.por nuk ka hartuar specifike teknike , grafikun e levrimit , kushtet e veçanta te kontrates te cilat i dergohen Autoritetit qendror te prokurimit, nuk eshte zbatuar neni 2, pika 4 e VKM nr. 914, dt.29.12.2014**.**

Hartimi i kontrates Hartimi i kontrates eshte bere dhe sigluar nga z.[redacted] dhe z [redacted]. Me shkresen nr.185/2 date 17.05.2016 nga INSTAT eshte kerkuar Avokatures se Shtetit per dhenie mendim per projekt-kontraten. Ne pergjigjen e saj nr.374/1 date 25.05.2016 Avokatura e Shtetit shprehet dakort, se kjo kontrate eshte hartuar ne perputhje me VKM nr.1, dt 10.01.2007**. Kjo VKM eshte e shfuqizuar** (*VKM nr.1, dt 10.01.2007 eshte shfuqizuar nga VKM nr. 914, dt 29.12.2014)*
Ne hartimin e kontrates nuk janë respektuar kerkesat e nenit 77, pika 5 te VKM nr. 914, dt 29.12.2014 ne rastet kur çmimi ndryshon, ngrihet apo ulet, çmimi ne fature i shitjes se karburantit mbeshtetet ne deklaraten doganore. Konstatojme se ne kontraten e lidhur me dt.09.06.2016 ne

nenin 8, paragrafi i dyte *"Perllogaritja e çmimit do te behet sipas burses se fundit te karburanteve, i cili publikohet çdo dite te hene ne buletinin e APP"* , nuk pasqyrohet rastet e ritjes apo uljet e çmimi, ne keto raste do te zbatohet çmimi sipas deklarates doganore, pra neni 8, paragrafi i dyte eshte hartuar ne kundërshtim me nenin 77, pika 5 te VKM nr. 914, dt 29.12.2014
Ne kontrate mungon çmimi i kontrates Ne nenin 18 te kesaj kontrate " *Çmimi i kontrates*" shprehet : "*Çmimi i kontrates duhet te jete çmimi i ofruar ne oferte*…Çmimi i kontrates eshte elementi kryesor i nje kontrate i cili ne asnje rast nuk duhet te mungoje.

Mbikeqyrja e zbatimit te kontrates

Perfaqesuesi i Autoritetit kontraktor per ndjekjen e zbatimit te kontrates eshte caktuar z.[redacted] Pergjegjes i Sek.Sherbimeve
Konstatojme shkelje te nenit 77, pika 3 te VKM nr. 914, datë29.12.2014 lidhur me mbikeqyrjen e e zbatimit te kontrates**,** nuk eshte bere monitorimi i kontrates per te siguruar cilesine e karburantit, nuk ka asnje analize, as testim nga pala e autoritetit kontraktor INSTAT."Nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates kjo ne shkelje te pikes 4 te nenit 77 te VKM **nr.** 914, datë 29.12.2014**.**
Nga auditimi i dokumentacionit te zbatimit te kontrates konstatuam se gjate levrimit periodik te mallit çmimi i karburantit eshte ritur ne te gjithe rastet e furnizimit kjo e pasqyruar ne faturat tatimore si me poshte:

-Fatura tatimore	nr.55 datë 29.06.2016	çmimi pa tvsh	**135.51** leke/liter
- " "	nr.93 datë 06.09.2016	çmimi pa tvsh	**134.37** leke/liter
- " "	nr.17 datë 21.11.2016	çmimi pa tvsh	**133.40** leke/liter
- " "	nr.22 datë 27.12.2016	çmimi pa tvsh	**143.63** leke/liter

Çmimi i fituar nga operatori ekonomik "[redacted]" sh,a. eshte 123.61 leke /liter pa tvsh

Kontraktori ne faturat tatimore te shitjes se karburantit ka pasqyruar çmimin sipas burses se fundit te karburantit ne momentin e shitjes, ne baze te nenit 8 te kontrates se lidhur midis dy paleve me dt. 09.06.2016
Siç e permendem me lart neni 8, i kesaj kontrate, paragrafi i dyte *"Perllogaritja e çmimit do te behet sipas burses se fundit te karburanteve, i cili publikohet çdo dite te hene ne buletinin e APP"* eshte hartuar nga Autoriteti kontraktor INSTAT ne shkelje te nenit 77. pika 5 te VKM **nr.** 914, datë 29.12.2014. Ne piken 5 citohet: " **Nese çmimi gjate kohes se zbatimit te kontrates, per furnizimin me karburant, sipas Reuters, ndryshon dukshem ne ulje apo ne ngritje , me kerkese me shkrim te paleve dhe ne varesi te çmimit te ndryshueshem te blerjes ne tregjet nderkombetare, kontraktori pasqyron ne faturat periodike te shitjes çmimin e mallit mbeshtetur ne deklaraten doganore SAD**".
Autoriteti kontraktor INSTAT meqenese çmimi eshte ritur dukshem ishte i detyruar te bente kerkese me shkrim pales tjeter ku ti kerkonte pasqyrimin ne faturen tatimore te shitjes çmimit e karburantit mbeshtetur ne çmimin e deklarates doganore te furnizimit te fundit.Sqarojme se ne çmimin e deklarates doganore eshte pasqyruar ritja e çmimit sipas burses ne ate moment qe eshte

blere karburanti ne tregjet nderkombetare. Ky mosveprim i Autoriteti kontraktor INSTAT konstatojme se perben shkelje te nenit 77. pika 5 te VKM nr**.** 914, datë 29.12.2014.
Kontraktori nga ky mos veprimi i Autoritetit kontraktor INSTAT ka perfituar nga ritja e çmimit sipas burses ne momentin e blerjes se karburantit dhe pas magazinimit qe e ka gjendje ne depozitat e tij pas nje periudhe te gjate rreth 50 dite nga kjo gjendje ben shitjen INSTAT-it me çmimin sipas ritjes se burses ne momentin e shitjes.Per kontraktorin ka dy çmime;

Çmimi ne blerje (CIF çmimi i blerjes se karburantit sipas burses te momentit , shpenzime transport, premio, pagesen e detyrimeve doganore si akciza, takes karboni takes qarkullimi, takes marketing shtuar ketu dhe marzhin e fitimit 16.4 % etj.

Çmimi ne shitje Kontraktori nga karburanti i magazinuar ben shitjen e tij sipas çmimit te burses se asaj dite qe rastin tone çmimi ne burse eshte ritur njekohesisht eshte ritur edhe marzhi i fitimit mbi 16.4 %
Diferenca midis çmimit te shitjes dhe atij te blerjesi i mbetet si perfitim kontraktorit. Ky eshte perfitim i padrejte , kontraktori ka konkuruar ne tender vetem per marzhin e fitimit i cili e ka fituar me 16.4 % dhe po te perllogaritesh nga fatura e shitjes me cmimin e deklarates doganore ky marzh i fitimit eshte ritur padrejtesisht me ate qe ka konkuruar dhe fituar ne tender, ndersa akciza, taksa e karbonit taksa e qarkullimit dhe taksa e markimit te karburantit eshte paguar ne momentin e ç'doganimit te karburantit (çmimi i blerjes) dhe pastaj ne momentin e shitjes se mallit qe eshte gjendje , keto taksa megjithese u rit perseri çmimi sipas burses nuk paguhen nga kontaktori por shkojne ne fitim te tij pra, riti marzhin e fitimit ne kundershtim me ate qe ka konkuruar ne tender.Dhe konkretisht per shitjen e 1500 litra karburant nga kontraktori ka aplikuar **çmimin ne shitje** e pasqyruar ne faturen tatimore nr.55 datë 29.06.2016, e shoqeruar me Raport analize date 08.05.2016.

<u>Ne dosje mungojne deklaratat doganore .</u>

Deklarata doganore e kontraktorit "[redacted]" sh.a. date 07.05.2016 e nxjere nga sistemi i Drejt Pergj. Doganave, çmimi i blerjes rezulton :

Çmimi CIF 342.71 $/ton
Premio 30 $
Kursi zyrtar i kembimit $ 121.56 leke

Nga nje llogaritje e elementeve te kostos se çmimit ne blerje rezulton si me poshte:

Nr	Emertimi	Çmimi $/ton	Kursi kembimit	Vlera Lek/ton	Vlera Lek/kg	Densiteti	Vlera Lek/liter
1	Deklarata doganore	342.71	121.56	41660	41.7		
2	Premio	30 $	121.56	3647	3.64		
	Çmimi i blerjes				45.34	0.8396	**38.07**
a	Akciza						37
b	Takse karboni						3
c	Takse qarkullimi						27
	Takse markimi karburant						0.614

	Marzhi i fitimit					16.4	17.33
	Çmimi per njesi pa tvsh						**123.01**
	Tvsh						24.6
	Çmimi me tvsh						147.61

Pra, çmimi i blerjes me te gjithe elementet e kostos eshte 147.61 leke/liter me tvsh
Çmimi i shitjes ne faturen tatimore date 29.06.2016 eshte 162.62 leke/liter me tvsh
Diferenca 15.01 leke/liter me tvsh
15.01 leke/liter x 1500 litra = 22 515 leke
Pra, siç rezulton vetem nga mos aplikimi i çmimit te mbeshtetur ne deklaraten doganore per blerjen e 1500 litrave gazoil, efekti negativ financiar eshte 22 515 leke, analoge eshte edhe me blerjen e 18 500 litra te tjere ku ritja e çmimit eshte edhe me e madhe.

5. Procedura e prokurimit , kerkese per propozime " Sherbim ruajtje objekti"
Fondi limit **2 534 522** leke pa tvsh
Vlera e kontrates e lidhur me fituesin e tenderit eshte **2 355 668,7** leke pa tvsh
Njesia e prokurimit ka argumentuar perllogaritjen e fondit limit duke marre oferta nga tre operatore ekonomik.Per mbulimin e ketij sherbimi ne kerkesen e Drejtorit te Burimeve Njerezore dhe Sh.B. kane percaktuar pese roje per nje vend roje.Ne dosje nuk ka argumentim ne percaktimin e numurit te rojeve per nje vend roje. Nga perllogaritjet rezulton 5 roje ne 24 ore per nje vend roje. Ne kontraten e lidhur me dt 26.04.2016 mungon vlera totale e kontrates. Ne nenin 14" Çmimi i kontrates shprehet : " *Çmimi i kontrates duhet te jete çmimi i ofruar ne oferte…*" ndersa tek neni 7 kushtet e pageses jepet vlera e kontrates vetem per nje muaj qe eshte 224 349,4 leke pa tvsh.
Njesia e prokurimit nuk ka plotesuar me dokumentacionin qe ka te beje me mbikeqyrjen e zbatimit te kontrates.Nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates kjo ne shkelje te pikes 4 te nenit 77 te VKM nr.914, dt.29.12.2014.Ne dokumentacionin e likujdimit te faturave tatimore ne sektorin e finances gjendeshin proces-verbalet e kontrollit dhe te verifikimit per plotesimin e kushteve te kontrates.

6. Procedure prokurimi " Negocim pa shpallje paraprake", me objekt " *Sherbim e ruajtje objekti"*
Fondi limit **303 495** leke pa tvsh
Vlera e shtese se kontrates **303 495** " "
Nga auditim rezulton se ne dosje gjendet vetem shtesa e kontrates (20 %) me nr.375/35 prot, date 08.06.2016. Per realizimin e kesaj procedure nuk ka Urdher Prokurimi dhe nuk jepet asnjë dokument mbi përllogaritjen e fondit limit etj.
-Procedure prokurimi me vlere te vogel me objekt " Sherbim ruajtje objekti INSTAT"
Fondi limit **482 766** leke pa tvsh
Vlera e kontrates se realizuar **448 698, 8** " "
Procedura ka filluar me kerkesen date 10.02.2016 te Drejt B.Njerzore dhe Sh. Mbeshtetese.per nevoja te ruajtjes se godines INSTAT.Komisioni i prokurimit me vlera te vogla ka argumentuar perllogaritjen e fondit limit duke marre oferta nga tre operatore ekonomik.Mungon argumentimi per numurin e rojeve per nje vend roje por eshte marre per baze ajo e kontrates fillestare.

7.Procedura e prokurimit, e hapur, me mjete elektronike, kerkese per propozime *' SHerbim mirembajtje pajisje kompjuterike"*
Fondi limit 1 473 833 leke pa tvsh

Loti I: "Sherbim mirembajtje printera, plotera, UPS per kompjutera,
UPS per servera 695 500 leke pa tvsh
Loti II: "Sherbim mirembajtje server 778 333 leke pa tvsh

Ne lotin e i KVO skualifikoi te dy operatoret ekonomike per mos paraqitje dokumentacioni te kerkuar si dhe ne lotin e II te skualifikoje tre operatore ekonomik per mos paraqitje te dokumentacionit te kerkuar.Nga autoriteti kontraktor jane respektuar afatet e ankimimit , ankesa nuk ka patur. Ne kontraten e lidhur me daten 04.08.2016 nuk ka detajuar penalitetet per kontraktuesin per sherbimin qe do te kryeje.
Njesia e prokurimit nuk ka plotesuar me dokumentacionin qe ka te beje me mbikeqyrjen e zbatimit te kontrates.Nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates kjo ne shkelje te pikes 4 te nenit 77 te VKM nr**.** 914, dt.29.12.2014.
8.Procedura e prokurimit , kerkese per propozime *" Blerje liçenca"*
Fondi limit 4 833 307 leke pa tvsh
Ndare ne pese lote .
Njesia e prokurimit ka argumentuar perllogaritjen e fondit limit duke marre oferta nga tre operatore ekonomik.Nga shqyrtimi i dokumentacionit kualifikues KVO ka skualifikuar ne lotin 1 nje operator ekonomik, ne lotin 2 skualifikohen dy operatore ekonomik, ne lotin 3 skualifikohen dy operatore ekonomik, ne loti 4 skualifikohen dy operatore ekonomik dhe ne lotin 5 skualifikohen dy operatore ekonomik.Te gjithe operatoret ekonomik jane skualifikuar pasi nuk kane paraqitur dokumentat e kerkuara per kualifikim. Nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates
9.Procedura e prokurimit e hapur , e perqendruar me objekt, *" Blerje material kancelarie dhe leter"*financuar nga buxheti i shtetit

Fondi limit 988 330 leke pa tvsh
Procedura e prokurimit eshte e perqendruar dhe eshte realizuar nga Ministria e Brendshme
Hartimi i kontrates Me shkresen nr.186/5 date 09.06.2016 nga INSTAT eshte kerkuar Avokatures se Shtetit per dhenie mendim per projekt-kontraten. Ne pergjigjen e saj nr.542/1 date 14.06.2016 Avokatura e Shtetit shprehet dakort me nje VKM te shfuqizuar.(VKM nr.1, dt 10.01.2007 eshte shfuqizuar nga VKM nr. 914, dt 29.12.2014)
Mbikeqyrja e zbatimit te kontrates
Ne kontrate autoriteti kontraktor nuk ka percaktuar perfaqesuesin pergjegjes per monitorimin e e kontrates. Mungon Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates kjo ne shkelje te pikes 4 te nenit 77 te VKM nr**.** 914, dt.29.12.2014**.**
Kontraktori ka dorzuar mallin e lotit I me faturen tatimore nr. Serie 119860290 date 28.07.2016, me vlefte 444 342 leke me tvsh Komisioni i pritjes se mallit ka marre ne dorezim mallin me proces-verbalin date 28.07.2016 , magazinuar me flete-hyrjen nr. 13 date 28.07.2016. Kontraktori

ka dorzuar mallin e lotit II me faturen tatimore nr. Serie 119857374 date 15.06.2016, me vlefte184 147 leke me tvsh Komisioni i pritjes se mallit ka marre ne dorezim mallin me proces-verbalin date 15.06.2016 , magazinuar me flete-hyrjen nr. 7 date 15.06.2016.

10.Proçedura e hapur, me mjete elektronike, me objekt "botim shtypshkime për INSTAT per vitin 2016", financuar nga buxheti i shtetit.

Fondi limit 8 291 579 leke pa tvsh

Vlera e kontrates se realizuar 5 355 366 " "

Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se, njesia e prokurimit eshte ngritur me Urdherin e prokurimit date 02.03.2016 ndersa njesisa e prokurimit ka filluar punen per hartimin dhe llogaritjen e fondit limit para se te dale urdheri i prokurimit. Argumentimi i fondit limit eshte bere me daten 01.03.2016, duke u mbeshtetur ne ofertat e marra nga dy operatore ekonomike.Nga punonjes te Sek. Zhv. Programeve Kompjuterike eshte realizuar testimi me skaner optik te INSTAT i mostrave te pyetsoreve te paraqitur nga operatoret ekonomik te cilat jane pasqyruar ne Raportin Teknik date 19.04.2016.Kane paraqitur oferta pese operatore ekonomike. KVO nuk ka kualifikuar operatorin ekonomik "[redacted] " shpk per mangesi ne dokumentacion.Eshte bere ndjekja afateve te procedurave te ankimimit

Kontraktori ka dorzuar mallin me faturen tatimore. Komisioni i pritjes se mallit ka marre ne dorezim mallin me proces-verbal dhe eshte magazinuar.

Nga auditimi konstatohet se nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates.

11.Procedura e prokurimit Kerkese per Propozime , me mjete elektronike, objekti,

*" Blerje pjese nderrimi paisje kompjuterike"*financuar nga buxheti i shtetit

Fondi limit 2 131 210 leke pa tvsh

Loti I Blerje pjese nderimi per printera **1 410 010 leke pa tvsh**

Loti II Blerje pjese nderrimi per kompjutera dhe server **721 200 leke pa tvsh**

Vlera e kontrates se realizuar loti II 687 776 leke pa tvsh

Argumentimi i fondit limit eshte realizuar duke u mbeshtetur ne ofertat e marra nga tre operatore ekonomik.Specifikimet teknike, sasia e pjeseve te nderrimit jane pergatitur specialistet e Dr. Tekn. dhe Informacionit

KVO ka bere shqyrtimin e dokumentave kualifikuese, atij teknik ne lotin e I dhe te II ka skualifikuar operatorin ekonomik "[redacted]" sh.p.k.me arsyen se nuk kishte paraqitur asnje nga dokumentat e kerkuara ne dokumentat e tenderit.

Operatori ekonomik "[redacted] " sh.p.k. me shkresen 615/5 date 08.07.2016ka kerkuar doreheqjen nga tenderi me arsyen se kompania prodhuese ka kryer ritje te çmimeve.Autoriteti kontraktor ne mungese te ofertave te tjera ka vendosur anullimin e procedures se prokurimin dhe rishpalljen ne Sistemin Elek. te Prokurimeve

Mbikeqyrja e zbatimit te kontrates.

Ne kontrate nuk ka te percaktuar garancite e pjeseve si dhe penalitetet per kontraktuesin per vonesat ne levrimin e mallit.

U konstatua se nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates kjo ne shkelje te pikes 4 te nenit 77 te VKM nr**.** 914, dt.29.12.2014**.**
Kontraktori ka dorzuar mallin e lotit II me faturen tatimore nr.1688 date 25.08.2016, me vlefte 687 776 leke me tvsh Komisioni i pritjes se mallit ka marre ne dorezim mallin me proces-verbalin date 25.08.2016 , magazinuar me flete-hyrjen nr. 80 date 25.08.2016.

12.Procedura e prokurimit Kerkese per Propozime , me mjete elektronike, objekti, *" Blerje pjese nderrimi per printera"* financuar nga buxheti i shtetit , Urdher Prokurimi nr.1114 prot date23.09.2016
Fondi limit 1 410 010 leke pa tvsh
Vlera e kontrates se realizuar 1 316 694,36 " "
Kjo procedure eshte e perseritur dhe perllogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike jane ato te procedures se mepareshme (Loti I) Jane ftuar pese operatore ekonomik nga te cilit vetem dy kane paraqitur oferta, jane kualifikuar te dyja dhe fitues eshte shpallur operatori ekonomik "[redacted]**"** sh.p.k. Ne kontrate ne nenin 18 "Çmimi i kontrates" shprehet : "*Çmimi i kontrates duhet te jete çmimi i ofruar ne oferte*…" Ne momentin e lidhjes se kontrate vlefta e kontrates eshte percaktuar 1 316 694, 36 leke pa tvsh ky eshte element kryesor i kontrates , po ashtu dhe ne nenin 17 "Garancite" duhet te vendosej se garancia e pjeseve te nderimit te printerave eshte nje vit nga data e lidhjes se kontrates (30.11.2016 deri 30.11.2017).
U konstatua se nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates
Kontraktori ka dorzuar mallin me faturen tatimore nr.M3012-01/16 date 30.12.2016, me vlefte 978206,28 leke me tvsh Komisioni i pritjes se mallit ka marre ne dorezim mallin me proces-verbalin date30.12.2016 , magazinuar me flete-hyrjen nr. 49 date 30.12.20162016.
13.Procedura e prokurimit e hapur, me mjete elektronike, *' SHerbim mirembajtje printera, plotera,UPS per kompjutera, UPS per server."*
Fondi limit 695 500 leke pa tvsh
Vlera e kontrates se realizuar 626 730 " "
Procedurat e prokurimit kane filluar bazuar ne Urdherin e Prokurimit nr.871 prot date 14.07.2016 Llogaritja e fondit limit dhe specifikimet teknike jane ato te nje procedure te mepareshme te analluar, Urdher Prokurimi nr.527 prot date 03.05.2016Kriteret e pergjitheshme dhe te veçanta te kualifikimit jane miratuar sipas proces-verbalit date 14.07.2016 . Ne kete procedure paraqiti oferte vetem nje operator ekonomik "[redacted]". Me oferte 626 730 leke pa tvsh ecila u kualifikua nga KVO pasi plotesonte kriteret per kualifikim. Nga auditimi konstatohet se nuk eshte bere Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates.
14.Procedura e prokurimit Kerkese per Propozime , me mjete elektronike, objekti, *" Sherbim internet"* financuar nga buxheti i shtetit , Urdher Prokurimi nr.256 prot date 19.02.2016
Fondi limit 2 409 212 leke pa tvsh
Argumentimi i fondit limit eshte realizuar duke u mbeshtetur ne ofertat e marra nga operatoret ekonomik "[redacted]","[redacted]" dhe "[redacted]".Specifikimet teknike per sherbimin e internetit jane pergatitur nga Sek. Administrimit te rrjetit dhe serverave.Jane ftuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi pese operatore ekonomik te regjistruar ne sistemin e prokurimit elektronik.

Ne lotin I kishin paraqitur dokumentacionin dhe oferten ekonomike tre operatore ekonomike nga keto skualifikohet operator ekonomik"[redacted]" sha per mungese te vertetimit te shlyerjes se energjise elektrike.
Ne lotin II kishin paraqitur dokumentacionin tre operatore ekonomike nga keto skualifikohet operator ekonomik"[redacted]" shpk dhe "[redacted]" sha pasi nuk kane paraqitur oferte ekonomike dhe mungesa ne dokumentacion. KVO shpalli fitues :
Loti I oferta e operatorit ekonomik "[redacted]" sha me vlefte 560 000 leke pa tvsh
Loti II oferta e operatorit ekonomik "[redacted]" sha me vlefte 598 500 leke pa tvsh
Monitorimi i kontrates eshte realizuar dhe pasqyruar me proces-verbalet perkatese por mungon hartimi i Raporti permbledhes i korrektesise dhe cilesise e zbatimit te kontrates.

Realizimit i prokurimeve publike për tremujorin e pare 2017, të INSTAT i cili paraqitet si me poshte:

Nr	Lloji i proçedurës	Sasia	Fondi limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (me TVSH)
1.	Kërkesë për propozim	4	12 985 107	13 400 603,72
2.	Negocim pa shpallje (20% shtese kontrate)	3	505 701,85	575 738
3	Prokurim i përqëndruar Ministria e Breëndshme	3	3 541 423,74	-
4	Prokurimet me vlerë të vogël	8	748 524	850 178
5	Proçedurë emergjente	1		85 000
	TOTALI			

<u>15 Procedura e prokurimit , kerkese per propozime "Sherbim ruajtje objekti "2017 me Urdher Prokurimi nr. 182 prot. Datë 30.01.2017</u>
Fondi limit **2 416 467** leke pa tvsh
Vlera e kontrates e lidhur me fituesin e tenderit eshte **2 346 904,87** leke pa tvsh
Njesia e prokurimit e ka argumentuar numurin e rojeve per nje vend roje ne 24 ore. perllogaritjen e fondit limit duke marre oferta nga kater operatore ekonomik.Moren pjese ne konkurim 24 opertaore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KVO ka skualifikuar dy operatore ekonomike per mos paraqitje te dokumentave te kerkuara per kualifikim.Ankimime nuk ka patur. Operatori ekonomik "[redacted]" shpk. Shpallet fitues per oferten ekonomike 2 346 467 leke pa tvsh.
Kjo procedure ndodhet deri ne fazen e Lidhjes se kontrates..

16. Procedure prokurimi " Negocim pa shpallje paraprake", me objekt " *Sherbim e ruajtje objekti" 2017*
Fondi limit -
Vlera e shtese se kontrates 439 724,8 me leke tvsh
Nga auditim rezulton se ne dosje gjendet vetem shtesa e kontrates (20 %) me nr. 208/32 prot, date 30.12.2016. Per realizimin e kesaj procedure nuk ka Urdher Prokurimi dhe nuk jepet asnjë dokument mbi përllogaritjen e fondit limit etj.

17. Procedure prokurimi " Negocim pa shpallje paraprake", me objekt " *Sherbim mirmbajtje serverash" 2017*
Fondi limit -
Vlera e shtese se kontrates 57 142, 85 me leke tvsh
Nga auditim rezulton se ne dosje gjendet vetem shtesa e kontrates (20 %) me nr. 327/4 prot, date 30.12.2016. Per realizimin e kesaj procedure nuk ka Urdher Prokurimi dhe nuk jepet asnjë dokument mbi përllogaritjen e fondit limit etj.

18. Procedure prokurimi " Negocim pa shpallje paraprake", me objekt " *Sherbim internet per Zyrat Rajonale te INSTAT" 2017*
Fondi limit -
Vlera e shtese se kontrates 63 680 leke pa tvsh
Nga auditim rezulton se ne dosje gjendet vetem shtesa e kontrates (20 %) me nr. 256/15 prot, date 30.12.2016. Per realizimin e kesaj procedure nuk ka Urdher Prokurimi dhe nuk jepet asnjë dokument mbi përllogaritjen e fondit limit etj.
19.Procedure prokurimi emergjente per 2017
Komisioni i prokurimit me vlere te vogel, i krijuar me urdherin e brendshem Nr.58, date 31.01.2017 ka bere prokurimin emergjent " *iparim defekti ne panelin qendror te komandimit te gjeneratorit*" argumentimi ne proces verbal te dates 02.02.2017 se ky difekt vinte ne rezik serverat qendrore.
Procedurat e tjera te prokurimit te vitit 2017 jane ne proces.

IV. IV. Përputhshmëria ligjore, analiza dhe vlerësimi i auditimit të brendshëm.

Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara. Auditimi i përputhshmërisë me Ligji nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".*

-Nga auditimi rezultoi se përgjatë vitit 2015 – 2017 kjo strukturë rezulton ende e pa plotësuar me burime njerëzore. Kjo stukturë gjithmonë është parashikuar me tre punonjës , me përbërje (1(një) përgjegjës sektori të auditimit dhe 2 (dy) auditues). Arsyetimin nga ana e drejtuesve të institucionit INSTAT, është justifikuar me dështimin e proçedurave të rekrutimit nga Departamenti i Administratës Publike (DAP). Kështu për rrjedhojë, sektori i auditimit të brendshëm nuk ka realizuar të gjitha e auditimet e planifikuara në fillim të viteve. Gjithashtu nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT është krijuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm për INSTAT, me Urdhër të Brendshëm me nr. 1118. prot, datë 23.09.2016, në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 12, gërma b, si dhe VKM nr. 160, datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike". *Risia e krijimi të këtij komiteti është që të në mënyrë të vazhdueshme (të paktën 4 herë në vit) jep këshillime dhe sugjerime titullarit* të INSTAT, në lidhje me:

- ✓ sigurinë pavarësinë e audituesit të brendshëm;
- ✓ vlerësimin dhe mendime për planin strategjik dhe vjetor;
- ✓ vlerësimin e përshtatshmërisë së burimeve të auditimit;
- ✓ sigurinë dhe monitorim e zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
- ✓ monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna;
- ✓ këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

-Nga auditimi u evidentua se sektori i auditimit të brendshëm në strukturën e fundit e miratuar me Urdhër të Kryeministrit me nr. 28, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave", ka patur ndryshime në pagë, ku inspektori i auditimit deri në 2016 ka patur pagën III-b, ndërsa me strukturën e re që është miratuar në vitin 2017 ky pozicion është ndryshuar në specialist dhe me pagë IV-a, element monetar i vlerësimit të punës, duke mos stimuluar burimet njerëzore të aplikojnë dhe të konkurojnë pranë DAP-it.
-Nga auditimi rezultoi se në muajin tetor të vitit paraardhës janë hartuar planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm që do realizohen për vitin pasardhës, duke marrë miratimin nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT dhe Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave. Kjo në përputhje me

- ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, neni 18, pika2.
- ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 12, gërma d..

Nga auditimet e realizuara NjAB e INSTAT vihet re se ka renie të numrit të planifikimit është në rënie për arsye të mungesës së theksuar të burimeve njerëzore.
Struktura e INSTAT ka në varësi dhe zyrat rajonale (Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër, Lezhë, Dibër, Durrës; Vlorë, Fier, Kukës, Berat, Gjirokastër.)
Në përgjithësi nga NJAB është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm .
Nisur nga sa më sipër, grupi audituesve, ka konstatuar si më poshtë vijon:
Për vitin 2015 planifikimi i auditimeve nga NjAB ishte 10 auditime, ku janë realizuar 8 të tilla, pranë zyrave rajonale (Durrës, Elbasan, Shkodër, Gjirokastër dhe Vlorë) dhe drejtorive të statistikave në INSTAT (Anketa e BSH, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e IT).
-Nga auditimi, mbi auditimin që ka realizuar NjAB, rezultojnë gjetje dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi, në fushën e pagave (në zyrat rajonale duke përbërë zonën me risk më të lartë), në administrimin dhe protokollimin e dokumentacionit në (zyrat rajonale).
-Nga auditimi,mbi auditimin që ka realizuar në anketat e Bankës së Shqipërisë rezultojnë gjetje organizative për të patur një monitorim më të mirë të proceseve të punës dhe të bashkëpunimit midis dy institucioneve është rekomanduar që kontratat të nënshkruhen në fillim të vitit, në mënyrë efektet financiare për anketuesit dhe operatorët të merren në kohën e duhur dhe jo me vonesa mujore.
-Nga auditimi i grupit të KLSH janë audituar 3 dosje të realizuara në zyrat rajonale Vlorë, Gjirokastër dhe Shkodër dhe anketa e Bankës së Shqipërisë, ku rezulton se nga, NjAB dosjet nga

ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i financave dhe Udhëzimi nr. 12, datë 05.06. 2012 "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik".

-Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i Përgjegjësit të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bërë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.

-Në mes të vitit 2015 sektori i auditimit të brendshëm ka funksionuar vetëm me përgjegjësin e sektorit, pra duke patur dy vende vakante.

Në fund të muajt nëntor 2015 është rekrutuar nga DAP vetëm një inspektor auditimi. Si rrjedhojë sektori i auditimit ka vazhduar të funksionojnë përsëri me dy punonjës (një përgjegjës sektori dhe një inspektor auditimi).

Sektori i auditimit të brendshëm për vitin 2015 ka dhënë 31 rekomandime ku më konkretisht:

- ✓ 8 rekomandime janë në nivel të ulët;
- ✓ 23 rekomandime janë të nivelit të mesëm.



Raportimi me Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm (DHAB) në Ministrinë e Financave

- Sipas ligjit nr. 9720, datë 23.04.2017 "Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik", i ndryshuar neni 18, pika 2 është dërguar në DHAB "Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm të INSTAT, periudha 2016 – 2020" me shkresën nr. 1158/1, datë 20.10.2015.
- Nga INSTAT është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm "Raportimi vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të INSTAT" me nr. shkrese 28, datë 11.01.2016 "Për raportimin e veprimtarisë audituese për vitin 2015 dhe evidencat përkatëse", në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 14 gërma ç.

Raportimet janë dërguar brenda afateve kërkuara dhe janë sipas kërkesave dhe metodologjisë së kërkuar nga DHAB.
Në planet strategjike dhe vjetore parashikimi i auditimeve ka qenë në 10 auditime në vit, pasi sektorit të auditimit të brendshëm është mbështetur se struktura e saj do plotësohej e gjitha dhe do funksiononte me kapacitet të plotë.

Rekomandimet e lëshuara nga sektori i auditimit të brendshëm INSTAT -



Rekomandime të cilat nuk janë realizuar

- Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, për të patur një monitorim më të mirë të proceseve të punës dhe të bashkëpunimit midis dy institucioneve të merren masa që kontratat midis dy institucioneve të nënshkruhen në fillim të vitit.

✓ *Afati i realizimit: në vazhdimësi*

- Të shikohet mundësia pas një studimi të mirë kosto përfitim për blerjen e sistemeve më të avancuara për monitorimin e akseseve në sistem si dhe ngritjen e alarmeve në raste kur ka hyrje të pautorizuara.

✓ *Afati i realizimit, në vazhdim*

- Të shikohet mundësia pas një studimi të mirë kosto përfitim për vendosjen e kamerave brenda dhomës së serverëve

✓ *Afati i realizimit, Në vazhdim*

- Të shikohet mundësia pas një studimi të mirë kosto përfitim për vendosjen e një sistemi "akses controller" për të bërë të mundur hyrjen në dhomën e serverit nëpërmjet një karte dixhitale dhe jo me çelës.

✓ *Afati i realizimit, në vazhdim*

- Vendosjen e një sistemi kundër zjarrit për të bërë shmangien e ndonjë fatkeqësie

✓ *Afati i realizimit, në vazhdim*

- Të gjitha botimet e Drejtorisë së Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit të cilat publikohen në faqen zyrtare të INSTAT, t'i dërgohet një kopje e tyre në zyrën e protokoll arkivës dhe dy kopje në bibliotekën e INSTAT.

✓ *Afati i realizimit, menjëherë dhe gjithnjë.*

- Ndryshimet e metodologjisë të miratohet nga drejtori i drejtorisë së statistikave të bujqësisë dhe mjedisit

✓ *Afati i realizimit, menjëherë dhe gjithnjë.*

Si konkluzion fakti që nga NJAB janë lënë 31 dhe nuk janë realizuar vetëm 6 prej tyre duhet që INSTAT të marrë masat e duhura që këto rekomandime të realizohen me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në INSTAT.

Për vitin 2016 **,** planifikimi i auditimeve nga NJAB ishte 9 auditime, ku janë realizuar 7 të tilla, pranë zyrave rajonale (Fier, Berat, Lezhë, Korçë, Kukës, Dibër) dhe auditimin e fondeve IPA.

Nga auditimi që ka realizuar NJAB rezultojnë gjetje dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi, në fushën e pagave (zyrat rajonale) duke përbërë zonën me risk më të lartë, në administrimin dhe protokollimin e dokumentacionit në (zyrat rajonale).

Nga auditimi i dosjeve u evidentua se sektori i auditimit të brendshëm në subjektet që ka audituar në raportet e tij ka lënë rekomandime të cilat kanë patur karakter organizativ dhe administrativ (në llogaritjen e pagave dhe dietave). Përgjithësisht nga auditimit është synuar formësimi i sistemit të kontrolleve të mendshëm.

Për vitin 2016 janë dhënë nga sektori i auditimit të brendshëm 34 rekomandime ku:

✓ 6 rekomandime me nivel të ulët;

✓ 26 rekomandime me nivel të mesëm;

✓ 2 rekomandime me nivel të lartë;

Këto rekomandime përgjithësisht janë zbatuar, ndërsa ka disa rekomandime që janë akoma në proces zbatimi (nuk janë kaluar afatet nga subjekti i audituar).

Rekomandimet e lëshuara nga sektori i auditimit të brendshëm INSTAT



Rekomandime të cilat nuk janë realizuar

- Rekomandime për pagën bruto si diference midis pagës përfituar realisht në kategorinë IV-a me pagën e aktit të emërimit në kategorinë IV-b

✓ *Afati i realizimit Qershor 2017*

- Për trajtimin financiar të punonjësve, që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës , brenda vendit

✓ *Afati i realizimit brenda 3 muajve (nëntor 2016)*

- Për paga të marra dhe kontribute të derdhura më tepër në zyrën rajonale Dibër

✓ *Afati i realizimit dhjetor 2017*

- Zyra rajonale e statistikave Dibër të respektojë procedurat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të ndërmarr hapat e nevojshëm në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në INSTAT për caktimin e nëpunësit zbatues të nivelit të dytë dhe kalimin e urdhër shpenzimeve në thesar vetëm me dy firma.

✓ *Afati i realizimit, menjëherë*

- Zyra rajonale e statistikës Dibër të komunikojë me Drejtorinë e financës dhe shërbimeve mbështetëse për të përditësuar dhe marrë udhëzimet e përshtatshme për veprimtarinë e saj në fushën e pagave, sigurimeve shoqërore dhe prokurimit me vlera të vogla si dhe të kryejë procedura të menjëhershme për caktimin e nëpunësit zbatues.

✓ *Afati i realizimit, menjëherë*

Nga sa mësipër rezulton se nga NJAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i financave dhe Udhëzimi nr. 12, datë 05.06. 2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash përgjegjësi i sektorit të auditimit dhe inspektori i auditimit i cili ka qenë në periudhë prove deri në muajin nëntor të 2016.
Si konkluzion fakti që nga NJAB janë lënë (34) dhe nuk janë realizuar vetëm (5) prej tyre duhet që INSTAT të marrë masat e duhura që këto rekomandime të realizohen me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në INSTAT.
Raportimi me Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm (DHAB) në Ministrinë e Financave
- Është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm "Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm të INSTAT, periudha 2017 – 2019" me shkresën nr. 1001/1, datë 17.10.2016 i ndryshuar.
- Nga INSTAT është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm "Raportimi vjetor i veprimtarisë së sektorit të auditimit të INSTAT" me shkrese nr. 193, datë 02.02.2017 "Për raportimin e veprimtarisë audituese për vitin 2016 dhe evidencat përkatëse" në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 14 gërma ç.

Raportimet janë dërguar brenda afateve kërkuara dhe janë sipas kërkesave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.
Me miratimin e ligjit 114/2015 të "Auditimit të Brendshëm për Sektorin Publik", sektori i auditimit ka hartuar kartën e auditimit. Karta e auditimit është miratuar me Urdhrit nr. 19, datë 11.01.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm dhe një kopje i është dërguar gjithashtu edhe Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm .
<u>Për vitin 2017</u>, janë planifikuar 7 auditime. Aktualisht sektori i auditimit të brendshëm është duke kryer auditimi për zyrën rajonale Elbasan.
Raportimi me Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm (DHAB) në Ministrinë e Financave
Gjatë auditimit u konstatua se sektori i auditimit ka hartuar Kartën e auditimit që janë miratuar me Urdhër ne. 566 prot, datë 11.04.2017 nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT. Një kopje e kësaj karte është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm më konkretisht.
Nga auditimi u evidentua se sektori i auditimit të brendshëm në strukturën e fundit e miratuar me Urdhër të Kryeministrit me nr. 28, datë 08.03.2017, ka patur ndryshime në pagë, ku inspektori i auditimit deri në 2016 ka patur pagën III-b. Ndërsa me strukturën e re që është miratuar në vitin 2017 ky pozicion është ndryshuar në specialist dhe me pagë IV-a.

IV. V. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", **neni 9** "*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues*", pika 4, germa "b" i cili citon se "*Nënpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit ka përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë*". Nëpunës i autorizuar për institucionin është **znj.** [redacted] aktualisht Drejtoreshë e Përgjithshme e INSTAT, definuar ky fakt

me shkresën nr. 1362/4 datë 24.11.2016 në vijim të shkresës nr. 1362/3, datë 11.11.2016 të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të INSTAT.
INSTAT ka dy plane strategjike gjatë periudhës objekt auditimi. Konkretisht këto të fundit janë të pasqyruara dhe në fletoren zyrtare me vendimin **nr. 3/2013** dhe vendimin **nr. 10/2017**. Në këtë pikë vlen të theksohet se lidhur me objektivat e **planit 2012-2016** ka munguar miratimi i një **plani vjetor veprimi** (deklarata vjetore 2015 nr. 1349/1 prot, dt. 18.02.2016). Në këtë rast përgjegjësinë e mban nëpunësi autorizues, ***znj.*** [redacted] *ish- drejtoreshë e përgjithshme e INSTAT*, në bazë të shkresës nr. 1334/9 datë 17.12.2015.

INSTAT ka funksionuar me ***rregulloren*** e tij me nr. 462 prot, datë 18.04.2013. Aktualisht për vitin **2017**, INSTAT funksionon me rregulloren nr. 39 prot. datë 10.01.2017 miratuar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT. Rregullorja e re është formatuar dhe konsoliduar duke bërë një mbulim më të plotë të organizimit dhe funksionimit të INSTAT.

INSTAT, përgjatë periudhës 2015-2016 nuk ka miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut dhe Gjurmën e Auditimit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 16 **"***Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit*", të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe konrollin*" i ndryshuar ku citohet: *"2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit."***.** Kjo situatë ka vazhduar edhe në **2016**. Gjatë periudhës **2015-2016** institucioni ka operuar në bazë të rregullores së brendshme (nr. 462 prot. datë 18.04.2013) dhe përshkrimit të detyrave të detajuara sipas kësaj të fundit.

Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Riskut, monitorimin e kontrolleve të riskut, që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve **10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21**, të ligjit nr.10296 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar. INSTAT, *nuk ka hartuar një regjistër identifikimi dhe kontrolli të riskut dhe adresimin tek personat përgjegjës për çdo risk,* i cili duhet të plotësohet, përditësohet të paktën një herë në vit nga NA me synimin e minimizimit të riskut. Dokumentimi i proçesit të menaxhimit të riskut sipas regjistrit përcaktohet edhe në Kapitullin V, Anekse (aneksi nr. 5) të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (2016). Për periudhën **2015-2016**, INSTAT nuk ka disponuar regjistër risku, por sipas deklaratave të cilësisë së kontrollit të brendshëm ka qënë në proçes hartimi. Aktualisht në përputhje edhe me **strategjinë e menaxhimit të riskut 2017-2020,** INSTAT *ka përfunduar regjistrin e riskut.*

Grupi i Menaxhimit Stategjik (GMS), sipas nenit 27 të ligjit nr. 10296 date 07.08.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut II pika 2.2.6 të manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i miratuar me Urdhërin nr. 108 datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave, citohet se "*Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. Grupi për Menaxhimin Strategjik është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike".* GMS ofron

mbështetje dhe këshilla për Titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. INSTAT, për **vitin 2015** ***nuk ka nxjerrë asnjë urdhër*** për ngritjen e GMS dhe për rrjedhojë nuk është realizuar asnjë mbledhje. Për vitin **2016**, INSTAT ka nxjerrë urdhër të brendshëm për ngritjen e GMS me nr. 1567 prot. datë 28.12.2016. Gjatë **2016** është realizuar një mbledhje e GMS protokolluar me shkresën nr. 1567/4 datë 30.12.2016. **Sekretar i GMS** është nëpunësi zbatues. Në këtë pikë u konstatua se me shkresën nr. 6413/2 prot. datë 2.06.2016 është konfirmuar përkohësisht Nëpunësi Zbatues i INSTAT, znj. [redacted] përgjegjëse e sektorit të financës. Ajo do jetë Nëpunëse Zbatuese deri në plotësimin e vendit vakant të *drejtorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse*. Mospërputhja qëndron në faktin që **sekretar i GMS** gjatë mbledhjes ka qënë drejtori i autorizuar i financës Z. [redacted], bazë autorizimit nr. 610 prot. datë 16.05.2016, i cili është shfuqizuar me shkresën nr. 93 prot. datë 18.01.2017, ku detyrat e drejtorit të Drejtorisë së Financave përkohësisht autorizohet ti realizojë znj. [redacted]. Aktualisht me **rregulloren dhe organikën** e re z. [redacted] kryen funksionin e **Koordinatorit të Sistemit Statistikor Kombëtar**. Për **vitin 2017**, është parashikuar që grupi të mblidhet **4 herë** dhe të përgatiten raporte **3-mujore** nga secila drejtori që do të jenë dhe objekt diskutimi në mbledhjet vijuese të GMS.

Mbështetur në pyetësorin e vetëvlersimit, deklaratën e cilësisë dhe raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitet **2015 dhe 2016**, referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga INSTAT, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë **komponentët** në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. <u>Mjedisi i kontrollit</u>.

Mjedisi i kontrollit ka një ndikim të gjithanshëm në vendimet dhe aktivitetet e një njësie dhe hedh themelet e të gjithë sistemit të kontrollit të brendshëm. Më poshtë do përshkruhen në detaje aspektet më të rëndësishme të mjedisit të kontrollit.

a.*Integriteti dhe Vlerat Etike*. Nëpunësit e këtij institucioni respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Për respektimin e rregullave të etikës INSTAT ka miratuar rregulloren e brendshme të institucionit, e cila është miratuar në vitin **2013**. Nisur nga ky fakt, etika personale dhe profesionale për periudhën **2015-2016**, normohet sipas rregullores së lartpërmendur, konkretisht në kapitullin II, pika II.I " **Personeli i INSTAT-it** ". Për periudhën në fjalë, INSTAT në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", **neni 20** "Mjedisi i kontrollit", **pika 2**, gërma **a** dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap III, pika 3.1. "Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm, paragrafi "***Integriteti dhe vlerat etike***", ***nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje.*** Për vitin **2017,** me shkresën nr. 390 prot. datë 13.03.2017 INSTAT ka miratuar **Kodin Etik**, ku ngarkohet konkretisht Drejtoria e Financës dhe shërbimeve mbështetëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. INSTAT me shkresën nr. 7 prot. datë 05.01.2017 ka miratuar edhe *Rregulloren për sigurinë dhe shëndetin në punë.*

b.*Struktura organizative.* **INSTAT** funksionon në bazë të strukturës së miratuar me Urdhërin nr.126 datë 10.09.2015 të Kryeministrit ″Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Institutit të Statistikave" dhe Rregullores së Brendshme e miratuar me shkresën nr.462 datë 18.04.2013,

ndryshuar me rregulloren e re, nr. 39 datë 10.01.2017. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të INSTAT **për 2015-2016**, janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit (2013). Për të njëjtën periudhë, vlen të përmendet se për rritjen e standarteve të statistikave të prodhuara, INSTAT ka nevojë gjithnjë për burime shtesë dhe krahas kësaj struktura ekzistuese nuk është plotësuar. Numri i punonjësve të Institutit të Statistikave, në kuadër të urdhrit nr. 126, datë 10.09.2015 për "Miratimin e Strukturës dhe Organikës së INSTAT" duhet të jetë **216 veta**. Bazuar në këtë urdhër dhe pas përfundimit të proceseve të sistemimit të nëpunësve civilë ekzistues sipas pozicioneve të reja, duke respektuar dhe kuadrin ligjor në fuqi për nëpunësin civil, janë evidentuar në institucion **31** pozicione vakante. Lidhur me këtë fakt INSTAT me shkresën nr. 543 prot. datë 05.05.2016 i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (DAP), për plotësimin e këtyre vendeve vakante. Korrespondenca që ky institucion ka mbajtur me DAP-in, për këtë fakt ka qënë e vazhdueshme përgjatë gjithë 2016. Ky problem vijon edhe në **2017**, pasi INSTAT me shkresën nr. 1555 prot, datë 23.12.2016 drejtuar DAP-it "***Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil***", përcjell planifikimin për rekrutim, konkretisht për **40** vende vakante. INSTAT për periudhën 2015-2016, lidhur me përshkrimet e punës është bazuar në formularët e përshkrimeve të punës sipas standarteve dhe udhëzimeve të DAP-it. Konkretisht me shkresën nr. 1593 datë 30.12.2016 INSTAT ka miratuar dhe Manualin për Proceset e Prodhimit Statistikor. Në funksion të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, **neni 12**, nëpunësi zbatues (NZ), duhet të jetë i nivelit menaxherial në vartësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm. Në bazë të kërkesave të këtij neni "*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*", cilësohet se *"Nëpunësi zbatues i njësisë publike është* ***punonjës i nivelit të lartë*** *të menaxhimit të njësisë publike, me diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike ose juridike, me përvojë menaxheriale dhe i specializuar në fushën e menaxhimit financiar ose të financave publike".* Grupi i auditimit konstatoi se **sekretar i GMS** gjatë mbledhjes është drejtori i autorizuar i financës **Z.** [redacted], bazë autorizimit nr. 610 prot. datë 16.05.2016, i cili është shfuqizuar me shkresën nr. 93 prot. datë 18.01.2017, ku detyrat e drejtorit të Drejtorisë së Financave përkohësisht autorizohet ti realizojë znj. [redacted]. Kjo bie në kundërshtim me **nenin 12/2a**, i cili përcakton qartë se sekretar i GMS së njësisë publike duhet të jetë nëpunësi zbatues.

c.*Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit* (<u>Profesionalizmi i stafit dhe delegimi i detyrave)</u>nëpunësi zbatues realizon përgjegjësitë mënxheriale të tij dhe është njëkohësisht edhe sekretar i GMS. Punonjësit e INSTAT i rregullojnë marrëdhëniet e punës në linjë hierarkike bazuar në Rregulloren e Brendshme të INSTAT dhe Manualin e Përshkrimeve të Punës, për periudhën 2015-2016. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Aktualisht për vitin **2017**, INSTAT funksionon me rregulloren nr. 39 prot. datë 10.01.2017**, e cila** bën një trajtim specifik lidhur me dokumentimin dhe trajnimet (pasqyrë trajnimesh), mirëmbajtjen e godinës dhe pajisjeve (parkimi, administrim parkimi, siguria), administrimin e aktiveve, mirëmbajtjen dhe administrimin e rrjetit elektronik***, delegimin* e detyrave**, rregullat mbi realizimin e anketave dhe anekset respektive lidhur me shkresat zyrtare brenda institucionit.

d. *Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore*.

Në rregulloren e brendshme të institucionit (**2013**), janë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet

ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, orari dhe koha e punës. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimit, INSTAT ka organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve tek ASPA, ka realizuar Ëorkshope me përfaqësues të huaj dhe trajnime jashtë vendit. Konkretisht me fillimin e **projektit Sida**, përmirësimi i kapaciteteve profesionale do të shkojë një shkallë më lart. Ky institucion nuk *ka program specifik për trajnimin e punonjësve* të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, pika 3.1. "Mjedisi i kontrollit të brendshëm" paragrafët "***Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njërezore***" dhe "***Profesionalizmi i stafit***".

2. Menaxhimi i riskut.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Ky institucion **ka përcaktuar konform** nenit **10** të ligjit nr. 10296**, koordinatorin e riskut (drejtoresha e përgjithshme).** Situata duket se ka nisur të përmirësohet ndjeshëm për vitin 2017, krahasuar me vitet 2015-2016. INSTAT me shkresën nr. 659 prot. datë 26.04.2017 ka nxjerrë urdhër për miratimin e regjistrit të riskut të njësisë publike, dhe ka vendosur miratimin e **Regjistrit të Riskut të INSTAT për vitin 2017**.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave dhe nxitjen e vendimeve të drejtuesve. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Aktualisht institucioni operon me rregullore dhe organikë të re miratuar **rishtazi në 2017**. INSTAT, përgjatë periudhës **2015-2016** *nuk ka miratuar* ***Strategjinë e Menaxhimit të Riskut dhe Gjurmën e Auditimit.*** Për të plotësuar nevojën për informacion, njësia ka instaluar sistemin e IT-së, ku kompjuterët janë të lidhur me serverin në brendësi të tij. INSTAT me shkresën nr. 300 prot. datë 24.02.2017 ka miratuar politikën e Sigurisë së Informacionit, ku për ndjekjen e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit. Në këtë linjë, INSTAT ka miratuar Rregulloren për administrimin e databazës statistikore (nr.35 prot. dt. 10.01.2017) dhe atë të Politikës e aksesit në dhomën e serverave (nr. 234 prot. dt. 09.02.2017) .

4. Informimi dhe komunikimi.

Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. (sistemet e menaxhimit, komuniki i brendshem dhe i jashtëm). Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive. Titullari informohet nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, por nuk ka relacione dhe raporte rreth këtyre mbledhjeve. Sektori i Financës (NZ), raporton tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, dhe realizon gjithashtu raporte monitorimi mujore, apo tremujore. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtëpërdrejtë, sigurohet dhe

komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia **nuk ka hartuar një procedurë** për mbledhjen dhe dokumetimin e gabimeve dhe analizën e tyre. INSTAT ka faqen zyrtare dhe nëpërmjet këtij WEBSITI të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të këtij institucioni.

5. Monitorimi dhe raportimi.

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme, se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet:

- Monitorimit të vazhdueshëm;
- Vetëvlerësimit;
- Auditimit të brendshëm.

Në këtë institucion, Titullari informohet vazhdimisht nga drejtuesit e mesëm dhe të ulët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve apo informacioneve. Pavarsisht takimeve të shpeshta, **zbardhja dhe mbajtja** e minutave të tyre është e rrallë. Kjo vlen për vitin 2015, pasi në 2016 e në vazhdim përmirësimi i këtij fakti ka qënë i dukshëm. Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, duke mos pasur njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe duke moskryer **trajnime** për kuptimin dhe zbatimin e ligjit, nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, megjithëse në Rregulloren e INSTAT janë përcaktuar edhe rregullat dhe përgjegjësitë për strukturat e ndryshme. Raportimi periodik shërben për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit për çdo proces e pozicion pune. Nga auditimi i të gjitha fushave të veprimtarisë së këtij institucioni rezultoi se janë **hartuar raportet e monitorimit të buxhetit** në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Lidhur me aktivitetin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe faktin se sa i përmbush ajo pritshmëritë e drejtuesve të njësisë publike, vlen fakti që në **vitin 2015** njësia e auditit të brendshëm ka qënë jo e plotë në organikë, gjë që ka afektuar intensivitetin e veprimtarisë audituese. Pavarsisht progreseve të dukshme të njësisë së auditit të brendshëm, progres i cili ka përmirësuar dukshëm punën dhe performancën e këtij institucioni, sërisht problematika e vendeve vakante ka vijuar edhe përgjatë vitit 2016 dhe në vijim të 2017. Lidhur me progresin drejt arritjes së objektivave dhe monitorimit të tyre, INSTAT për vitin **2015** ka ndjekur rrugën e mbledhjeve me strukturat drejtuese për të diskutuar mbarëvajtjen e veprimtarisë statistikore. Drejtori i Përgjithshëm ([redacted]) ka operuar duke paraqitur pranë Këshillit të Statistikave raporte **4-mujorte** për zbatimin e aktiviteteve. Përgjatë **2016** një praktikë e tillë është dobësuar. **Së fundmi**, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", **neni 18 "***Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm",* INSTAT ka përpiluar **pyetësorin e vetëvlerësimit** për sistemet e MFK-së, deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të INSTAT dhe Raportin për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm, për vitet 2015-2016, kjo protokolluar me **shkresën nr. 1349/1** prot. datë 18.02.2016 (2015) dhe **shkresën nr. 53 prot**. datë 12.01.2017 (2016).

Në miratimin e rregullave specifike mbi procedurat për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, u konstatua se, me shkresen nr.799 date 20.06.2016, sipas pikës **81** të Udhëzimit **nr.30**, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e*

sektorit publik" është ngritur komisioni për kryerjen e inventarizimit të mjeteve kryesore dhe pasurive të tjera, të luajtshme ose të paluajtshme për aparatin qendror, INSTAT dhe Zyrat rajonale. Sipas komisionit të inventarizimit për Aparati Qendror, INSTAT ka propozuar të dalin nga perdorimi 80 artikuj me vlerë 10,832,371 lekë dhe për Zyrat rajonale 39 artikuj me vlerë 3,651,460 leke. Pra totali 119 artikuj me vlerë 14,483,831 lekë.
Me Urdhër të Drejtoreshës Përgjithshme **nr. 799/1 datë 17.10.2016**, sipas pikës **103** të Udhëzimit **nr.30**, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve që do të dalin nga përdorimi. Komisioni i vlerësimit ka propozuar të dalin nga përdorimi 77 artikuj për Aparatin Qëndror INSTAT me vlerë 8,226,364 leke nga të cilat 51 artikuj aktive qëndrore të trupëzuara (AQT) me vlerë 8,058,520 leke dhe 26 artikuj aktive qarkulluese me vlerë 167,843 lekë . Për Zyrat rajonale komisioni i vleresimit ka propozuar te dalin nga perdorimi 36 artikuj me vlere 3,557,704 leke nga te cilat 27 artikuj AQT me vlere 3,491,993 leke dhe 9 artikuj me vlere 65,771 leke .
Së fundmi, me Urdhër të Drejtoreshës Përgjithshme **nr.799/2 date 24.10.2016**, sipas pikës **109** të Udhëzimit **nr.30**, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", është ngritur komisioni i asgjesimit te paisjeve dhe materialeve qe do te dalin nga perdorimi. Me shkresën **nr. 799/4 date 31.10.2016** është urdhëruar shkarkimi nga kontabiliteti i shumave përkatëse për Aparatin qëndror INSTAT me vlerë 8,226,364 lekë dhe Zyrat rajonale me vlerë 3,557,704 leke, në total 11,784,068 lekë.
Për vitin 2017:
Sipas pikës **95** të Udhëzimit, me shkresën nr. 255 Prot, datë 14.02.2017 me urdhër të brendshëm është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e automjeteve, nga ku rezulton se 7 (shtatë) automjete janë në total nga të cilët 4 (katër) janë nxjerrë jashtë përdorimit. Kjo realizuar me shkresën nr. 255/1, bazë urdhërit për daljen nga përdorimi të automjeteve të INSTAT. Nisur nga ky fakt është shkatkuar nga kontabiliteti shuma prej **12.217.027** lekë.

VI. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

"Mbi auditimin mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, organizimit e funksionimitn e Këshillit të Statistikave, për vitet kalendarike 2015, 2016 dhe tremujorin e parë (I) të vitit 2017".

1.*Organizimi dhe funksionimi i Këshilli të Statistikave (KS)*
Këshilli i Statistikave, është organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar me ligjin nr. 21/2012 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9180, datë 05.04.2004 "Për statistikat" si dhe ligjin nr. 7/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare". Këshilli i Statistikave, e ushtron veprimtarinë sipas nenit 10, 11 të ligjit të sipërcituar, të VKM nr. 62, datë 12.02.2014 "*Për emërimin e anëtarëve të këshillit të statistikave",* si dhe të Rregullores së Brendshme të INSTAT.
Këshilli i Statistikave përbëhet nga 7 anëtarë e përkatësisht nga përfaqësuesi i Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, 2 anëtarë nga përdoruesit kryesorë të statistikave zyrtare, nga bota akademike, nga shoqëria civile si dhe nga Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë,

me mandat pesë vjeçar, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë në vit. Nga auditimi konstatohet se Kryetar i KS është zgjedhur z. [redacted], përfaqësuesi i botës akademike.
Nga auditimi mbi përputhshmërinë e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Statistikave, për vitet kalendarike 2015, 2016 dhe 3 mujori (I) i vitit 2017, ka rezultuar se, znj. [redacted] është emëruar në bazë të VKM nr.62 datë 12.02.2014, si përfaqësuese e shoqërisë civile, të cilën e ka mbajtur deri në momentin, kur me Urdhër të Kryeministrit nr.157 datë 02.12.2015, është autorizuar të ushtroj kompetencat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave. Kështu nisur nga ky urdhër, për të shmangur çdo konflikt interesi për ushtrimin e detyrës së saj, nuk ka marrë pjesë në votim dhe as ka përfituar pagesë, si anëtare e KS.
Znj. [redacted] është riaktivizuar nga muaji nëntor 2016 e në vazhdim, si anëtare e KS, me marrjen dhe emerimin e drejtimit të INSTAT nga znj. [redacted]. Gjithashtu, nga auditimi znj. [redacted], është emëruar në një detyrë tjetër pranë administratës së lartë shtetërore, duke e humbur përfaqësimin e saj nga shoqëria civile. Gjithashtu i njëjti arsyetim vlen dhe për znj. [redacted], e cila ka ndryshuar institucionin.
Nisur për sa më sipër, nga drejtuesit e KS dhe INSTAT, duhej të negocionin me Këshillin e Ministrave, për shkak se disa prej anëtarëve të KS, nuk e kanë më atë status të përfaqësimit, e për rrjedhojë çdo vendim marrje e Këshillit të Statistikave nuk është në përputhje mbi bazën ligjore mbi të cilën është krijuar dhe funksion.

2. Veprimtaria e Këshillit të Statistikave dhe analiza e mbledhjeve të Këshillit të Statistikave për vitin 2015

Nga auditimi i ushtruar mbi veprimtarinë dhe rolin e KS për vitin 2015, konstatohet se, ky Këshilli i Statistikave, nuk ka përmbushur rolin dhe detyrat në përputhje me përcaktimet në nenin 11, të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar. Konkretisht:
- Nuk është dokumentuar shkresërisht se Këshilli i Statistikave ka mbikëqyrur dhe mbështetur INSTAT në rolin e tij për të siguruar se programi është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare.
- Nuk ka dokumentacion shkresor mbi miratimin e projekt programit, ndryshimet e tij, miratimin e planit strategjik pesëvjeçar të INSTAT-it, masat për realizimin e këtij programi, miratimin e plan veprimit një vjeçar, mbi raportimet e shkurtuara katër/mujore të ecurisë në zbatimin e programit të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Veprimtaria për vitin 2015 është pasqyruar duke organizuar dy mbledhje, në kundërshtim me ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, neni 10/1 "Mbledhja e Këshillit të Statistikave", pika 1 në të cilën citohet: ***këshilli i Statistikave mblidhet, të paktën tri herë në një vit kalendarik.***

KS ka zhvilluar vetëm dy mbledhje më datë 30.06.2015 dhe 24.12.2015.
Në mbledhje kanë marrë pjesë z. [redacted], kryetar i KS, znj. [redacted], znj. [redacted], znj. [redacted], znj. [redacted], znj[redacted].
Në mbledhjen e datës 30.06.2015, sipas rendit të ditës, të përcaktuar në njoftimet që u janë dërguar çdo anëtari është shqyrtuar:

1. Projekt–Struktura për miratim;
2. Analiza Vjetore viti 2014, për miratim;

3. Raporti 4 mujor i ecurisë së programit të Statistikave Zyrtare;
4. Prezantimi i përgjithshëm i risive kryesore si dhe aksesit nga përdoruesit në informacionin statistikor.

Në mbledhje janë shqyrtuar çështjet e përcaktuara sipas rendit të ditës si dhe është mbajtur procesverbali përkatës nga sekretari i KS. Konstatohet se ***procesverbali, nuk është nënshkruar nga pjesëmarrësit në mbledhje***. KS në mbledhje sipas rendit të ditës i janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo çështje në diskutim ***por që nuk janë nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm*** si dhe të ***pa shoqëruara me projekt vendimet përkatëse***. KS për vitin 2015, ka nxjerrë gjithsej një vendim, me nr. 2, datë 30.06.2015, protokolluar me nr. 839/2. Nga analiza e problematikave të shqyrtuar, vendimmarrja e KS është adresuar në, miratimin e Projekt-Strukturës Organizative të Institutit të Statistikave, që është dërguar për miratim Këshillit të Ministrave.
Nga auditimi konstatohet formalitet në veprimtarinë e KS futja në rendin e ditës të mbledhjes së datës 30.06.2015 të Analizës vjetore të vitit 2014 (gjashtë muaj pas përfundimit të vitit kalendarik) si dhe raportimi 4-mujor i ecurisë së programit të statistikave zyrtare, (dy muaj pas përfundimit të veprimtarisë katër/mujore).
Dosja me materialet përkatëse për mbledhjen e KS, zhvilluar më datë 30.06.2015, nuk është inventarizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat". Nga ana e Sekretarisë së Këshillit të Statistikave, nuk është administruar dosja me indeks të veçantë sipas kërkesave të Kapitullit V, Formati Standard i arkivimit. Mungon inventari përmbledhës i dosjes, në të cilin të evidentohen shkresat dhe fashikujt e veçantë. Nuk ka gjurmë nga ana e punonjësit arkivues që dosja është marrë në administrim nga arkivi.

Në mbledhjen e datës 24.12.2015, sipas rendit të ditës, të përcaktuar në njoftimet që u janë dërguar çdo anëtari është shqyrtuar:
1. Prezantimi i Raportit Vjetor të INSTAT për vitin 2014;
2. Informacion mbi Projekt-Buxhetin e vitit 2016;
3. Informacion mbi rinovimin e shportës së produkteve;
4. Informacion në lidhje me projektet si dhe marrëveshjet e nënshkruara gjatë vitit 2015.

Në mbledhje janë shqyrtuar çështjet e përcaktuara sipas rendit të ditës si dhe është mbajtur procesverbali përkatës nga sekretari i KS. Konstatohet se ***procesverbali, nuk është nënshkruar nga pjesëmarrësit në mbledhje si dhe nga sekretaria e KS***. Sipas rendit të ditës KS i janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo çështje që do të diskutohet ***por që nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të Statistikave.***
Në dosje nuk ka dokumentacion shkresor që të ***vërtetojë pjesëmarrjen e anëtarëve të KS në këtë mbledhje,*** për pasojë Urdhri me nr. 1398 prot., datë 29.12.2015 "Për pagesën e anëtarëve të Këshillin të Statistikave", i Drejtorit të Përgjithshëm të Autorizuar znj. [redacted], për pagesën e katër anëtarët të KS me vlerë totale prej 56,000 lekë, si pjesëmarrës në mbledhje konsiderohet fiktiv, ([redacted] 20,000 lekë, [redacted] 12,000 lekë, [redacted] 12,000 lekë, [redacted] 12,000 lekë – 15% tatim), kështu vlera totale prej 47,600 lekë është paguar, në kundërshtim me, ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar nenin 10 pika 2, dhe me VKM-në nr.999 datë 25.10.2013 "Për kriteret dhe proçedurat e përfaqësimit, të përzgjedhjes, të emërimit e të

shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave", pika 20, pasi vendimi nuk është i vlefshëm, është miratuar vetëm nga 4 persona.
Gjithashtu, nga auditimi i dosjes me materialet përkatëse për mbledhjen e KS, zhvilluar më datë 24.12.2015, nuk është inventarizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat". Nga ana e Sekretarisë së Këshillit të Statistikave, i cili është ngritur në mbështetje të ligjit nr.9180 datë 05.02.2004 i ndryshuar, neni 8 (Detyrat e INSTAT), nënpika 1/k(II) dhe neni 10/1 pika3, nuk është administruar dosja me indeks të veçantë sipas kërkesave të ligjit dhe formatit standard të arkivimit. Mungon inventari përmbledhës i dosjes, në të cilin të evidentohen shkresat dhe fashikujt e veçantë si dhe numri kronologjik i fletëve sipas fashikujve përbërës të dosjes. Nuk ka gjurmë nga ana e punonjësit arkivues që dosja është marrë në administrim nga arkivi.

3. Veprimtaria e Këshillit të Statistikave dhe analiza e mbledhjeve të Këshillit të Statistikave për vitin 2016

Nga auditimi, rezultoi se, Këshilli i Statistikave për vitin 2016, është mbledhur dy herë brenda këtij viti kalendarik, respektivisht në datën 16.06.2016 dhe në datën 21.11.2016, duke mos plotësuar numrin minimal të mbledhjeve, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, neni 10/1 "Mbledhja e Këshillit të Statistikave", pika 1 dhe me VKM-në nr.999 datë 25.10.2013 "Për kriteret dhe proçedurat e përfaqësimit, të përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave" pika 16, ku thuhet se "*Këshilli i Statistikave mblidhet, të paktën tri herë në një vit kalendarik".*
Nga ana e INSTAT-it, grupit të auditimit, janë vënë në dispozicion praktika shkresore për mbledhjen e datës 16.06.2016, dhe Urdhër nr. 856 prot. datë 17.07.2016 "Për pagesën e anëtarëve të Këshillit të Statistikave" e miratuar nga ish- Drejtori i Përgjithshëm i Autorizuar ([redacted]), duke rezultuar me 4(katër) anëtarë të KS. Nga auditimi, është rezulton se, në bazë të Deklaratës personale të zj. [redacted], me shkresë, me nr.904prot datë 09.07.2015, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Statistikave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, ka deklaruar, se në bazë të VKM nr.418 datë 27.06.2012 i ndryshuar "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qëndrore" pika 4, shkronja "a", heqjen dorë nga pagesa që përfiton si anëtare e KS. Vlen të theksohet se zj.[redacted] a është pjesëmarrëse në 4 (katër) borde/këshilla, si përfaqësese nga Kryeministria.

Kështu, nga auditimi, i mbledhjes datë 16.06.2016, sipas rendit të ditës, të përcaktuar në njoftimet që u janë dërguar çdo anëtari është shqyrtuar:

1. Prezantimi i Raportit Vjetor të INSTAT për vitin 2015;
2. Prezantim mbi proçesin e hartimit të "Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) 2017-2021;
3. Informacion mbi projektet e miratuara të INSTAT për vitin 2016;
4. Informacion mbi ecurinë e botimit të të dhënave të Censusit të Bujqësisë 2012.

Nga auditimi, është evidentuar se, në bazë të proces-verbalit të datës 16.06.2016, janë shqyrtuar çështjet e përcaktuara më parë, të mbajtura dhe firmosura nga sekretari i KS. Konstatohet se *procesverbali, nuk është nënshkruar nga pjesëmarrësit në mbledhje, por vetëm nga nga*

sekretaria e KS. Sipas rendit të ditës KS, i janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo çështje që janë, diskutuar, *por që nuk janë nënshkruar as nga Kryetari i Këshillit të Statistikave dhe as nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, kjo në kundërshtim me aktet ligjore për funksionimin e KS.*

Nga auditimi, i mbledhjes datë 21.11.2016, sipas rendit të ditës, të përcaktuar në njoftimet që u janë dërguar çdo anëtari është shqyrtuar:

1. Miratimi i Projekt-Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021;

Nga auditimi, është evidentuar se, në bazë të proces-verbalit të datës 21.11.2016, janë shqyrtuar çështjet e përcaktuara më parë, të mbajtura dhe firmosura nga sekretari i KS. Konstatohet se *procesverbali, nuk është nënshkruar nga pjesëmarrësit në mbledhje, por vetëm nga nga sekretaria e KS*. Sipas rendit të ditës KS, i janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo çështje që janë, diskutuar, *por që nuk janë nënshkruar as nga Kryetari i Këshillit të Statistikave dhe as nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, kjo në kundërshtim me aktet ligjore për funksionimin e KS.* Kjo mbledhje është shoqëruar me Vendimin e nr.1476, datë 09.12.2016 "Për miratimin e projekt-programit të statistikave zyrtare 2017-2021".
Duke gërshetuar dhe faktet e mësipërme, në mbledhjet e realizuara nga KS, sipas procesverbaleve, nuk rezulton prania e anëtareve të këshillit, sipas pikës c, të VKM nr.62 datë 12.02.2014, duke mos plotësuar numrin minimal të anëtarëve në marrjen e vendimeve, i cili duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë).
Nisur nga sa më sipër, pagesa e realizuar në bazë të Urdhërit nr.1448 prot., datë 02.12.2016 "Për pagesën e anëtarëve të Këshillit të Statistikave" i Drejtorit të Përgjithshëm të znj. [redacted], për pagesën e tre anëtarëve të KS me vlerë totale prej 44,000 lekë, si pjesëmarrës në mbledhje konsiderohet fiktiv, ([redacted] 20,000 lekë, [redacted] 12,000 lekë, dhe [redacted] 12,000 lekë – 15% tatim), kështu ***vlera totale prej 37,400 lekë,*** është paguar, në kundërshtim me, ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, nenin 10/1, dhe me VKM-në nr.999 datë 25.10.2013 "Për kriteret dhe proçedurat e përfaqësimit, të përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave", pika 20, pasi vendimi nuk është i vlefshëm, është miratuar vetëm nga 3 persona ose nga 4 persona nëse ka marrë pjesë dhe znj. [redacted].

4. Veprimtaria e Këshillit të Statistikave dhe analiza e mbledhjeve të Këshillit të Statistikave për tre mujorin e (I) të vitin 2017

Nga auditimi, rezultoi se, Këshilli i Statistikave, për pjesën e tremujorin të (I) të vitit 2017 është mbledhur 1 (një) herë më datë 06.02.2017, sipas rendit të ditës, të përcaktuar në njoftimet janë si më poshtë:

1. Dërgimi për miratim projekt-struktura Organizative, pranë Këshillit të Ministrave;
2. Analiza Financiare e vitit 2016 dhe buxheti i miratuar për vitin 2017;
3. Monitorimi i aktiviteteve në kuadër të Programit të Statistikave Zyrtare për 2017;
4. Aspekte të tjera të sistemit sipas propozimit të anëtarëve.

Nga auditimi, është evidentuar se, në bazë të proces-verbalit të datës 06.02.2017, janë shqyrtuar çështjet e përcaktuara më parë, të mbajtura dhe firmosura nga sekretari i KS. Konstatohet se *procesverbali, është nënshkruar nga pjesëmarrësit në mbledhje, nga Kryetari i këshillit të Statistikave dhe nga sekretaria e KS*. Kjo mbledhje është shoqëruar me Vendimin e nr.2, datë 06.02.2017 "Për propozim Kryeministrit të Projekt-Strukturës Organizative të INSTAT".

Gjithashtu, nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ligjore, është verejtur se në Relacionin e miratimit të Projekt –Strukturës organizative të INSTAT 2017, nga ana e KS, është kërkuar, si ndryshim kryesor midis të tjerave, shtimin edhe të dy koordinatorëve, duke e çuar në 4 (katër), për të mbuluar funksione të rolit kordinues të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe prodhimi i analizave dhe studimeve kërkimore. Në relacion e KS, nuk është e argumentuar pse është e domosdoshme, pasi nga auditimi rezultojnë që ekzistenca e dy pozicioneve të kordinatorëve,të miratuar në bazë të Urdhër të Kryeministrit nr.126 datë 10.09.2015 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave" ,ku ende një vend është vakand deri në momentin e hartimit të akverifikimit dhe kordinatori tjetër është me kurs të gjatë trajnimi jashtë shteti, duke mos e bërë efikas dhe efiçentë detyrën e kordinatorit, pasi nuk është përftuar ndonjë produkt administrativ, në lidhje me prodhimin e anlizave, studimeve kërkimore, etj.
Nisur sa më sipër, ky fakt bie ndesh deri diku me ligjin 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" neni 3 pika 5, (Parimi i qartësisë), *duke pasur ndërthurje të detyrave funksionale të drejtorive pjesë e strukturës së miratuar*, nga Drejtori i Përgjithshme znj. [redacted], me Vendimin nr.39 prot datë 10.01.2017 "Për miratimin e rregullores së brëndshme", në mbështetje të Urdhër të Kryeministrit nr.126 datë 10.09.2015 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave", duke nxjerrë lehtësisht, që ky hartim dhe miratim duhej të ishin realizuar kohë më parë nga drejtuesit e INSTAT.

Gjithsesi, kërkesa e mësipërme, e paraqitur nga Këshilli i Statistikave, nuk është marrë në konsideratë nga Këshilli i Ministrave, kjo në bazë të Urdhër të Kryeministrit nr.28 datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave", duke mbajtur përsëri vetëm 2 (dy) kordinatorë dhe jo 4 (katër) kordinatorë.

GJETJE DHE REKOMANDIM

1. Gjetje:

Nga auitimi i Planifikimit të Buxhetit Afatmesëm u konstatua se, hartimi i programit buxhetor afatmesëm si për fazën fillestare ashtu edhe për fazën e dytë ka mangësi në trajtim, gjithashtu në kërkesat shtësë ku intitucioni parashikon për investime apo shërbime operative në të cilat mungojnë relacionet shpjeguese në vlera sasiore dhe cilësore dhe disa formatet për argumentimin për kërkesat shtesë të PBA-së ku saktësisht për vitin 2015, formati mbi argumentimin e shtesës së kërkuar për numrin e anketuesve në vlerën 18,710 dhe për vitin 2016 formati mbi argumentimin e shtesës për inevstimin "blerje paisje chiller" në vlerën 6.5 milion lekë.

Rekomandim:

Instituti i Statistikave të marrë masa në hartimin e Planfikimit të Buxhetit Afatmesëm në të dy fazat e saj, duke trajtuar qëllimin e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike produketet e programeve dhe kostot e tyre respektive

si dhe në rastet e kërkesave shtesë të bëjë argumentimin e tyre si dhe plotësimin e formateve standarde të MF.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje:
Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2015, 2016 dhe 4-mujorin e 2017, u konstatua se, në të gjitha kërkesat e INSTAT-it mbi rishpërndarjen e fondeve, mungon analiza specifike e datajimit si dhe arsyes së kërkesave në kundërshtim me pikën 74 të udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Rekomandim:
Institucioni të marrë masa, ku për cdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh të shoqërohet me analizë ku të identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje:
Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit konstatohet se, programimi është prekur nga Aktet Normative si në vitin 2015 dhe në vitin 2016, gjithashtu shikojme se Planifikimi i Buxhetit Afatmesëm nuk i referohet vitit parardhës për të minimizuar ndryshimet e ndjeshme të cilat ndodhin kur perballemi me faktin në fund të vitit duke krijuar kështu mosrealizim të shpenzimeve korrente dhe kapitale.

Rekomandim:
Strukturat drejtuese të INSTAT-it, dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje:
Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit, si dhe raportet periodike që institucioni i ka paraqitur në Ministrinë e Financës, nuk janë plotësuar me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel artikulli, lidhur më ndryshimet e planit të produkteve si në sasi ashtu edhe në vlerë në kundërshtim me pikën 79 të udhëzimin plotësues nr. 1, dt. 15.01.2016 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016*"
-Mungojnë argumentat e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikojnë në të ardhmen për realizimin e tyre.
-Performanca e produketeve duhet të paraqitej e lidhur me relizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e programit si dhe si janë realizuar këto objektiva.

-Raportet e monitorimittë buxhetit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Institutit të Statistikave, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Financës nëpërmjet lidhjes së vendosur në faqet zyrtare të Institucioneve.

Rekomandim:
Institucioni gjatë hartimit të raportit të monitorimit si dhe raporteve periodike, të kryhen me të gjitha argumentimet cilësore dhe sasiore, si dhe të argumentohet mosrealizimi i tyre. INSTAT-i të marrë masa për publikimin e raporteve ato në faqen zyrtare si dhe në faqen e MF.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje:
Nga auditimi i ushtruar mbi veprimtarinë dhe rolin e KS konstatohet se, këshilli nuk ka përmbushur rolin dhe detyrat në përputhje me përcaktimet në nenin 11, të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, konkretisht:
- Nuk është dokumentuar shkresërisht se Këshilli i Statistikave ka mbikëqyrur dhe mbështetur INSTAT në rolin e tij për të siguruar se programi është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare.
- Nuk ka dokumentacion shkresor mbi miratimin e projekt programit, ndryshimet e tij, miratimin e planit strategjik pesëvjeçar të INSTAT-it, masat për realizimin e këtij programi, miratimin e plan veprimit një vjeçar, mbi raportimet e shkurtuara katër/mujore të ecurisë në zbatimin e programit të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Veprimtaria për vitin 2015 është pasqyruar duke organizuar dy mbledhje, në kundërshtim neni 10/1, pika 1 të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, ku citohet: "Këshilli i Statistikave mblidhet, të paktën tri herë në një vit kalendarik".

Nga auditimi konstatohet formalitet në veprimtarinë e KS futja në rendin e ditës të mbledhjes së datës 30.06.2015 të Analizës vjetore të vitit 2014 (gjashtë muaj pas përfundimit të vitit kalendarik) si dhe raportimi 4-mujor i ecurisë së programit të statistikave zyrtare, (dy muaj pas përfundimit të veprimtarisë katër/mujore).

Rekomandim:
Këshilli i Statistikave, në veprimtarinë e tij të marrë masa të menjëhershme, për të përmbushur rolin dhe detyrat në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, që të realizohet në mënyrë sa më të plotë misioni, vizioni dhe objektivat e INSTAT në lidhje me prodhimin e statistikave asnjanëse, transparente dhe të përditësuara, që të ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit të fushave ekonomiko-sociale brenda vendit. KS të mbikëqyri dhe mbështesë INSTAT në vazhdimësi për të përmirësuar cilësinë e statistikave zyrtare, duke respektuar parimet e cilësisë statistikore të parashikuara në ligjin shqiptar dhe standardet e Kombeve të Bashkuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje:
Gjatë analizës mbi zhvillimin e mbledhjeve të KS konstatohet se, ***procesverbalet nuk janë nënshkruar nga pjesëmarrësit në mbledhje***. KS i janë vënë në dispozicion relacionet përkatëse për çdo çështje në diskutim ***por që nuk janë nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm*** si dhe ***të pa shoqëruara me projekt vendimet përkatëse***.

Rekomandim:
Sekretaria e Këshillit të Statistikave, të marrë masa që materialet që do të shqyrtohen në mbledhjet e radhës të KS, të jenë të nënshkruara nga nëpunësit përgjegjës për hartimin e tyre. Relacionet për të cilat KS do të shprehet me vendim, të jenë të shoqëruara me projekt vendimin përkatës. Procesverbali përfundimtar i mbledhjes të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KS, pjesëmarrës në mbledhje.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje:
Në mbledhjen zhvilluar më datë 24.12.2015, në dosje mungon dokumentacioni shkresor që ***vërteton pjesëmarrjen e anëtarëve të KS në këtë mbledhje,*** për pasojë Urdhri me nr. 1398 prot., datë 29.12.2015, i Drejtorit të Përgjithshëm të Autorizuar, për pagesën e katër anëtarët të KS, si pjesëmarrës në mbledhje konsiderohet fiktiv.
Mbështetur në urdhrin nr. 1398 prot., datë 29.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm, për pagesën e anëtarëve të KS, pjesëmarrës në mbledhjen e datës 24.12.2015, konstatohet se ***mbledhja është zhvilluar pa kuorumin e nevojshëm,*** në kundërshtim me nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, në të cilin citohet: "Kuorumi përbëhet nga të paktën pesë anëtarë të këshillit".

Rekomandim:
Këshilli i Statitikave, të marrë masa që mbledhjet të zhvillohen sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004 "*Për statistikat zyrtare",* i ndryshuar, duke plotësuar kuourumin e nevojshëm me 5 anëtarë. Prezenca e anëtarëve në mbledhjet e KS të evidentohet shkresërisht nëpërmjet nënshkrimit të çdo anëtari.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje:
Nga auditimi i dosjes me materialet përkatëse për mbledhjen e KS, zhvilluar më datë 24.12.2015, nuk është inventarizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat". Nga ana e Sekretarisë së Këshillit të Statistikave, i cili është ngritur në mbështetje të ligjit nr.9180 datë 05.02.2004 i ndryshuar, neni 8 (Detyrat e INSTAT), nënpika 1/k(II) dhe neni 10/1 pika 3, nuk është administruar dosja me indeks të veçantë sipas kërkesave të ligjit dhe formatit standard të arkivimit. Mungon inventari përmbledhës i dosjes, në të cilin të evidentohen shkresat dhe fashikujt e veçantë si dhe numri kronologjik i fletëve sipas fashikujve përbërës të dosjes. Nuk ka gjurmë nga ana e punonjësit arkivues që dosja është marrë në administrim nga arkivi.

Rekomandim:
Sekretaria e Këshillit të Statistikave, të marrë masa të menjëhershme për inventarizimin e dosjeve me materialet e mbledhjeve të Këshillit të Statistikave për vitin 2015, 2016 dhe tremujorin e parë të vitit 2017, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"* dhe formatit standard të arkivimit,

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje:

Nga auditimi mbi zbatimin e ligjit nr. 152/2013, datë 01.10.2013 "Për statusin e nëpunësit civil" në lidhje me respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin, procedurat e ndjekura në rekrutimet për vende të lira pune, ngritjen në detyrë, lëvizjet paralele dhe administrimin e dosjeve të personelit rezultoi se:
- Instituti i Statistikave, për periudhën objekt auditimi në strukturën organike, pavarësisht lëvizjeve paralele apo ngritjeve në detyrë, nuk ka plotësuar dhe as ka tejkaluar numrin e planifikuar të punonjësve, miratuar me urdhrin 147, datë 24.12.2012, nr. 126, datë 10.09.2015, nr. 28, datë 08.03.2017 *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave "* të Kryeministrit.

Rekomandim:
Sektori i Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës së Lartë Publike të marrë masa për plotësimin e vendeve vakantë në strukturë si dhe të rivlerësojë për plotësim me dokumentacionin e nevojshëm dosjet personale për nëpunsit e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues.

Menjëherë

10. Gjetje:
INSTAT ka ekzekutuar 5 vendime gjyqësore **me vlerë 2,873,323 lekë** për ish punonjësit, që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna, Nga vendimet e ekzekutuara 2 i përkasin vitit 2015 si dhe 3 vendime vitit 2016, nga këto një vendim është për rikthim në vendin e punës. Në tremujorit të parë të vitit 2017 nuk ka vendime të reja të dala nga proceset gjyqësore të formës së prerë për likuidim.
Për vitin 2015 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore 960,585 lekë, vlerë e cila është paguar nga fondi i akorduar nga INSTAT.
Për vitin 2016 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore është 1,397,373 lekë, vlerë e cila është paguar nga fondi i akorduar nga INSTAT.
Për tremujorin e parë të vitit 2017 vlera në total e mbetur për likuidim nga viti 2016 është 515,365 lekë.
Për periudhën objekt auditimi INSTAT ka likuiduar një person, punonjës i aparatit, i cili ka fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna, me të drejtë rikthimi në vendin e punës, vendim i cili është zbatuar nga ana e INSTAT. Vlera e likuiduar në total, deri më 31.03.2017, për këtë person është 564,200 lekë.
Aktualisht INSTAT, ka gjithsej 7 procese gjyqësore për punonjës të cilët janë larguar nga puna në vitin 2014 dhe 2015.

Rekomandim:
- Të merren masa dhe të nxirren përgjegjësitë konkrete ndaj personave shkaktar përgjegjës për detyrimet financiare të krijuara në dëm të buxhetit, si pasojë e vendimeve të gjykatave.

- Instituti i Statistikave, të marrë masa dhe të bashkëpunojë me Departamentin e Administratës së Lartë Publike, për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjësit, me të drejtë rikthimi në vendin e punës, në mënyrë që të ndërpritet rritja e detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit.

- Të gjitha detyrimet e krijuara sipas vendimeve të gjykatave të ekzekutohen në mënyrë vullnetare, pa urdhër ekzekutimi të përmbaruesit, me qëllim eliminimin e pagesës së tarifës së shërbimit të përmbaruesit.

- Instituti i Statistikave, të ndjekë të gjitha shkallët e gjykimit, për të gjitha rastet e ankimimit, ndaj vendimit të titullarit dhe ish titullarëve të institucionit, për largim nga puna.

Në vazhdimësi

11. Gjetje:

Nga auditimi i proçedurave të prokurimeve publike, për vitin 2015,rezultoi se, Autoriteti Kontraktor INSTAT, kishte parashikuar vlerën prej 33,152,134 lekë pa tvsh, për objektet prokuruese (me zë buxhetor 231, 602), duke realizuar vlerën prej 33,157,522 lekë me tvsh, fakt ky tregues, që nga ana e AK-së, janë realizuar të gjitha proçedurat e planifikuara, në referim të regjistrave të parashikimeve dhe realizimit,dërguar pranë Agjecisë së Prokurimeve Publike (APP).Gjithashtu, për vitin 2015 janë realizuar 6 proçedura prokurimi "Kërkesë për propozim", 4 proçedura "Negocim pa shpallje", 1 proçedurë e hapur,5 proçedura të përqëndruara, të cilat u audituan plotësisht nga grupi i auditimit.

Për vitin 2016, kishte parashikuar vlerën prej 38,379,610 lekë pa tvsh, për objektet prokuruese (me zë buxhetor 231,602), duke realizuar vlerën prej 33,521,593 lekë me tvsh, nga ku 5 proçedura prokurimi "Kërkesë për propozim", 1 proçedurë "Negocim pa shpallje", 2 proçedurë e hapur,4 proçedura të përqëndruara të cilat u audituan plotësisht nga grupi i auditimit.

Kështu, nisur nga ky auditim, <u>*në disa prej proçedurave*</u> tenderuese si vijon, "Kërkesë për propozim" me objekt "*Blerje chilleri për Institutin e Statistika*", viti 2015; Proçedura e hapur me objekt "*Shërbim ruajtje objekti*", viti 2015; "Kërkesë për propozim" me objekt "*Botim shtypshkime për INSTAT*", viti 2015; Proçedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt " *Shërbim akomodim hotelerie*", viti 2016 dhe "Kërkesë për propozim" me objekt " *Blerje karburanti*" viti 2016, janë evidentuar mangësi, në hartimin e fondit limit, në përzgjedhjen e proçedurës së prokurimit, në përgatitjen e dokumentave të tenderit, në hartimin e kërkesave kualifikuese, në ekzekutimin dhe monitorimin e kontratave, duke sjellë një efiçencë të joplotë të fondeve publike, në arritjen e objektivave të këtij institucioni. Ky përfundim kushtëzohet deri diku, edhe nga fakti se, pranë INSTAT-së, nuk ka njësi prokurimi të përhershme, brenda institucionit, duke bërë të mundur që nga ana e titullarit të autoritetit kontraktor, të krijohen në mënyrë të vazhdueshme njësi prokurimi, të cilat paraqiten me produktivitet të ulët, për shkak të mos pasjes me anëtarë trajnuar dhe të specializuar në fushën e disiplinës së prokurimit publik.

Gjithashtu, në përgjithësi (AK) i INSTAT, ka përzgjedhur proçedurën tenderuese "Kërkesë për propozim" me arsyetimin, se kontratat janë me vlerë më të ulët monetare, njoftimi i kontratës ka afat kohor minimal 10(dhjetë) ditë për dorëzimin e ofertave, por përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të ftuar, nga ana Njësia e prokurimit (NjP) është bërë me pretendimin se janë të regjistruar në sistemin elektronik, duke mos paraqitur argumentimin dhe dokumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomike që kanë ftuar, kjo në kundërshtim me VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit të prokurimit publik"neni 39, pika 4 (kërkesë për propozime).

Rekomandim:

Autoritetit Kontraktor i INSTAT-it, të marrë masa që, në fillim të çdo viti kalendarik , në pamundësi për ngritjen e njësisë së prokurimit, të përzgjedhë burime njerëzore në njësitë e prokurimit, të cilët duhet të jenë të trajnuar pranë APP-së ose të aplikohet marrja e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, të vendosen specialistë të fushës përkatëse, me qëllim që të përllogaritet sa më drejtë fondi limit, përzgjedhja e llojit të proçedurave, përcaktimi e kërkesave specifike në DT,në mbështetje të bazës ligjore, duke sjellë rritjen me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet, të përdorimit të fondeve publike në dispozicion të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje:

Nga auditimi, në proçedurat me objekt "*Blerje chilleri për Institutin e Statistika",* me fond limit 5,400,000 (pesë million e katërqind mijë) lekë, pa tvsh, për vitin 2015, dhe i proçedurës me blerje të vogël procedurën me blerje të vogël me vlerë prej prej 71,667 lekë pa tvsh, me Urdhër Prokurimi nr.36 datë 28.12.2015, në formë shkresore, të financuara nga buxheti i shtetit, rezultoi se:

-Në dosjen fizike dhe në sistemin elektronik të prokurimeve SEP në faqen zyrtare të app.gov.al, me REF-13337-10-28-2015, në DT, janë vendosur specifikimet teknike, skica teknike dhe lista e materialeve për lidhjen e chillerit, të hartuara nga ([redacted] firmosur me vulë dhe firmë), i cili nuk rezulton të jetë punonjës pranë INSTAT apo të jetë marrë si ekspert i jashtëm. Nuk është evidentuar, asnjë e dhënë mbi mënyrën sesi është rekrutuar për të realizuar dokumentacionin e dorëzuar prej tij. Gjithashtu në dosje ndodhet licenca profesionale fotokopje e cila është lëshuar në 26.05.2005 me afat 10 vjeçar, tenderi është realizuat në tetor 2015, pra del jashtë afateve ligjore) si dhe asnjë ekstrakt pranë QKR-së, gjë që ngarkon me përgjegjësi ish titullarin me delegelim të INSTAT, (z.[redacted])

-Titullari i INSTATI-it, i ka deleguar të drejtën në mungesë dhe porosi [redacted] me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, i cili ka vendosur të jetë njëkohësisht dhe kryetar i KVO-së, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 56, me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, gjë që ngarkon me përgjegjësi ish titullarin me delegim ([redacted]).

-Në DT, është vendosur kriteri i veçantë (Kapaciteti teknik) në pikën b) Liçensa profesionale e shoqërisë, të lëshuara nga autoritet kompetente shtetërore , *Kat. N.S-12 Impjante teknologjike, termike dhe të kondicionimit,* kriter i plotësuar nga operatori ekonomik fitues, "[redacted]"shpk, me të cilin është lidhur kontrata nr.1219/10 datë 24.12.2015, me vlerë totale prej 4,668,000 lekë me tvsh,e cila është realizuar me sukses nga OE, e vërtetuar në bazë të proces verbalin e datë 30.12.2015 nga komisioni i pritjes së mallit(vlen të theksohet se se,kjo proçedurë tenderimi është lëvruar në zërin buxhetor 231, pra kemi të bëjmë me investim dhe jo blerje malli).

- Gjithashtu në të njëjtën kohë, në datë 24.12.2015, nga ana e ish-Titullarit të AK ,[redacted], është miratuar kërkesa, e hartuar nga z.[redacted] Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, duke realizuar procedurën me blerje të vogël me vlerë prej prej 71,667 lekë pa tvsh, me Urdhër Prokurimi nr.36 datë 28.12.2015, në formë shkresore,me qëllim, për të testuar realizimin e montimit dhe blerjes se chillerit.Pikërisht, për të testuar është rikërkuar përsëri

nga AK, *<u>që INSTAT të kontraktojë një inxhinier të fushës i cili të jetë i liçensuar për ushtrimin e funksionit sipas kategorisë NS-12 "Impiante teknologjike, termike dhe kondicionimit",</u>* kërkesë kjo që ishtë kërkuar më parë, në proçedurën e blerjes së chillerit, e plotësuar nga operatori ekonomik "[redacted]"shpk. Ky fakt të jep idenë e mosbesimit ndaj OE fitues.
-Komisioni i blerjeve të vogla, ka vendosur të përcaktojë fitues operatorin ekonomik "[redacted]" me vlerë ofertë me vlerë prej 60,000 lekë pa tvsh. Titullari i AK zj. [redacted], ka lidhur kontratë me datë 29.12.2015, me personin fizik [redacted], e cila ka marrë përsipër të gjej inxhinierin sipas kërkesës së mësipërme. Nga auditimi rezultoi se, relacioni për "testimin e punës" e bërë nga operatori ekonomik "[redacted]" është i konfimuar nga ing. [redacted], i cili rezulton të ketë kontratë punë e lidhur më datë 28.12.2015, midis [redacted] dhe ing. [redacted].Pranë AK, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion, që të vërtetojë detyrimet që rrjedhimn midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke të dhënë idenë se personi fizik [redacted], ka bërë thjesht lidhjen me këtë person, duke u paguar me Urdhër shpenzimi nr.35 datë 28.01.2016 me *vlerë prej 60,000 lekë pa tvsh*, në mënyrë jo korrekte nga buxheti i shtetit, në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimeve, duke sjellë një <u>efekt ekonomik</u> <u>negativ</u> që ngarkon me përgjegjësi ish titullarin e INSTAT zj. [redacted] dhe Z.[redacted].

Rekomandim:
Autoriteti Kontraktor, INSTAT-i, të marrë masa që në vashdimësi të realizojë proçedurave tenderuese në përputhje me bazën ligjore të prokurimit publik, në mënyrë që të kemi përdorim me efektivitet të fondeve publike, si dhe të analizojër shkaqet e shkeljeve të evidentuar në proçedurën e mësipërme, në mënyrë , të mos përsëritjes të veprimeve administrative të cilat bien ndesh me kërkesat e bazës ligjore të prokurimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje:
Në proçedurën e prokurimit, e përqëndruar e realizuara nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqëndruara në Ministrinë e Brëndshme me objekt " Blerje karburanti për vitin 2016", rezultoi se, nga ana AK të INSTAT-it, nuk janë përcaktuar specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit dhe kushtet e veçanta të kontratës, por është llogaritur vetëm vlera e fondit limit dhe sasia e karburantit. Lidhja dhe monitorimi i kontratës datë 26.04.2016 me operator fitues "Kastrati sh.a", është realizauar nga INSTAT. Nga auditimi rezultoi se, çmimi është rritur dukshëm, në referim me çmimin fitues për 123,61 lekë/litër, duke i krahasuar me faturat tatimore të shitjes (Fatura tatimore e shitjes nr.55 dt. 29.06.2016 çmimi pa tvsh 135,51 lekë/litër; nr.93 dt. 06.09.2016 çmimi pa tvsh 134.37 leke/liter; nr.17 dt. 21.11.2016 çmimi pa tvsh 133,40 lekë/litër; nr.22 dt. 27.12.2016 çmimi pa tvsh 143,63 leke/liter). Kështu nisur nga këto kushte, nga ana e AK , *<u>duhej të zbatohej</u>* nenit 77 pika 5 e VKM-së nr. 914, dt.29.12.2014, i cili thotë *<u>" Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës, për furnizimin me karburant, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo në ngritje , me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimit të ndryshueshëm të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit mbështetur në deklaratën doganore SAD</u>", gjë e cila ka sjellë që AK, ka përfituar më pak sasi gazoil, për shkak të vlerës më të lartë të çmimit të shitjes.*

Rekomandim:
Autoriteti Kontraktor i INSTAT-it, të marrë masa nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të Brëndshëm, të realizojë monitorimin e kontratës, duke i bazuar në çmimin e Deklaratave Doganore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje:
Nga auditimi,u evidentua se, gjatë vitit buxhetor 2015, janë realizuar 5 proçedura prokurimi të cilat janë zhvilluar në mënyrë të përqëndruar, pranë Drejtorisë së Prokurimeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brëndshme, kjo në zbatim të VKM nr.28, datë 14.01.2015 "Për ngarkimin e ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime" si dhe në bazë të shkresës së Ministrisë së Brendshme, nr.26 prot datë 29.12.2014 "Kujtesë në lidhje me dërgimin e të dhënave për proçedurat e prokurimit që zhvillohen nga ana OQB", ku është kërkuar që prokurimet përqëndruara duhet të paraqiten, nga AK e INSTAT-it, pranë Ministrisë së Puneve të Brendshme, brenda datës 31.01.2015. Kështu, nisur nga sa më sipër, grupi i auditimit , ka vërejtur se, INSTAT-it, nuk e ka respektuar afatin ligjor, për dërgimin e të dhënave teknike e sasiore dhe fondin përkatës për çdo prokurim, të realizuara nga OQB, duke sjellë vështirësi e vonesa të panevojshme në zhvillimin e procedurave të prokurimit, e për rrjedhojë janë zgjatur afatet e zhvillimit të tenderëve dhe shkaktojnë vështirësi në plotësimin e nevojave për mallra e shërbime për administratën INSTAT-it.

Rekomandim:
Nga ana e strukturave drejtuese të INSTAT-it, të merren masa që të realizohen në kohë proçedura e përqëndruara tenderuese në përputhje me bazën ligjore të prokurimit publik, në mënyrë që të kemi përdorim me efektivitet të fondeve publike

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje:
Nga auditimi, rezultoi se pranë INSTAT-it, sektori i auditimit është një strukturë jo e plotë me burime njerëzore, për shkak të dështimit të rekrutimeve të autituesve të brënshëm nga DAP dhe si rrjedhojë nuk ka realizuar të gjitha auditimet që ka parashikuar në fillim të çdo viti kalendarik. Gjithashtu u evidentua se auditimi realizohet me një grup prej dy vetash. Ky grup në mënyrë të vazhdueshme (përbëhet nga përgjegjës sektori të auditimit dhe një auditues). Pozicioni i përgjegjësit të sektorit, bie në kundërshtim me detyrën e tij funksionale pasi duhet të bëjë rishikimin e cilësisë së auditimit dhe të mos marrë pjesë në angazhime të auditimit, pasi ky proces duhet të bërë në mënyrë sa më objektive dhe transparente.

Rekomandim:
Nga ana e Titullarit të INSTAT, duhen marrë masat e menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm të shqyrtojë mundësinë e rritjes së numrit të audituesve në INSTAT, me qëllim mbulimin e të gjitha fushave me risk dhe rritjen e frekuencës së angazhimeve të auditimit. Sektori i auditimit të brendshëm, të marrë masa që të rrisë frekuencën e auditimeve të IT dhe auditimeve të performancës në INSTAT. Të merren masa nga menaxhimi i lartë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga sektori i auditimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje:
Lidhur me 2015 nuk është realizuar inventarizimi në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" dhe udhëzimin e MFinancës nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" Kapitulli IV "*Inventarizimi i aktiveve*". INSTAT në 2015 ka bërë zbardhjen e inventarit të 2014.

Rekomandim:
INSTAT të marri masa dhe të realizojë zbardhjen e inventarit për vitin 2015. Në vijim.

Menjëherë

17. Gjetje:
Grupi i auditimit konstatoi se INSTAT, për **vitin 2015** ***nuk ka nxjerrë asnjë urdhër*** për ngritjen e GMS dhe për rrjedhojë nuk është realizuar asnjë mbledhje. Për vitin **2016**, INSTAT ka nxjerrë urdhër të brendshëm për ngritjen e GMS me nr. 1567 prot. datë 28.12.2016. Gjatë **2016** është realizuar një mbledhje e GMS protokolluar me shkresën nr. 1567/4 datë 30.12.2016. GMS nuk është mbledhur rregullisht për periudhën objekt auditimi. Kjo bie ndesh me kërkesat e n**enit 27** ***"Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë së sektorit publik"*** të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" ku përcaktohet se: "*1. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave*".

Rekomandim:
INSTATI të marrë masa për realizimin e takimeve periodike me qëllim diskutimin e çështjeve kryesore dhe mangësive që dalin brenda njësisë publike dhe që duhet ti parashtrohen rast pas rasti GMS-së për diskutim dhe për marrjen e masave dhe përmirësimin e punës së institucionit.

Ne vazhdimësi

18. Gjetje:
Grupi i auditimit konstatoi se institucioni ka organikë të paplotësuar gjë që afekton mbarëvajtjen e punës. INSTAT është një institucion i cili për rritjen e standarteve të statistikave ka nevojë gjithmonë për burime shtesë dhe mungesa e këtyre burimeve afekton mbarëvajtjen e punës dhe standarteve të institucionit**. Sekretar i GMS** është nëpunësi zbatues. Në këtë pikë u konstatua se është konfirmuar përkohësisht Nëpunësi Zbatues i INSTAT me shkresën nr. 6413/2 prot. datë 2.06.2016, znj. [redacted] përgjegjëse e sektorit të financës. Ajo do jetë Nëpunëse Zbatuese deri në plotësimin e vendit vakant të *drejtorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse*. Mospërputhja qëndron në faktin që **sekretar i GMS** gjatë mbledhjes ka qënë drejtori i autorizuar i financës Z. [redacted], bazë autorizimit nr. 610 prot. datë 16.05.2016, i cili është shfuqizuar me shkresën nr. 93 prot. datë 18.01.2017, ku detyrat e drejtorit të Drejtorisë së Financave përkohësisht autorizohet ti realizojë znj. [redacted]. Kjo bie në kundërshtim me **nenin 12/2a** "*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe*

kontrollin" ku përcaktohet se: *" 2. Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: a) dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*;" Aktualisht me **rregulloren dhe organikën** e re z. [redacted] kryen funksionin e koordinatorit të sistemit statistikor kombëtar.

Rekomandim:
INSTAT, të marrë masa dhe të vazhdojë të ruajë korrespondencë me DAP-in deri në plotësimin e vendeve vakante të institucionit, gjë që prek mbarëvajtjen e punës në mënyrë të drejtpërdrejtë pasi institucioni punon me kapacitete njerëzore të pamjaftuesshme. Gjithashtu të merren masa për organizimin e detyrave brenda institucionit dhe të rishikohet organika e re si pasojë e vendeve vakante.

Në vazhdimësi

19. Gjetje:
Grupi i auditimit konstatoi se Titullari informohet nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, por nuk **ka relacione dhe raporte** rreth këtyre mbledhjeve. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtëpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia **nuk ka hartuar një procedurë** për mbledhjen dhe dokumetimin e gabimeve dhe analizën e tyre.

Rekomandim:
Institucioni, të marrë masa për hartimin e relacioneve dhe raporteve rreth mbledhjeve që realizon INSTATI. Gjithashtu të merren masa dhe të hartohet një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizimin e tyre.

Menjëherë

20. Gjetje:
Grupi i auditimit konstatoi se INSTAT ka mungesë në fushën e trajnimeve të stafit. Ky institucion nuk *ka program specifik për trajnimin e punonjësve* të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III, pika 3.1. "Mjedisi i kontrollit të brendshëm" paragrafët "***Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njërezore***" dhe "***Profesionalizmi i stafit***". Punonjësit e njësisë duke mos patur njohuritë e duhura për ligjin e MFK-së dhe duke moskryer trajnime nuk bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të MFK-së, dhe kjo passjell mangësi në punën institucionale.

Rekomandim:
INSTAT, të marrë masa për trajnime të vazhdueshme të stafit dhe hartimin e një programi trajnimesh. Sipas mundësive të institucionit trajnimet që gjeneron INSTATI, si brenda dhe jashtë vendit të përshijnë të gjithë stafin sipas një skematike, bazuar kjo në barazi dhe reciprocitet.

Në vazhdimësi

Përsa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT